

ALI DHRIMO

RRETH SHKALLËVE TË MBIEMRAVE NË SHQIPEN E SOTME LETRARE

Mbiemrat, krahas karakteristikave të tjera morfologjike, kanë edhe aftësinë për t'u shkallëzuar. Me të drejtë, V. Jungu e quan këtë «ndryshimi më specifik që pëson mbiemri dhe përmes të cilit ai dallohet nga emri»¹.

Nga ana tjetër, duhet theksuar se këtë aftësi nuk e kanë që të gjithë mbiemrat e një gjuhe, por vetëm mbiemrat cilësorë të drejtpërdrejtë (duke përfshirë këtu edhe mbiemrat që tregojnë një tipar lëndor a përkatësor në kuptimin e tyre figurativ) dhe, në radhën e vet, vetëm ata cilësorë të drejtpërdrejtë, semantika e të cilëve lejon që tipari i shprehur prej tyre të dalë në shkallë (masë) të ndryshme tek emra të ndryshëm ose edhe tek i njëjti emër në rrethana të ndryshme; ndërsa cilësorët e tjerë që tregojnë një tipar absolut, nuk janë të aftë për t'u shkallëzuar, semantika e tyre nuk i lejon për ta shprehur cilësinë në gradë të ndryshme (me përjashtim të kuptimit të tyre figurativ) kh. *i verbër, i çalë, i asgjësuar, i çmëndur, i vdekur* etj. Në kuptimin e tyre figurativ mbiemrat që tregojnë një tipar lëndor a përkatësor (pronor) shkallëzohen që të gjithë, por megjithatë shkallëzimi i tyre nuk është aq i natyrshëm sa i cilësorëve të drejtpërdrejtë; të parët nuk përdoren barabar në të gjitha shkallët e nëndarjet e shkallëve — ata kanë si më të zakonshme shkallën krahasore të sipërisë.

Nga sa u tha, del se shkallëzimi i mbiemrave në thelb është karakteristik vetëm për cilësorët e drejtpërdrejtë, por jo në pavarësi të plotë nga semantika e tyre leksikore. «Shkalla është nocioni i masës në përcaktimin e brendisë semantike të njëres ose tjetres kategori fjalësh»². Shkalla e mbiemrit shpreh gradën (masën) në të cilën gjendet tipari cilësor te sendi i dhënë. Duke pasur parasysh vetëm kundërvënjen semantike midis shkallëve, mund të themi se mbiemri ka tri shkallë: *pohoren, krahasoren dhe sipëroren*.

Gjuha shqipe për shprehjen e shkallës ka vetëm forma analitike, nuk ka pra morfema formëformuese për forma sintetike si disa gjuhë të tjera, e, duke u nisur nga ky fakt Gj. Pekmezi ka pohuar se «për shkallëzimin

1) W. Jung, *Kleine Grammatik der deutschen Sprache*, Leipzig, 1955, 171, shih edhe H. Paul, *Deutsche Grammatik*, III, Halle (Saale), 1956, 94. Sado që ky pohim i përket gjermanishtes, ku mbiemri ka disa tipare më specifike sesa mbiemri i shqipes, prapëseprapë edhe për shqipen ky pohim mbetet i drejtë, sepse, ndërsa karakteristikat e tjera morfologjike që ka mbiemri, jo vetëm që i ka edhe emri, por përkundrazi mbiemri i ka ato vetëm në sajë të emrit, si forma përshtatjeje me të, shkallëzimi është një karakteristikë që mbiemri e ka në pavarësi të plotë nga emri dhe që emri nuk e ka. Sa për disa emra që kanë kuptim të përgjithshëm cilësor (*poet, filozof, burrë* etj.), kur shkallëzohen, këta nuk emërtojnë më sendin a vetën përkatëse, por tiparin e abstraguar prej tyre, pra, si të thuash, në kontekstin e dhënë, nuk janë më emra; kështu që nuk mund të themi se kategorinë e shkallës e kanë edhe emrat.

2) O.S. Ahmanova, *Slovar. lingvističeskikh terminov*, Moskva, 1956, 453.

e mbiemrave shqipja nuk ka forma të veçanta»³. Përsa i përket caktimit të formës së secilës shkallë të mbiemrit, nuk duhet ngatërruar funksioni ose përdorimi i një shkalle në vend të një tjetre, me formën e njohur e të qëndrueshme të secilës shkallë; çdo shkallë ka një formë të caktuar. Përdorimi i një shkalle në vend të një tjetre merret veç nga marrëdhënjet sintaksore të formës përkatëse dhe nga arësyetimi logjik, kurse forma e secilës shkallë lidhet drejtpërsëdrejti me morfologjinë (me treguesit morfologjikë përkatës).

Në gjuhët me forma sintetike shkallëzimi për formimin e shkallëve të ndryshme përdoren morfemat, ndërsa në gjuhët me forma analitike për këtë funksion përdoren mjete leksikore që dalëngadalë, në fillim funksionalisht e pastaj edhe morfologjikisht, duke zbehur kuptimin e duke humbur theksin e tyre, mund të përfundojnë edhe në morfema formëformuese.

1. SHKALLA POHORE.

Kur dëgjojmë termin shkallë pohore, mund të na lindë pyetja: pse nuk ekziston edhe një shkallë mohore e mbiemrit? Me termin shkallë pohore duhet të nënkuptojmë patjetër pohimin e cilësisë për sendin e dhënë — në kuptimin e gjerë të fjalës; me këtë duhet të nënkuptojmë pohimin e cilësisë së sendit, si të tillë, përmendjen e saj si karakterizuese të sendit, pa përmendur masën (gradën), në të cilën shfaqet ajo tek sendi i dhënë — pra, si shkallë bazë. Dimë se mbiemri tregon një cilësi të sendit gramatikor — kur e tregon d.m.th. pohon praninë e saj tek sendi i dhënë; po ne dimë se gjuha zotëron mjete për të pohuar edhe mungesën e cilësisë tek sendi. Kjo duket qartë po të kemi parasysh ato raste, ku mbiemri është me përdorim predikativ dhe cilësia e treguar prej tij i mohohet emrit të përcaktuar prej tij, p.sh. Berti nuk ishte *i qetë* (D. Agolli, Zhurma, 160); Ata vërtet nuk sillëshin të *përrulur* karshi Mimoszës (N. Jorgaqi, DeM, 39). Në këto raste gjuha për tregimin e cilësisë që në fakt nuk zotërohet nga sendi i dhënë, përdor po atë formë mbiemri (që përdor kur cilësia zotërohet nga sendi), pra e pohon njëherë praninë e cilësisë tek sendi dhe me një mjet tjetër gjuhësor (pjesëzat e mohimit) kthehet dhe mohon jo cilësinë, por praninë e saj tek sendi përkatës. Kjo është një rrugë logjiko-sintaksore e gjuhës dhe nuk prek aspak formën pohore të mbiemrit të dhënë, prandaj do të përgjigjemi se shkallë mohore as ka e as mund të ketë, sepse mbiemri vetëm pohon cilësinë e asnjëherë nuk e mohon atë tek sendi i karakterizuar prej tij — për këtë të fundit shërbejnë pjesëzat e mohimit.

Mbiemri në shkallën pohore vetëm përmend thjesht tiparin e një sendi gramatikor, pa treguar as shkallën (gradën, masën), në të cilën ndodhet ky tipar tek ky send, as ndonjë krahasim të këtij tipari (për nga shkalla e tij) me po këtë tipar tek sendet e tjera ose me tipare të tjera të të njëjtit send ose me të njëjtin tipar, tek i njëjti send, në të tjera rrethana.

Pra, për momentin e dhënë të ligjërit, duke përdorur shkallën pohore të mbiemrit, ne e shkëpusim tiparin e dhënë nga çdo lidhje me shkallën e me tiparet e tjera të sendit⁴. P. sh. Mirëmbërëma, arqitekturë e *re!* Tabellat e *bardha* të rrugëve të *porsapagëzuara* (I. Kadare, Shekulli, 100);

3) Gj. Pekmez, *Grammatik der albanesischen Sprache*, Wien, 1908, 121.

4) Siç thotë Vinogradovi, në këtë shkallë «cilësia merret në vetvete e abstraguar, e shkëputur nga marrëdhënja me shkallën, gradën, shprehet plotësisht jashtë krahasimit të sendeve sipas shkallës së kësaj cilësie. Forma e shkallës pohore e karakterizon sendin drejtpërsëdrejti dhe pavarësisht. Ajo është si të ishte guri i parë, vendosur për shkallët e tjera», «Russkij jazyk», Moskva, 1947, 243.

Tafili ishte *i çqetësuar*, (Th. Kacorri, Për mëmëdhenë, II, 84); tjetri ish Xhon Fistiku, intelektual i *pakënaqur* nga çdo gjë *shqiptare* (M. Kallamata, Netë, 120).

Kjo shkallë shpreh thjesht cilësinë si diçka absolute, normale, pa u mbështetur në ndonjë krahasim. Pra, nuk duhet menduar as që kjo shpreh cilësinë në shkallën më të ulët, sepse, siç do të shohim hollësisht më tej, shkalla krahasore në mjaft raste (sipas kontekstit) e shpreh cilësinë në një shkallë më të ulët se pohorja p.sh. *më i sjellshëm se ...* nuk do të thotë gjithmonë *sa duhet (tamam) i sjellshëm* (por nga ana tjetër: çka je mor ti atje? — e pyeti dragoni — jam *ma i fortë se i forti* — ia pret Marashi — Donat Kurti, Prralla, I, 54); prandaj duhet theksuar mirë që shkalla pohore nuk merr aspak parasysh gradën e cilësisë ose krahasimin, por tregon thjesht tiparin që i përket një sendi.

Siç kemi vërejtur më lart, pranimi i shkallës pohore për mbiemrat cilësorë të drejtpërdrejtë dhe mospranimi i kësaj shkalle për mbiemrat që tregojnë tipare lëndore apo përkatësore, përligjet vetëm nga ekzistenca e dy shkallëve të tjera tek cilësorët e drejtpërdrejtë e nga mungesa e këtyre tek të tjerët; përndryshe «forma» e shkallës pohore nuk ka asnjë tipar morfologjik tregues (sikurse shprehet Admoni ajo «morfologjikisht karakterizohet negativisht me anë të një morfeme zero») ⁵, ajo është thjesht forma neutrale e mbiemrit që haset ndër fjalorë. Kjo formë themelore (bazë) e mbiemrit është gjithashtu shkalla themelore (bazë) e shkallëzimit.

2. SHKALLA KRAHASORE

Duke u nisur nga fakti që shkalla pohore nuk ka asnjë tregues morfologjik karakterizues, ndonjë autor e quan shkallën krahasore «shkalla e parë e shkallëzimit» ⁶ meqenëse kjo ka treguesit morfologjikë përkatës. Siç do të shohim, sadoqë shqipja nuk ka një tregues morfologjik për të formuar një formë krahasore sintetike, prapëseprapë ajo ka një tregues morfologjik për formimin e një forme krahasore analitike. Në këtë vështrim pohimi i mësipërm mund të vlejë barabar edhe për gjuhën shqipe. Shkalla krahasore ndërtohet gjithmonë mbi bazën e krahasimit.

Në radhë të parë këtu duhet bërë një sqarim themelor. Është bërë traditë të thuhet që «kemi shkallë krahasore kur bëhet krahasimi midis dy vetave e dy cilësive të të njëjtit frymor» ⁷, «Mbiemni asht në shkallë krahasore kur tregon cilsin e emnit tue e krahasue» ⁸, «Mbiemri në shkallën krahasore shërben për të krahasuar dy emra në cilësinë e shprehur prej tij ose dy cilësi të të njëjtit emër» ⁹.

Në fund të fundit kjo thënjë është e drejtë, «shërbimi» i shkallës krahasore ky është, por në thelb kjo thënjë s'është e saktë. Mbiemri në shkallën krahasore nuk krahason sende (gramatikisht emra) midis tyre lidhur me cilësinë e shprehur prej mbiemrit, se, po të ishte kështu, po cilësitë e të njëjtit emër kur «krahasohen midis tyre» lidhur me çfarë krahasohen? Pra, në thelb në shkallën krahasore të mbiemrit krahasohen cilësi (të njëjta ose të ndryshme) të sendit (a sendeve) për nga shkalla e tyre. E që kjo është e vërtetë, dëshmon teza themelore që shkalla është karakteristikë morfologjike e mbiemrit e jo e emrit; dhe ashtu si mbiemri

5) W. Admoni, *Der deutsche Sprachbau*, Leningrad, 1960, 70.

6) W. Jung, *vep. e cit.*, 171.

7) K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949, 75.

8) O. Myderrizi, *Gramatika e re*, Tiranë, 75.

9) Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, I, 73.

në përgjithësi tregon një tipar të emrit, edhe mbiemri në shkallën krahasore duhet të tregojë tipar të emrit — kurse krahasimi i dy emrave s'ka të bëjë direkt me shprehjen e tiparit nga ana e mbiemrit. Të dy sendet që përbëjnë gjymtyrët e krahasimit duhet të kenë dhe kanë detyrimisht të njëjtin tipar, prandaj të krahasohen këto të dyja lidhur me tiparin e dhënë duhet kuptuar kështu: të krahasohet tipari i dhënë për nga shkalla e tij tek njëri dhe tek tjetri element, tek cili element ky tipar është në një shkallë më të lartë se tek tjetri. Një e vërtetë e tillë gjuhësisht errësohet nga fakti që mbiemri shprehet vetëm një herë dhe pikërisht tek elementi i parë — ndërsa po të thuhej gjithmonë vetëm: Emri i atij njeriu në ato vite ishte bërë për ilirët *aq familjar e i adhurueshëm*, sa ishin *familjarë e të adhurueshëm* edhe emrat e hyjve (Njerëz të rinj tokë e lashtë, 135), pra po të kundërvihet gjithmonë edhe gjuhësisht, ashtu siç kundërvihet logjikisht: *aq familjar me familjar*, kjo do të dilte më lehtë në dukje. Me këtë as që mendojmë që duhet të thuhet pa tjetër kështu ose që dikur është thënë vetëm kështu, po e përdorim këtë arësytim vetëm e vetëm për të depërtuar në thelbin e procesit të krahasimit.

Mbas këtij shpjegimi besojmë se është e qartë që edhe kur, për lehtësi e shkurtësi trajtimi, do të përdoret shprehja — krahasimi i dy sendeve për nga *shkalla* (grada) e cilësisë së tyre, të shprehur nga mbiemri karakterizues, prkt. krahasimi i dy cilësive për nga *shkalla e tyre* (kur krahasohen cilësi të ndryshme të të njëjtit send ose të sendeve të ndryshme), me këtë duhet të kuptohet gjithmonë ajo që u shpjegua më sipër.

Mendojmë se nuk i qëndron së vërtetës shkencore ndarja që ekziston nëpër gramatikën tona e të huaja midis shkallës krahasore të sipërisë dhe së ashtuquajturës shkallë sipërore relative. Në të vërtetë, edhe kjo e fundit mbështetet plotësisht mbi bazën e krahasimit — kërkon dy elementë krahasimi e në mjaft raste përdor edhe po ato lidhëza krahasimi, (*nga, se*). Nga ana tjetër, edhe forma e vetë mbiemrit shumë shpesh është e njëjtë me atë të krahasores së sipërisë. I vetmi ndryshim midis tyre është ndryshimi semantik: në shkallën krahasore të sipërisë elementët, të cilëve u krahasohet cilësia përkatëse, nuk është e domosdoshme të jenë homogjenë, mjafton që të dy këta elementë të zotërojnë cilësinë e dhënë (kh. Mendtë janë *më të vlefshëm* se dhentë) dhe, veç kësaj, kur elementët e krahasimit janë homogjenë, në këtë shkallë në të dy krahet e krahasimit mund të marrin pjesë një numër i barabartë ose i ndryshëm sendesh, por si krahi i dytë krahasimi nuk mund të jetë kurrë mbarë klasa e sendit (a sendeve) që shqyrtohet për nga shkalla e cilësisë së dhënë në elementin e parë të krahasimit. Në të ashtuquajturën shkallë sipërore relative është e domosdoshme që elementët e krahasimit të jenë homogjenë, t'i përkasin së njëjtës klasë dhe nga ana tjetër, në elementin e dytë të krahasimit të përfshihet mbarë klasa ose grupi i synuar i sendeve ku bën pjesë sendi që përmendet në elementin e parë të krahasimit (kh. *nxënësi më i mirë i klasës*). Por, nëse cilësia e sendit të dhënë qëndron në një shkallë më të lartë se e njëjta cilësi tek një send tjetër, apo tek mbarë sendet e klasës përkatëse, kjo, siç thamë, nuk e lëkund aspak bazën themelore, që në të dyja rastet mbetet krahasimi. Për këto arësye ne do t'i përfshijmë të dyja aspektet në një shkallë me dy variante: të parën do ta quajmë shkallë krahasore të sipërisë relative, ndërsa të dytën, shkallë krahasore të sipërisë absolute. Kështu që për nga shkalla (grada) mund të krahasohet:

a) cilësia e një sendi me po atë cilësi tek një send tjetër: Gjini asht *ma i gjatë e ma i bukur* se ti (S. Pitarka, Trimi, 4); Kur kishte dalë partizan, në shtëpi la t'ëmën, t'anë dhe një vëlla *më të vogël* se vetja. (Z. Sako, Nga

jeta, 29); Kënga qënka më e fortë se njeriu (J. Xoxa, Lumi, I, 55); N'është m'i zoti nga unë, / le të më dalë këtunë! (Çajupi, Baba Tomorri, 32); i rriht prej gjuhe / zë m'i ëmbëlë nga mjalti (N. Frashëri, Iliadhë, 33).

b) cilësia e një sendi me po atë cilësi tek disa sende të tjera: Ka dalë ma i zgjuet se baba e gjyshi i vet (K. Jakova, Toka, 10); Aljona dukej pak m'e madhe në moshë dhe m'e pjekur nga të tjerat (D. Shaplllo. Përtëritje, 155); Ai luftoi me nder në çetë, / Nga trimat ish më trim (D. Agolli, Zhurma, 15); Dhe kjo çupa e Zongove, e pashme, e hedhur, m'e kuqe se gajtanët e xibunit e m'e bardhë se këmisha e gjirit (S. Andoni, Tregime, 31).

c) cilësia e disa sendeve me po atë cilësi tek një send i vetëm: Irena i kishte mbyllë syt e zij, ma të zij se rrushi (H. Stermilli, Sikur, 62); Gjon Kastrioti dhe Araniti s'qenë aq të lumtur sa Balsha III (F. Noli, HeS, 68/1921); Jini të dy më të rinj nga unë (N. Frashëri, Iliadhë, 34); Ti i di ata më të mirë se unë. (F. Gjata, Ujë fle, 27); ca kanë qënë motra të vogla të shqipes e shumë më të ra se ajo (S. Frashëri, Shqipëria, 28).

c) Cilësia e disa sendeve me po atë cilësi tek disa sende të tjera: këta do të ishin më të thjeshtë se ne (D. Agolli, Zhurma, 14); Dhëmbët e tyre bëheshin më të mëdhenj se gishtrinjt e tyre që mirrin formën (P. Marko, Qyteti, 261); A ka ndër bjeshkët e në shpatat tona / Dy emra më të ndershëm se tuajt? (S. Luarasi, Vilhelm, 49). ose

d) cilësia e një a disa sendeve me po atë cilësi tek mbarë klasa ku bëjnë pjesë: Dora i kapi gurin më të madh të gjerdanit të çmuar (J. Xoxa, Lumi, III, 248); ajo ishte gruaja më e dëgjuar e më e afruar e lagjes (V. Vinçani, Lumturia, 93); Nusja më fatzezë mbi të gjitha nusët (H. Mosi, Cubat, 118); Raporti ekzistues midis pagës mesatare të punonjësve ose pagës më të ulët të punonjësve... dhe pagës më të lartë në vendin tonë... është nga më të ultit (Fjala e Sh. M. Shehu — Puna, 18. III. 66,2); ishte më i gjatë në atë grup të vogël njerëzish (A. Abdihoxha, Tri, I, 302).

Gjithashtu mund të krahasohet

dh) cilësia e një sendi (a disa sendeve) me një (a disa) cilësi tjetër (a të tjera) të të njëjtit send: dhe hëna si dhe dheu nuk 'e bën rrumbullake, po më të gjatë se të gjerë (N. Frashëri, Dituritë, 118); Dashuria, që i jep flakë e mban gjallë jetën, qënka më tepër ngjitesë se sa zbritësë (J. Xoxa, Lumi, I, 107); Me Besimin djaloshin e lidhte një histori, sa e ndërlikuar aq dhe e papëlqyer, (A. Abdihoxha, Tri, I, 8); Fytyra e tij sa e rreptë, aqë e këndëshme edhe e mallshme më siellet gjithmonë përpara syve të mi (H. Mosi, Cubat, 91); Sjellja e Venecianëve në periudën e këti rrethimi është aqë e turpshime sa edhe e pabesë (F. Noli, HeS 62/1950); Duke mbaruar mund të themi që për Skënderbenë është aqë e drejtë sa edhe e merituar lëvdata (po aty, 117).

e) cilësia e një sendi me vetveten e vështruar në kohë e kushte të ndryshme: Po paskëtaj duhetë të jemi shumë më të mirë nga ç'kemi qënë. (N. Frashëri, Mësime, 30); Pasha zotin ma të mërzitun se sot kurrë s'të kam pa! (M. Myftiu, Leka, 149); Tani dhoma Mimosës i duket më e pasur dhe më e bukur se herë të tjera. (N. Jorgaqi, DeM, 24); Azemit i ishin skuqur faqet dhe ishte më i shqetësuar se sa kur i binte tamburasë dikur mes shokëve të çetës së tij. (D. Agolli, Zhurma, 15); Në gjumë, Skënderi dukej më i cfilitur dhe më i dobët se zakonisht. (A. Abdihoxha, Tri, I, 180); doktori doli nga dhoma më i dëshpëruar, më i dërmuar se më parë. (po aty-110); Jam shumë më e qartë se sa isha. (I. Uruçi, Pëlhura e zezë, 20).

Nga sa parashtroam, del e qartë se sendet që përbëjnë krahët e krahasimit (ose cilësitë e të njëjtit send të krahasuara për nga shkalla e tyre), nga të dy anët e krahasimit, mund të jenë të panumërta, por ne, për lehtësi

studimi, do të bëjmë fjalë për dy sende, duke nënkuptuar: dy a më shumë sende, prkt. dy a më shumë cilësi.

Mbiemri në shkallën krahasore cilësinë e një sendi e shpreh të krahasuar për nga shkalla e saj me të njëjtën cilësi të një sendi tjetër, ose me një cilësi tjetër të të njëjtit send, ose me një cilësi tjetër të një sendi tjetër, ose me të njëjtën cilësi të mbarë klasës ku përfshihet sendi i dhënë, e bile me të njëjtën cilësi tek i njëjti send, por në rrethana të ndryshme. Pra, shkalla krahasore tregon shkallën e së njëjtës cilësi tek dy a më shumë bartës të ndryshëm të saj (prkt. tek gjithë bartësit e një klase të dhënë) dhe më rrallë shkallën e dy a më shumë cilësive të ndryshme tek i njëjti bartës i tyre, e bile shkallën e së njëjtës cilësi tek i njëjti bartës në rrethana të ndryshme. Ndryshe, mund të themi edhe: Mbiemri në shkallën krahasore shërben për të krahasuar për nga shkalla të njëjtën cilësi tek dy sende të ndryshme (prkt. tek një send në raport me mbarë klasën ku ai bën pjesë), ose dy cilësi të ndryshme tek i njëjti send e bile të njëjtën cilësi tek i njëjti send, por në rrethana të ndryshme, ose dy cilësi të ndryshme tek dy sende të ndryshme.

Për të pasur krahasim midis cilësive të sendeve për nga shkalla e tyre, duhet pa tjetër të kemi dy elementë, dy krahe krahasimi të cilët lidhen me njëri-tjetrin me anë të krahasimit. Gramatikisht kjo lidhje bëhet me anë të lidhëzave krahasuese, të cilat, sa kohë që janë të pranishëm të dy elementët e krahasimit, janë të domosdoshme (jo si në rusishte e latinishte, ku edhe mund të mungojnë, p. sh.rus. *mjod slashe çem sahar*, lat *mel dulcius quam saccharum est* — por edhe: *mjod slashe sahara*, prkt. *mel dulcius saccharo est*). Në mjaft raste sendi i krahasuar për nga shkalla e cilësisë së dhënë mund të mos jetë shprehur në fjalinë përkatëse, ku gjendet mbiemri karakterizues, por në fjalinë a fjalitë e mësipërme; megjithatë, sa kohë që dihet se për se bëhet fjalë, cili emër karakterizohet, ai nuk rimerret, p.sh. Mos asht martesë sinonim i vdekjes? Për mue dhe shumë të tjera asht *ma e hidhët* se vdekja (H. Stermilli, Sikur, 172). Po kështu mund të mungojë edhe elementi i dytë i krahasimit, kur është tashmë i njohur nga lexuesi a bashkëbiseduesi; por elementi i dytë mund të mungojë edhe kur nuk është shprehur asnjëherë më parë, por është lehtësisht i vetkuptueshëm, p.sh. Ferra e vogël e ka dymimin *më të pakë*. (J. Xoxa, Lumi, I, 239).

Duke pasur parasysh të gjitha këto, themi se kemi shkallë krahasore të mbiemrit sa herë që cilësia e shprehur prej tij paraqitet e krahasuar për nga shkalla e saj me të njëjtën cilësi të një sendi tjetër (a sendeve të tjerë), duke rezultuar qoftë *më e lartë*, qoftë *më e larta*, qoftë *e barbartë* a qoftë *më e ulët* se ajo. Këtej del se kemi shkallë krahasore të sipërisë relative, të sipërisë absolute, të barazisë dhe të ultësisë.

2.1. A. Shkalla krahasore e sipërisë relative dhe forma e saj.

Duke u nisur nga përkufizimi i mësipërm i shkallës krahasore, themi se mbiemri në shkallën krahasore të sipërisë relative tregon se cilësia e sendit të karakterizuar nga ai mbiemër është në një shkallë më të lartë se e njëjta cilësi tek një send tjetër, ose se një cilësi tjetër e të njëjtit send, ose se një cilësi tjetër e një sendi tjetër e bile se e njëjta cilësi e të njëjtit send, por në rrethana të tjera. Emri që e ka cilësinë në një shkallë më të lartë, përbën gjymtyrën e parë të krahasimit, ndërsa emri tjetër, me cilësi në shkallë më të ulët (ose cilësia tjetër e emrit a e njëjta cilësi në rrethana të tjera) përbën gjymtyrën e dytë të krahasimit (p.sh. Doktor i ishte *më i verdhë* se ne të dy (D. Agolli, Zhurma, 96); Po tashti ajo ishte

aty në qoshe të magazines dhe ndoshta do t'i jepej një tjetri, një njeriu *më të zot se ai*. (A. Abdihojha, Tri, I, 13); Deti shtrihet i qetë, kjo qetësi e bënte *më madhështor, më të pafund, më plak e më të ri* (po aty, 7); Një hije, e cila iu duk vajzës *më e gjatë* nga ç'ishte (.) kapërcen gardhin (J. Xoxa, Lumi, I, 199); qerozi i shëmtuar e i ndyrë u hodh në një kazan magjik me ujë të përvëlur dhe doli q'andej i ripërtëritur: *më i ri, më i fortë, më i ditur, më i bukur* (M. Kallamata, Shokë, 25).

Forma e shkallës krahasore të sipërisë relative ndërtohet analitikisht, duke i pararendosur pjesëzën me origjinë ndajfoljore *më* formës së shkallës pohore të mbiemrit të dhënë, pra *më + mbiemër në pohore*. Kësaj pjesëze i është zbehur kuptimi i mirëfilltë, origjinar ndajfoljor (kh. s'dua *më*, s'jeton *më*, s'foli *më* etj.); ajo ka humbur edhe theksimin e saj dhe ka një pozicion të ngulitur, para mbiemrit — pra është kthyer në morfemë formëformuese¹⁰, kështu që thënja e K. Cipos që shqipja s'ka «parashtesë autonome për të formuar shkallë krahasore edhe sipërore» e detyrohet t'i formojë «vetëm perifrastikisht, d.m.th. me mjete leksikore»¹¹, për shkallën krahasore të sipërisë (relative e absolute) është e drejtë vetëm historikisht, sepse sot *më* nuk ka mëvetësi leksikore, por është fjalë-morfemë, a fjalë shërbyese.¹²

Forma e shkallës krahasore të mbiemrit mund të përforcohet me ndajfolje të ndryshme sasiore që tregojnë intensitetin e shkallës së tiparit *-sa më* e madhe është konkretisht kjo sipëri në krahasim me shkallën e po këtij tipari tek një send tjetër (kh. më pëlqeu të pasonj dhe unë me fuqitë e mia të vogla lëvizjen madhështore që bëhet rreth kësaj godine *sa e sa më të madhe*, nga mjeshtër të çuar dhe të mënçur që punojnë atje — Çajupi, Vepra, 323)¹³.

Këto ndajfolje janë: *shumë, akoma, edhe, pak, ca, jashtëzakonisht* etj. (kh. edhe gjerm.: *viel, etwas*; frengj.: *bien (de) beaucoup, un peu*).¹⁴

Skema e këtij përforcimi është kjo: *ndajfolje përforcuese + mbiemër në krahasoren e sipërisë relative*.

Siç vëren edhe V. Vinogradovi, «në grupin e ndajfoljeve sasiore vërehet një gamë e ndërlikuar kalimesh nga kuptimi cilësoro-vlerësues, nganjëherë shumë emocional dhe subjektiv, i shkallës dhe sasisë, deri në kuptimin e përpikët objektiv të shkallës dhe të sasisë, nganjëherë të shprehur bile me numra (kh. nga njëra anë: *oçenb, krajne, sovershenno, çrezvyčajno, zameçatelbno* etj. dhe nga ana tjetër, *vdvoe, vtroe, mnogo, tri-zhdy* etj.)»¹⁵

P.sh. Dashuria e Bertit: Një zjarr kashte, që ishte shuar që në orën e parë ose ndofta *pak më e fortë* (V. Vinçani, Lumturia, 113); Gjë e keqe si vepër dhe *ca më e keqe* si mejtim (F.S. Noli, Don Kishoti, 85); Por ma i bukur, *fort ma i bukur* se ju do të jetë ai (J. Rrota, Rreth, 2); Pastaj ti filllove të më shikoje dhe sytë t'u bënë *akoma më të turbull*. (I. Kadare,

10) Pjesëz (Partikel) e jo ndajfolje e quan *më-në* e kësaj forme edhe Gj. Pekmezi, vep. e cit., 121.

11) K. Cipo, *Gramatika*, 76.

12) Siç janë foljet ndihmëse *kam e jam* tek kohët e përbëra të foljes.

13) Kh. edhe J. Erben, *Abriss der deutschen Grammatik*, Berlin, 1965, 164: «Nga ana tjetër mund të shfaqen tek krahasorja fjalë shoqëronjëse gradëtheksuese, përforcuese: *viel (bedeutend, erheblich, Weitaus, Wesentlich) schneller*».

14) Ndër ndajfoljet që përdoren si intensifikuese të cilësisë, si përforcuese të kësaj shkalle K. Kristoforidhi shënon veç këtyre edhe *tepër e fare: tepër më i bukur, fare më i bukur, Gramatiki tis Alvaniqis glosis*, Konstandinopojë, 1872, 32. Në letërsinë dhe materialin gjuhësor që shqyrtoam nuk gjetëm as edhe një rast të tillë.

15) V.V. Vinogradov, vep. e cit., 370.

Përbindshi, 4); Na mundena me bam një sent tjetër edhe ma të bukur (H. Mosi, Cubat, 27); Qoftë edhe një mijë herë më i vogël trualli ku sillet e vërtitet gruaja, ai është një mijë herë më i mbushur se fusha e hapët (J. Xoxa, Lumi, I, 171); Megjithëse dy herë më i ri nga unë, ti më dhe këshilla (V. Vinçani, Të rinjtë, 34).

Duhet shënuar se ndajfoljet përforcuese (shprehëse të intensitetit të sipërisë) këtu nuk janë aspak sinonimike, por përkundrazi ato kanë vlerën e tyre përkatëse e vetëm në një vështrim të gjerë mund të grupohen si më sipër.

Shkalla krahasore e sipërisë relative mund të përdoret edhe e shoqëruar nga ndajfoljet *sa... aq...* për të treguar rritje proporcionale të shkallës së cilësisë (a cilësive) tek një a më shumë sende, p.sh. Prandaj, *sa më të lartë të ketë pozitën* ndonjeri në Amerikë, *aq më të çmëndura dhe tuafe* janë veprat e tij (M. Kallamata, Gjembat, 9). Por rritja proporcionale e shkallës së tyre mund të ekzistojë jo vetëm tek dy cilësi (pra, tek dy mbiemra) por edhe tek një cilësi e një proces (pra, një mbiemër dhe një ndajfolje ose anasjelltas) p.sh. Malsorët, *sa ma të pafrigë* që kishin qenë ditum në fillim kundrejt të prekunvet, *aq ma fort* ia tepruen rojes (J. Rrota, Rreth, 64); *Sa më shumë* çante vapori dallgët drejt lindjes *aq më e ngrysur* bëhej fytyra e doktorit. (A. Abdihoxha, Tri, 1, 23); Sa më tepër dëshëron ta shofish vëllaun *aq ma e fortë* bahet frika se mos të pengon gja (K. Jakova, Halili, 48).

Nga sa thamë, del se ndajfoljet intensifikuese kanë të bëjnë me mbarë formën e shkallës krahasore të sipërisë relative e jo vetëm me pjesëzën formëformuese *më*. Ato vendosen përpara formës përkatëse. Ajo vlen edhe për raste të tilla si: Filja e bukur ishte aty, veshur me një fund jeshil si atëhere, por *shumë më të vjetër e të zbardhur* (A. Abdihoxha, Tri, I, 184); Në këtë botë nuk ka tjetër *sulltan më të math e fuqiplotë* (Çajupi, Përralla 143), — ku jo vetëm ndajfolja, shprehëse e intensitetit (*shumë*), por edhe pjesëza (*më*) që është pjesë e pandashme e formës së krahasores së sipërisë, për efekt stilistik, nuk përsëritet para çdo mbiemri, por përdoret vetëm para mbiemrit të parë (ky fenomen i mospërsëritjes së elementëve përbërës të një forme nuk është i izoluar vetëm tek mbiemrat -kh. duke qeshur e kënduar, do lexuar e mësuar, të lexoj e mësoj etj. Ne mendojmë se përdorime të tilla i përkasin më tepër gjuhës popullore dhe nuk duhet të shtrihen në gjuhën letrare). Për të hetuar, nëse shkallëzohen e intensifikohen gjithë mbiemrat e bashkërenditur në këtë mënyrë, apo vetëm mbiemri i parë, ndihmohemi nga konteksti i dhënë dhe nga semantika e këtyre mbiemrave.

Përsa u përket rasteve të tipit: Do t'isha *më shumë e kënaqur* sikur babai të më rrihte për vdekje, se sa të duroj ndëshkimin e tij të heshtur. (N. Jorgaqi, DeM. 116); ajo qëndronte më këmbë të dera dhe, me një vështrim *më shumë të dëshpëruar* se sa ironik,... dëgjonte bisadat e tyre. (Sh. Musaraj, Para, II, 186; e ndjente veten më tepër përgjegjës kundrejt popullit (S. Spasse, Buzë, 144) — do të vërejmë se këtu s'kemi paralelizëm (e *aq më pak barazi*) me format *shumë më e kënaqur, shumë më e dëshpëruar* etj., pra nuk kemi ndërkalje të *shumë* midis pjesëzës *më* e mbiemrit në pohore, por një formë më vete që është ndoshta një analogji e gjuhës letrare me formën *më pak + mbiemër* në pohore (pra kundërvënje e kësaj forme),¹⁶ pra në fund të fundit një shkallëzim të

16) Këto forma: *më shumë i bukurë / më shumë e madhe* edhe Kristoforidhi i jep të kundërvëna me format *më pak e madhe / më pak i bukurë, vep. e cit., 33.*

ndajfoljes intensifikuese (*shumë, tepër fort* etj). në format *shumë* i kënaqur, *tepër* interesant etj. Si rrjedhim këtu bëhet fjalë për intensifikimin e sasisë, masës së cilësisë të shprehur nga ndajfoljet sasiore e jo të vetë cilësisë së shprehur nga mbiemri (kh. edhe hiperkarakterizimet që hasen në gjuhën e folur, p.sh. Ai është *akoma edhe më i zgjuar* se Petriti). E njëjta vërejtje mund të bëhet edhe për rastet me mbiemra foljor, ku *shumë* për vetë semantikën e këtyre mbiemrave vendoset zakonisht pas formës së shkallës pohore të mbiemrit. Kjo ndajfolje në atë pozicion, si në çdo pozicion tjetër, mund të shkallëzohet, dhe do të kemi forma të tilla: I ngrysur *më shumë* se herët e tjera, ai nuk e la Emirën e Ajetin... (Sh. Musaraj, Para, I, 104), filloi ta shohë veten të lidhur *më tepër* me popullin (S. Spasse, Buzë, 144) — ku duket qartë që s'mund të barazohet me *shumë më i ngrysur*, por shumë-shumë vetëm me: *më shumë i ngrysur*.

Gjymtyra e dytë e krahasimit lidhet me lidhëzat: *se, se sa*, në toskërishten edhe *nga, seç* dhe në gjuhën e folur *se nga*. Kjo e fundit duhet mënjanuar nga gjuha letrare, p.sh. Të egrat, kur zbuten, vijnë e të bëhen më të buta *se* të butat (J. Xoxa, Lumi, III, 290); S'ka gjë më të bukur *se sa* të shohësh Pogradecin (Dh.S. Shuteriqi, Gurnecka, 18); Dashke të dalç më e zgjuar *nga* unë (Sh. Musaraj, Të shkuara, 64); Ma e bukur edhe nga shqipja jonë? (K. Floqi, Nder, 31); Dhoma iu duk e shkretë... iu duk më e errët *seç* ishte. (N. Jorgaqi, DeM, 6).

Në ndonjë rast, kur si gjymtyrë e dytë e krahasimit është një fjali, lidhëza krahasore mund të mos shprehet, por nënkuptohet p.sh. shejtan murmuriti ai... duke menduar me trishtim se s'kishte gjë më të keqe / *se sa* — A. Dh. / kur s'të besonte edhe një çamaroke (A. Abdihoxha, Tri, I, 226); Nukë ka m'e madhe gjëmë / për një pjellë (*se sa* — A.Dh.) kur s'ka mëmë (Çajupi, Vepra, 309).

Ndonjëherë në toskërishten letrare, duke u tërhequr nga analogjia me krahasoren e sipërisë absolute (më i miri *prej* nesh etj.) gjymtyra e dytë e krahasimit ndërtohet me lidhëzën *prej*, p.sh. nuk e shikoni se ka në ujërat batakë / kafshë *prej* nesh më frikacake? (S. Çomora, Sorra, 31). Një përdorim i tillë duhet mënjanuar nga gjuha letrare.

Kur gjymtyra e dytë e krahasimit është e njohur për bashkëbiseduesin, folësi e lë krahasimin të mangët, d.m.th. shpreh vetëm gjymtyrën e parë të tij, p.sh: Duhan i mirë ky i Shkodrës! — Ja bëri i jati, sikur fliste me vete. Pastaj shtoi me zë *më të lartë*: (S. Spasse, Buzë, 153); Zakonisht, vajzat e mëhallës mblidheshin në shtëpinë e Emakos se aty s'kishte mashkull. Atje qëndronin *më të lira* e nuk u binte rasti të skuqeshin (Z. Sako, Buka, 70); do të na dëgjonte mëhalla e s'do kish turp *më të madh* (Sh. Musaraj, Isha unë, 20).

2.1. B. Shkalla krahasore e sipërisë absolute

Mbiemri në shkallën krahasore të sipërisë absolute tregon që cilësia e një a disa sendeve të një grupi *homogjen* sendesh është në shkallën më të lartë në krahasim me të njëjtën cilësi tek të gjitha sendet e tjera (që mbeten) të këtij grupi. Pra, në një grup të përbërë prej elementësh të njëllajtë (homogjenë), cilësia e dhënë (e shprehur nga mbiemri përkatës) tek një e disa elementë të këtij grupi qëndron në shkallën më të lartë përballë së njëjtës cilësi tek mbarë elementët e tjerë të grupit, ku këto bëjnë pjesë, — këto të fundit veçohen si bartëse të gradës më të lartë të kësaj cilësie.

Ajo që e dallon prerazi këtë shkallë nga shkalla krahasore e sipërisë relative është pikërisht fakti që këtu vihen përballë njëra-tjetrës (lidhur

me shkallën e cilësisë) një a disa pjesë me të tërën e synuar si njësi e jo në elementët e veçar pjesëpërbërës të saj, rrjedhimisht këtu krahasohen për nga shkalla e cilësisë së tyre elementë homogjenë (të njëllojshëm) e jo si në krahasolla e sipërisë relative, ku elementët që krahasohen mund të jenë edhe heterogjenë (mjafton që të kenë cilësinë e dhënë).

Një ndihmë të madhe për dallimin praktik të shkallës krahasore të sipërisë absolute të mbiemrit (gjithmonë kemi parasysht pozicionin atributiv të mbiemrit) nga krahasorja e sipërisë relative na jep edhe shqyrtimi i trajtës së emrit të karakterizuar nga forma përkatëse; në qoftë se emri i karakterizuar është në trajtën e shquar, atëhere kemi të bëjmë gjithmonë me shkallën krahasore të sipërisë absolute, ndërsa, kur ai është në trajtën e pashquar, kemi të bëjmë me shkallën krahasore të sipërisë relative, p.sh. duhet të ish ndeshur me *rrugët më të vështira të jetës*. (Sh. Musaraj, Para, I, 99) (— krahasore e sipërisë absolute); ndërsa: duhet t'ish ndeshur me *rrugë më të vështira të jetës*: (nënkuptohet: *se sa këto rrugë*) (- krahasore e sipërisë relative): kh. Sa e ambël dhe e shijëshme ishte kjo bukë! Kurrë s'kam hangër *bukë ma të mirë* (H. Stërmilli, Shtigjet, 62).

Sa herë që përdoret në funksion atributiv shkalla krahasore e sipërisë absolute nuk ka një formë të veçantë, ajo është e njëllojtë me atë të shkallës krahasore të sipërisë relative, ndërsa kur përdoret në funksionin predikativ, ajo — si rregull — është si e shkallës krahasore të sipërisë relative, por gjithmonë në trajtë të shquar¹⁷, pra, në fakt, në rastin e dytë kemi të bëjmë me mbiemër të substantivuar gramatikisht, pra me substantivim kontekstual të mbiemrit të dhënë, p.sh. Gjergj Kastrioti është një nga kryeluftëtarët *më të mbaruar*, *më faqebardhë* dhe *më të mëdhenj* të botës. (F. Noli, HeS, 116); Qenka burri *më i poshtër* që ka Korça! (S. Çomora, Karnavalet, 203); U zbulua një nga bazat *më të vjetra* të teknikës (F. Paçrami, Në Tufan, 7); Kjo është një nga fitoret *më të shkëlqyera* të partisë sonë. (E. Hoxha, 20 vjet, 24); Ky ishte me siguri *më i gjati* në këtë listë (I. Kadare, Gjenerali, 19); Në këtë pikë Qemali kish filluar të urrente edhe zotin Bardhi, që ish si *më i gjykuari* në gjithë atë rreth (Sh. Musaraj, Para, I, 28); zgjodhi ata që ju dukën *më të mirë* me porosi (M. Gura, Themelet, 60).

Disa autorë e përdorin formën e shkallës krahasore të sipërisë absolute në pozicion atributiv të prapavendosur në formë të shquar edhe për ta dalluar formalisht nga shkalla krahasore e sipërisë relative, p.sh. Një nga këngët *më të përmallshmet* t'Italisë dhe një nga pjesët më interesante të poezisë popullore ballkanike të krahasuar është kënga e Kostandinit. (E. Çabej, Konstandini, Shkrimtarët, II, 456); Ky e ata që e kanë çuem janë njerzit *ma të poshtërmit e ma të ndytit* e kësaj botë. (H. Mosi, Cubat, 52); Pse e dërgove Tahir bejn me taborrin *ma të mirin?* (K. Jakova, Halili, 25); atë birin e vet *ma të madhin* e shtrëngonte me u stërvitun (A. Xhuvani, Jeta, 41). Me sa kemi hetuar ne, ky përdorim është një gegizëm, dhe është më i rëndomtë në shkodrnishten.

Diferencimi edhe formal i shkallës krahasore të sipërisë absolute nga shkalla krahasore e sipërisë relative është një karakteristikë mjaft e mirë dhe dëshmon për lëvrimin e gjuhës, por, meqenëse mënyra më e rën-

17) Duhet mënjeluar nga gjuha letrare rastet e rralla, kur nën ndikimin e gjuhës së folur popullore edhe në funksion predikativ mbiemri në këtë shkallë del në trajtë të pashquar, p.sh. *M'e madhe* e nisivet t'Evropës është Ingiltera. (S. Frashëri, Dheshkronja, 20) — pra, sidomos kur pason gjindorja. Për paqëndrueshmërinë e kësaj forme mjafton të krahasojmë formën e shumësit: *Më të mëdhat'* e kënetavet t'Evropës janë: (po aty, 24) — ku nuk themi dot: *më të mëdha të...*

domtë për krahasoren e sipërisë absolute me formë të substantivuar të mbiemrit është ajo e paravendosjes së mbiemrit, mendojmë se është më mirë që të përgjithësohet pikërisht kjo mënyrë në pozicion atributiv, p.sh. E han deri në *ma të mbramen* dromcë (D. Kurti, Prralla, I, 26); Desdemona... që nga shpirti, nga zemra dhe nga fytyra siç thotë Emilia «*më i bardhi dhe më i ëmbëli* pullumb që fluturoj në këtë botë» (F. Noli, Othello, 7) — sepse në të gjitha shembëllat e këtij tipi kemi barazi të plotë kuptimore me «*ma të mbramen e dromcave*» etj.

Nga sa u parashtrua, del se edhe në këtë shkallë kemi krahasim, por këtu — si rregull — nuk kemi lidhëza krahasore për të lidhur elementin e parë me elementin e dytë. Krahu i dytë i krahasimit asnjëherë nuk zbërthehet shprehimisht në elementet e tij përbërës, ai shfaqet si grup, i padetajuar. Për të shprehur këtë krah përdoret rasa gjindore, ose një rasë parafjalore e emrit të grupit, të cilit i përket elementi (a elementët) që përbën gjymtyrën e parë të krahasimit, p.sh. më kujtohet se ishte një nga anëtarët më të çrregullt të *organizatës* së Bashkimeve profesionale (D. Ago-lli, Zhurma, 49); Nusja ma fatzezë *mbi* të gjitha nusët (H. Mosi, Cubat, 118).

Por shumë shpesh gjuha bën një abstraksion mjaft të rëndësishëm, duke mos e shprehur fare grupin ku bën pjesë elementi, të cilit i shkallëzohet cilësia. Ky grup lihet mënjanë si lehtësisht i kuptueshëm prej bashkëbiseduesit e lexuesit dhe, në vend të tij, shprehet vendi, ku ndodhet grupi ose pronari i tij. Ka ndonjë rast që shënohen që të dy, p.sh. *nga besët'* e këtyre... më të — përhapuratë *mi dhet* janë bes e Budesë edhe bes'e... Brahmesë. (S. Frashëri, Dheshkronjë, 14). Ky abstraksion nuk është specifik për shqipen, por, me sa mund të konstatojmë ne, edhe për gjuhë të tjera. Në një mënyrë mjaft të goditur S. Zomer (Sommer) thotë se «ekonomia e shprehjes, në stilin më të lartë edhe në më të ultin, gjen të drejtën e saj më të plotë në shkurtësinë...». Ai vëren më tej se, sado që kjo shkurtësi në stilin e lartë të poezisë është e përcaktuar nga prirja estetike, megjithatë edhe shprehjet e gjuhës së përditshme janë të prira drejt një «kursimi gjuhësor shumë të thellë»¹⁸. Kështu në vend që të thuhet: Vani ishte nga nxënësit më të mirë të *nxënësve* (që ishin) në klasë (ose: të klasës); kurse ne jemi varrmihësit më të mëdhenj të *varreve të botës* (në botë); Ky është ndoshta shteti më i vetmuar i *shteteve* (që janë) në botë (a: të botës); Kjo është historia më e vjetër e *historive të Skënderbeut* etj. thuhet: Vani ishte nga nxënësit më të mirë të *klasës* (F. Gjata, Në pragun, 163); kurse ne jemi varrmihësit më të mëdhenj të *botës* (I. Kadare, Gjenerali, 34); Ky është ndoshta shteti më i vetmuar në *botë* (po aty, 25); Kjo është historia më e vjetër e *Skënderbeut* (F. Noli, HeS, 10/1921) etj. Vetëkuptohet që grupi i synuar, e tëra ku bën pjesë elementi, të cilit i shkallëzohet cilësia, nuk është asnjë nga fjalët e nënvizuara herën e dytë. Këtu, në vend që të dalë emri i grupit të synuar në gjindore a në një rasë tjetër parafjalore, përkundrazi del në këtë rasë emri i vendit, ku ndodhet grupi, a emri i «pronarit» të cilit i përket grupi. Kështu që në shembujt: fitorja e Frontit Demokratik më 2 dhjetor është më e rëndësishmja që kemi pasur gjer më sot në kohë paqe (S. Luarasi, Fjala, 58); Rruga gjer në Kënetë iu duk rruga më e gjatë që pati bërë ndonjëherë (J. Xoxa, Lumi, III, 218); kjo i dukej atij më e bukura simfoni, që kish dëgjuar gjatë gjithë jetës së tij të gjatë (I. Kadare, Përbindshi, 56) — po ta shikosh hollë-hollë përëmiri lidhor që duhet të rimerr-

18) Cituar sipas W. Havers, *Handbuch der erklärenden Syntax*, Heidelberg, 1931, f. 167.

te jo antecedentin e pranishëm (emrin e elementit në njëjës), por gjymtyrën e dytë të krahasimit që mungon (emrin e grupit në shumës).

Por, duke mos u shprehur emri i grupit në gjindore, ai humbet edhe në ndjenjën e folësit dhe fjalia e varur përcaktore lidhore, në vend që të përcaktojë atë, përcakton elementin pjesëpërbërës të tij, të cilit i shkallëzohet cilësia, p.sh. Dhe kjo ndodhte pikërisht tani që Zefit me shokë i ish besuar puna më delikate dhe më me përgjegjësi, që *mund të bëhej*. (Sh. Musaraj, Para, I, 313). Kjo vepër... është ndofta më e mbaruara që ka parë dritën gjer më sot (F. Noli, HeS, 127). Veç kësaj, duhet pasur parasysh edhe fakti i pamohueshëm që folësi a shkruesi ndërron disa herë planin e ligjërimit, kështu që edhe po të jetë i shprehur emri i grupit, vetëm në rrethana të caktuara fjalia përcaktore ka të bëjë detyrimisht me atë e jo me elementin e tij përbërës.

Si përfundim, do të themi se krahun e dytë të krahasimit mund ta përbëjë gjindorja e emrit të grupit të synuar ose e emrit të «pronarit» të grupit a e vendit ku ndodhet ky grup, por mund ta përbëjë edhe rasa kollëzore me parafjalë e njërit nga këta emra: ndonjëherë edhe përemri pronor (kh. njerinë më të dashur të tij po e përpinte batak — R. Brahim, Katër, 135). Parafjalët përkatëse janë: *në* (ndë), *ndër*, p.sh. ishte më i gjatë *në* atë grup të vogël njerëzish (A. Abdihojha, Tri, I, 302); Ja, ngrihet në tribunë / Njeriu ma i shtrenjtë n'rruzullim (Ll. Siliqi, Vjersha, 11); Por Tirana do t'ish' me siguri më i bukuri *ndër* qytetet e Shqipërisë (V. Kokona, Me valët, I, 22); Turku ishte armiku më i egër *ndër* më të egërit (M. Kuteli, Tregime, 230). M'i forti ndë këtë jetë (Çajupi, Vepra, 142).

Përdoret edhe parafjala *mbi*: O vendi ma i shtrenjtë *mbi* dhe për mue! (Ll. Siliqi, Ringjallje, 31); si ma i miri *mbi* kët dhe (T. Miloti, Zanusha, 34);

Në toskërishte kemi edhe ndërtime me rasën emërore me parafjalën *nga*, p.sh. Një nga këta, bile më i tërbuari *nga* të gjithë, ish një djalosh (Sh. Musaraj, Para, I, 37); Më i dëgjuari *nga* dega e parë ishte Karoll Thopia (F. Noli, HeS, 13). *Nga* gjithë vendet Misiri / ka qen'e është m'i miri. (Çajupi, Baba, 50); por haset edhe tek ndonjë autor gegë p.sh.: Ajo asht ma e mira, ma e bukura e ma e dashtuna *nga* të gjitha! (Q. Guranjaku, Tetë, 90).

Një përdorim gjithmonë e më të gjerë po merr edhe rrjedhorja me parafjalët *midis* e *prej*, p.sh. Më të shënuarit *prej* këtyre ishin (F. Noli, HeS, 42); Ai ishte më plaku *midis* punëtorëve të fabrikës (Abdihojha, Tri, I, 214).

Jo vetëm në ligjërimitin e zakonshëm, por edhe në gjuhën letrare, kur për bashkëbiseduesin është tashmë i qartë si grupi i synuar, ashtu edhe pronari i tij a vendi ku ky ndodhet, shpeshherë kuadri i krahasimit nuk është i plotë, krahu i dytë nuk shprehet fare, p.sh. Na mbetet edhe një turne — tha prifti. — Po. Nëpër male. Ai është më i vështiri. (I. Kadare, Gjenerali, 99).

2.2. Shkalla krahasore e barazisë

Mbiemri në shkallën krahasore të barazisë tregon se cilësia e sendit të karakterizuar prej tij është në një shkallë të barabartë me të njëjtën cilësi tek një send tjetër ose me një cilësi tjetër të të njëjtit send ose me të njëjtën cilësi tek i njëjti send, por në rrethana të tjera ose me një cilësi tjetër tek një send tjetër. Për gjuhën shqipe nuk kemi një formë të veçantë për shprehjen e kësaj shkalle. E ashtuquajtura «formë» e kësaj shkalle është zakonisht e njëjtë me atë të shkallës pohore, por kësaj «forme» mund t'i paravendoset ndajfolja sasiore *aq* ose *kaq*, kur elementi i dytë i kra-

hasimit lidhet me lidhëzën *sa*¹⁹. Hetimi i krahasimit, kur mungojnë *kaq*, *aq*, bëhet i mundshëm pikërisht në saje të pranisë së elementit të dytë të krahasimit dhe të lidhëzës krahasore, e cila duhet të jetë pa tjetër e pranishme, p.sh. shumë vjet kish që e mbanja në sup atë pushkë, po e rëndë sa asaj dite nuk më ishte dukur kurrë (D. Agolli, Zhurma, 60); duke folur për ndjenja të zjarra të *të larta* sa valët e Adriatikut (J. Xoxa, Lumi, I, 150). Anasjelltas, kur mungon elementi i dytë i krahasimit, sepse është i nënkuptueshëm nga bashkëbiseduesi, atëhere ndajfoljet *aq*, *kaq* janë të domosdoshme për të shprehur krahasimin, p.sh., Kombi shqiptar s'është komp për të pasur turp prej tij; të qënët e një njeriu nga një komp *kaqë trim e kaqë i xgjuarë*, s'është turp, po është nder i madh (S. Frashëri, Shqipëria, 91); Ai njeri *aq i dobët* nga shëndeti përpara Gjiks ngjallej, rritej, forcohej e bëhej çelik (S. Spasse, Ata, 12); Ferdinandi, i çliruar me një herë prej një rreziku *aqë të math*, hapi dyert (F. Noli, HeS, 233/1921).

Ndajfoljet sasiore nuk kanë përfunduar aspak në fjalë shërbyese; ato ruajnë pavarësinë e tyre, duke pësuar vetëm zbehjen e zakonshme të theksit që pëson elementi i parë i togfjalëshit. Pra, del se kjo shkallë përligjet vetëm semantikisht, por jo morfologjikisht. Ndajfoljet e përmendura i pavarëndosen formës pohore të mbiemrit barabar si edhe një foljeje çfarëdo. Për arsye afektive këto edhe mund të theksohen e madje të dalin në plan të parë, duke lejuar kështu të futet midis tyre dhe trupit të mbiemrit një element tjetër. Edhe këto ndajfolje mund t'u shërbejnë dy a më shumë formave mbiemërore, pa u përsëritur para secilës. E për të hetuar, nëse ndajfolja shkallëzuese u takon gjithë formave apo njërës a disave prej tyre, ndihmohemi nga konteksti përkatës dhe nga semantika e mbiemrave, p.sh. Ne krenohemi që kemi një aleat e një mik *kaq besnik e të fuqishëm* (Zëri i pop., Rap. i shokut E. Hoxha, 15/IX/67,6); A ishte *aq e bukur dhe e mirë* sa e bënin të tjerët? (N. Jorgaqi, DeM, 47); Ballabani ishte *aq trim dhe i zoti* në luftë sa Skënderbeu (F. Noli, HeS, 245/1921).

Prania e ndajfoljes sasiore ka më tepër qëllim theksimi dhe në gjuhën e folur popullore është më i rëndomtë përdorimi pa ndajfolje (kh. dua të më bënë dy shandanë të mëdhenj, edhe të gjatë sa mua. (Mbledhës, I, 276).

Gjymtyra e dytë e krahasimit mund të lidhet me lidhëzën *sa ose si*, p.sh. kish një principatë pothua *aq të gjërë sa të Skënderbeut* (F. Noli, HeS, 140/1921); Shqipëtarat, *aqë të hjeshime sa edhe të nderçime*, më tepër se burrat e tyre edhe, pothua, *aq trime sa edhe ata*, vështrojnë vetëm për vetëm punët (S. Frashëri, Shqipëria,.... 41); Një periudhë *aq e ndritur* e historisë sonë *si ajo* e Skënderbeut përmblihet në disa faqe (J. Malo, Përmirësimi... Zëri i pop., 25.I.66,2). Këta janë Pirrua dhe Aliu. Ka edhe të tjerë, po jo *aq të rrezikshëm si këta* (N. Jorgaqi, DeM, 91); Nuk është shkruar një libër *aq'e lezeçime* dhe e çuditëme *si kjo* (F. Noli, Don Kishoti, 61). Midis këtyre dy lidhëzave ka një dallim të qartë. Kur përdoret lidhëza *sa* kemi barazim të cilësisë vështruar në sasinë e saj, d.m.th. që të dy gjymtyrët e krahasimit e kanë në të njëjtën masë cilësinë e dhënë. Kur përdoret lidhëza *si*, cilësia e gjymtyrës së parë (tërthorazi dhe masa e saj) iden-

19) Kjo «formë» e dytë e shoqëruar me këto ndajfolje përmendet së pari nga F. Rossi, *Regole grammaticali della lingua albanese*, Roma, 1866, 323 dhe ridel përsëri tek G. Jungu, *Elementi grammaticali della lingua albanese*, Scutari, 1881, 32, duke u lënë kështu në heshtje nga G. De Rada, A. Dozoni — po dhe nga Kristoforidhi e Gj. Pekmezi. Siç do të shohim, meqënëse kjo «formë» nuk përligjet morfologjikisht, është më i drejtë qëndrimi i autorëve që nuk e përmendin si formë, por megjithatë duhej përmendur si mënyrë shprehjeje e shkallës përkatëse.

tifikohet me atë të gjymtyrës së dytë, e cila duhet të jetë (ose së paku kë-shtu paramendohet nga folësi) e njohur edhe nga bashkëbiseduesi.

Jo rrallë, duke u nisur nga gjeneza e ndajfoljes pyetëse *sa*, kemi një përdorim specifik në gjuhën shqipe — kjo ndajfolje, duke kaluar nga ligjërata e drejtë në ligjëratën e zhdrejtë, bëhet korelative me ndajfoljen *aq*, merr afërsisht një funksion lidhëzor, bëhet më tepër një ndajfolje marrëdhënore. Pra, në ndërtimet *sa... aq*, gjymtyra e përcaktuar nga *sa* merret si e njohur nga ana e folësit dhe, me ndihmën e saj, ai përcakton masën e cilësisë së gjymtyrës tjetër; kështu që ndërrimi i vendeve *sa* dhe *aq*, vërtet lë të pandryshuar raportin e barazisë, por roli i gjymtyrëve ndërron, përcaktuesja bëhet e përcaktuar. Këtej dalin ndërtime të tilla: Duken *sa guximtarë aq edhe krenarë* (H. Stërmilli: Shtigjet, 169); Me Besimin djaloshin e lidhte një histori *sa e ndërlikuar aq dhe e papëlqyer*. (A. Abdihoxha, Tri, I, 8); Fytyra e tij *sa e rreptë aq e kandëshme dhe e mallshme* më siellet gjithmonë përpara syve të mi (H. Mosi, Cubat, 91). Ky rend i përmbysur *sa... aq...* në vend të rendit të zakonshëm *aq... sa* është një veçori specifike e shqipes, të cilën, me ç'na rezulton neve, s'e kanë simotrat e tjera indoevropiane të saj (kh. rendin e ngulitur të këtyre gjuhëve: rus. *stolbko... skolbko...*, gjerm. *so... wie...*, *ebenso... wie...*, frengj. *aussi... que...* angl. *so... as...*, it. *tanto (altretanto)... quanto...*).

Por në disa të folme e tek ndonjë autor, për ta treguar më qartë kundërvënjen antonimike të mbiemrave që krahasohen, në vend të ndërtimeve *sa... aq...* përdoret ndërtimi me ndajfoljen *aq* të përsëritur, duke e pasur të domosdoshme një fjali krahasore midis tyre, p.sh. *Aq i rrefkët sa është me prindët ose me shokët e radhës së tij, aq i shtruar është me anëtarët e partisë* (Sh. Musaraj, Para, I, 366).

Mbiemri në shkallën krahasore të barazisë mund të shoqërohet nga pjesëza përforcuese *po*, e cila, kur nuk pason një fjali të prirë nga lidhëza krahasore *sa*, nuk mund të hiqet pa ndryshuar sadopak mbrendinë leksikore të shprehjes, sepse kjo, si të thuash, zëvendëson deridiku pikërisht atë fjali, p.sh.: Nga ana e tyre antilëkunditorët u treguan *po aq të gatshëm*, duke zgjedhur si të deleguar Gutkovin (Stalin, Vepra, III, 272); Qielli ishte *po aq* i mvrejtur dhe i lartë vetëm se tani dielli kish mundur të çfaqej (I. Kadare. Përbindshi, 40). Në rastet kur fjalia a gjymtyra pasuese krahasore me *sa* është e pranishme, pjesëza *po* përdoret si përforcuese, p.sh. Po tashti, a do të ketë të tjerë *po aq* të vendosur sa Stas Vasili (A. Abdihoxha, Tri, I, 213); Ai... më dëgjonte me vëmendje sikur të isha *po aq e pjekur dhe e rrahur* në jetë sa ai (V. Vinçani. Lumturia, 93).

Veç rasteve kur gjymtyra e dytë e krahasimit nuk shprehet, sepse është tashmë e qartë si për folësin ashtu edhe për bashkëbiseduesin e tij, elementi i dytë mund të mungojë edhe kur shprehja ka vlerën: *barabar (njëlloj) + mbiemër*, p.sh. Se gruaja lindte fëmijë / Por pushka lindte kris-më, / dhe për shqiptarët ishin / *Po aq të shtrenjta* të dyja; / Dhe krisma dhe fëmija. (I. Kadare, Përse, 47). (kh. Gjithë ky trazim i pa prituri i ngjalli përfytyrime djaloshare, kur ish *njëlloj i zoti* për pela dhe për... (J. Xoxe, Lumi, III, 275); ose kur folësi e shoqëron ligjërimin e tij me gjeste, përmes të cilave e bën plotësisht të qartë gjymtyrën e dytë të krahasimit, p.sh. s'ka ditë që të mos shkoj në zhukë nga tre e katër, na, *kaq të mbëdhenj...* dhe preu krahun me dorën tjetër, në atë vënd ku ju duk se mund të arrinte bishti i qefullit. (J. Xoxa, Lumi, I, 205) — për lexuesin këtë plotësim e saktësim e japin fjalët e fjalitë që pasojnë.

Kur sendi që përbën gjymtyrën e dytë të krahasimit, është i pranishëm ose është tashmë i njohur nga *sa* është thënë rreth tij, krahasimi

i mangët është shumë i rëndomtë e madje në mjaft raste i vetmi i mundshëm. Kjo vërejtje vlen për të gjitha rastet e shkallës krahasore. Duhet pasur parasysh që mosshprehja e elementit të dytë të krahasimit të shumtën e herës është një fenomen logjik, pra, ky element është gjithmonë i nënkuptuar, por gjuhësisht jo gjithmonë i shprehur; pra edhe kur nuk është i shprehur, kjo nuk do të thotë aspak se ai pa tjetër ka rënë nga përdorimi i shpeshtë. Afërsia e sendit tashmë të njohur shprehet me përdorimin e ndajfoljes sasiore *kaq*, kurse për sendet tashmë të njohura, por që ndodhen larg folësit, pra për largësi, përdoret ndajfolja *aq*, p.sh. një komp *kaq i mënçim* (sa kombi shqiptar — A. Dh.) e me një gjuhë *kaq të bukurë* (sa gjuha shqipe — A. Dh.) të humbasë nga padija e nga të mos pasurë gjuhë të shkruar (S. Frashëri, Shqipëria, 93). Fjalët në kllapa janë plotësisht të tepërta për lexuesin — ai e di fare mirë që bëhet fjalë për kombin shqiptar, shqipen e Shqipërinë. Por shpesh kjo rregullësi edhe thyhet; më tepër përdoret *aq*.

Shpesh ky krahasim i mangët e humbet lidhjen e nënkuptueshme me elementin e dytë e të pashpëhur të krahasimit dhe mund të mos shikohet më si krahasim, si «formë», që kërkon një korelat, por si «formë» e mëvetëshme dhe si paralele me *mjaft (shumë) + mbiemër në pohore*, por folësi parapëlqen format me *aq, kaq*, sepse dëshëron ta shprehë cilësinë në një masë *aq të lartë*, sa që s'gjen asnjë ndajfolje sasiore intensifikuese të gradës së cilësisë, të mjaftueshme për këtë qëllim, kurse këto të dyja lejojnë nënkuptimin e një fjalie rrjedhimore (sa...) që përjashton çdo krahasim e që tregon cilësinë në shkallën më të lartë që mund të ekzistojë (shih më poshtë tek Përdorimet e shkallëve të mbiemrit). Pra, kur themi: Nuk asht e vërtetë se jeni *aq e sëmuni*. (H. Stërmilli, Sikur, 153) — e marrë veçmas, kjo mund të shikohet si paralele me *mjaft e sëmuni, shumë e sëmuni* etj., por po të jetë përgjigje e mendimit: «Doktor, jam shumë e sëmuri, jam në rrezik etj.», atëhere kjo formë do të merret vetëm si krahasim barazie i cunguar e jo ndryshe, pra: Nuk asht e vërtetë se jeni *aqë e sëmuni, sa thoni*. Kjo tregon rëndësinë e kontekstit. (kh. edhe: *Ç'kaq'e holla, ç'kaq e gjata, ç'kaq'e donatosurë?* s'më sheh o babai imë, se nuse jam nisurë? — Mbledhës II, 67).

Kur folësi është në mëdyshje për pohimin a mohimin e barazisë së tiparit, atëhere para formës së shkallës krahasore të barazisë del fjala *edhe, dhe*, e cila merr vlerën e një pjesëze stilistikisht (kuptimisht deridiku) të domosdoshme. Ajo nuk e ka aspak vlerën e saj shtuese, por vetëm për së largu të nënkuptuar nga bashkëbiseduesi, p.sh. përshkrimi i jetës seme... do t'i gjasojë nji shtati pa kokë, po të mos përmendi këtu edhe kohët e kalueme — sidomos e arta të fëminisë, me gjith që ato nuk kanë qenë *edhe aq t'arta* për mue. (H. Stërmilli, Sikur... 25-26) — pra, *edhe* kanë qenë *edhe* s'kanë qenë. Nuk ish kohë *edhe aq e gjatë* ajo e stehimit në shtëpinë e tyre (Sh. Musaraj, Para, I, 330); Ata u kthyen duke sjellë lajme jo *edhe aq të këqia* (po aty — 314). Pra kjo formë mund të transformohet në: *deridiku (deri në një farë mase) + mbiemër në pohore* dhe mbarë konstrukti të kthehet në fjali pohore (p.sh. me gjithë që ato kanë qenë *deridiku të arta* për mue etj.).

Edhe forma e shkallës krahasore të barazisë, për efekt theksimi, kryesisht në gjuhën e folur popullore, përdoret edhe e prapanyjzuar, p.sh. Kur ti, o zot, qënëke *kaqë trimi*, unë të jam falë e të kam për burrë. (Mbledhës II, 259). Po t'et i erdhi shumë keq përse i biri qënëkej *kaq frikamani*. (Po aty — 279). Sa për të vrarë atë llamiën *aq të fuqishmen*, duhet të mendojnë (po aty — 280); Shemo s'ma priste fiqiri të bëheshe *kaq i miri* (popu-

llore — Dozoni, Mbledhës, I, 314 e ka: *kaq i mirë*). Përdorime të tilla duhen mënjeluar nga gjuha letrare.

Siç do të shohim tek vlerat e shkallëve, mbiemri i prirë nga ndajfolja *aq, kaq*, kur mbarë konstrukti pasohet nga një fjali rrjedhimore, ka vlerën e shkallës sipërore²⁰. Në këto konstrukte vendi i ndajfoljes sasiore (a marrëdhënjore) është i qëndrueshëm — midis saj e mbiemrit nuk duhet të futet asnjë element tjetër. Megjithatë hasen aty-këtu shkelje të kësaj norme, kur folësi dëshiron të theksojë në mënyrë të veçantë anën sasiore të cilësisë, pra në shprehje afektive, p.sh. Më njëzet vjet shkronjatë shqip lëshuan *aq* rrënjë të *shëndosha* e *zun' aq* themele të *fortë*, sa s'mund të shuhet' e të rëzohet kurrë (S. Frashëri, Shqipëria, 55); *Aq* është e *vërtetë*, sa një djalë... më dërgoi në vend të letrës së fundit katër vargje (R. Brahim, Katër vajzat, 139); u fut përnjëherë nën batanije dhe *kaq* e ndjeu veten të *dërmuar*, sa s'do t'ishte në gjendje të lëvizte (Sh. Musaraj, Para, II, 272); *Ish e çelur dhe e gëzuar aq* sa Dekua nuk e kish parë prej kohësh (po aty — 372)²¹; Ne e ndjejmë veten të lumtur që Komiteti Qendror i PPSH i çmon me *kaq* zemër të *gjërë* rezultatet e para të punës sonë. (Buletin i Institutit të Shkencave, I/1949/, 4). Përdorimet e këtij tipi të fundit janë mjaft të përhapura në gjuhën popullore si për rastet me *kaq* e *aq*, ashtu edhe për shkallën sipërore me *shumë* etj. (shih më poshtë).

Këtu nuk duhet të ngatërrohen përdorimet e mësipërme me rastet, kur kemi përemër të pakufishëm (*aq, kaq*) + *emër* + *mbiemër në pohore*, p.sh. Pas takimeve të para që Mimosës i sollën *aq* shqetësime *t'ëmbëla*, ajo u dha (N. Jorgaqi, DeM, 140).

Po për efekt teksimi ndajfoljet sasiore *aq, kaq* përdoren në bashkë-vajtje me *shumë, tepër* etj., p.sh. e mbëreti, q'ishte gjerë mbë sod *aq shumë* i *pikëlluar* për humbjen e çupës... mbëlodhi gjithë parësinë (Mbledhës, II, 182); *Aqë shumë* i *shëndosh'* ishte / sa një-qint burra ta zinin / aju brengë nukë kishte (N. Frashëri, HeS, 32); Ajeti hëngri darkë shpejt u shtri në shtrat *kaq shumë* e ndjen veten të *lodhur* (Sh. Musaraj, Para, II, 352). Kjo formë është karakteristike kryesisht për gjuhën e folur dhe përdoret kur duam të vëmë një theks të veçantë mbi anën sasiore të cilësisë. Është më e lejueshme kur pason një fjali rrjedhimore (*aq... sa që*). Për të njëjtat arsye ndodh edhe përsëritja e kësaj ndajfoljeje, p.sh. Dhe nuk di se si u përqaftuan / se si u puthëm *aq e aq të nxehët* (D. Agolli, Në rrugë, 50); E ndjehet *aq / aq* vetmitare / në gjumë kur merr me ra (Ll. Siliqi, Ringjallja, 39).

2.3. Shkalla krahasore e ultësisë.

Nën ndikimin e gjuhëve të huaja ka hyrë në gjuhën letrare shqipe një mënyrë shprehjeje, e cila është quajtur shkallë krahasore e ultësisë dhe ka plotësisht vlerën e kundërt të formës së shkallës krahasore të sipërisë relative²². Midis tyre ekziston një paralelizëm antonimik i plotë. Si rrjedhim, mbiemri në të ashtuquajturën shkallë krahasore të ultësisë tregon se

20) Një gjë të tillë e ka vënë drejt në dukje Sh. Demiraj, *Morfologjia*, I, 73.

21) Për konstruktet rrjedhimore të këtij tipi shih hollësisht: S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, «Stud. filol.», 2/1965, 55 v.

22) Ndër gramatikat e shqipes kjo formë del së pari tek J. Jungg, *vep. e cit.*, 32 (*ma pak i diuëm, ma pak fajtur*)-ai thekson njëkohësisht: «Por të thuash të vërtetën më shpesh shndërrohet në krahasoren e sipërisë, duke u thënë më drejt *ma i paadishm* «ma injorant» dhe në mënyra të tjera të ngjashme»; e shënon edhe K. Kristoforidhi, *vep. e cit.*, 33 (*më pak e madhe / më pak i bukurë*). Mendimin e J. Junggut e përsërit edhe A. Xanoni, *Gramatika*, 60.

cilësia e një sendi të karakterizuar prej tij është në një shkallë më të ulët se e njëjta cilësi tek një send tjetër, ose se një cilësi tjetër tek i njëjti send, ose se e njëjta cilësi tek i njëjti send, por në rrethana të tjera, ose se një cilësi tjetër tek një send tjetër.

«Forma» e kësaj shkalle ndërtohet duke i paravendosur formës së shkallës pohore lokucionin ndajfoljor *më pak* (që origjinarisht është shkalla krahasore e ndajfoljes *pak*), i cili i përgjigjet plotësisht funksionit të pjesëzës *më* të shkallës krahasore të sipërisë (kh. edhe gjerm. *weniger / minder* / gut; angl. *less* usefult; frëngj. *moins* bon — ndryshimi konsiston në faktin që këto gjuhë kanë ndajfolje të thjeshtë, më drejtë formë sintetike të shkallëzimit të ndajfoljes, ndërsa shqipja lokucion ndajfoljor — formë analitike shkallëzimi të ndajfoljes së paravendosur). Këtej del e njëjta vërejtje që bëme edhe për shkallën krahasore të barazisë, që edhe kjo «shkallë» përligjet vetëm në planin semantik, por jo në planin morfologjik, p.sh. Nuk kujtoj se mund të guxojë kush me pretendue se fusharaket ose malsorët tona janë... *ma pak të ndershme* se sa qytetaret. (H. Stërmilli, Sikur, 144); Duke e marrë me mend se ky komunikim «me rëndësi» nuk do të ish *më pak i shkurtër* se «komunikimi i shkurtër» javën e kaluar (M. Kallamata, Gjambat, 4); Në punërat e në mjeshtërit Shqiptari s'është *më pak i zoti* se në luftët e në ditarit (S. Frashëri, Shqipëria, 40); Në dy nëngrupet e tjera përqindja e punëtorëve me mëditje është *më pak e lartë* në grupin II në krahasim me grupin e I. (Lenin, Vepra II, 425); Pse nuk e bën si ai shoku yt, që nuk ishte *më pak i zgjuar* nga ti (Sh. Musaraj, Para, I, 210); Un fillova tani të bëhem *më pak i afrueshëm*, të përmblihem në vetvehte (Dh. Shuteriqi, Gurnecka, 163).

Lokucioni ndajfoljor *më pak* mund të intensifikohet me ndajfoljen e sasisë *shumë*²³, e rrallë me ndonjë tjetër. Ky fakt, që ndërsa tek shkalla krahasore e sipërisë relative ndajfoljet përforcuese i paravendosen mbarë formës (*shumë + më i mirë*), në të ashtuquajturën shkallë krahasore të ultësisë këto ndajfolje i paravendosen jo tërë shprehjes, por vetëm lokucionit ndajfoljor (*shumë më pak + i mirë*), tregon qartë që këtu morfologjikisht s'kemi një formë të vetme, por dy elementë leksikorë të mvetësisshëm. Lokucioni ndajfoljor *më pak* mund të intensifikohet si fjalë e paravarur.

Lidhëzat që përdoren për elementin e dytë të krahasimit, siç duket edhe në shembujt e mësipërm, janë po ato që përdoren edhe për shkallën krahasore të sipërisë. Edhe këtu mund të mungojë ky element, kur është tashmë i njohur prej bashkëfolësit. E ashtuquajtura shkallë krahasore e ultësisë, siç thamë në sipër, është kryekëput e gjuhës letrare dhe nuk përdoret në gjuhën popullore²⁴. Populli nuk thotë: Ai është *më pak i mirë* se ti, por: Ai (nuk) s'është (*aq*) *i mirë* sa ti — ose kalon në planin e kundërt. — Ai është *më i keq* se ti. Në planin e kundërt kalohet kryesisht kur sendit të dhënë i mohohet zotërimi i cilësisë në shkallën krahasore të ultësisë për t'ju pohuar logjikisht në shkallën krahasore të barazisë, p.sh. në vend të formës: Unë nuk jam... *më pak trim* se ata (V. Vinçani, Të rinjtë, 21) — populli do të thoshte: Unë nuk jam *më frikacak* se ata — për të mos u mburrur me formën: Unë jam *po aq trim* sa ata. Përveç këtyre dy mënyrave, gjuha e folur përdor në disa raste edhe atë që përmend Junggu

23) Shih Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, I, 74.

24) Sh. Demiraj vëren se «në gjuhën shqipe shkalla krahasore e ultësisë e ndërtohet në këtë mënyrë nuk përdoret fort. Përdoren më shumë ndërtime të tilla: Hamzai s'ishte (*aq*) *trim* sa Skënderbeu» — po aty.

e që ritrajton edhe Xanoni: «*Ma pak i dijshëm* jam un se ti. — Por zakonisht e laam jasht fjalëzën *pak* e n'kambë t'saj përdorim adiektivin mohenik (antonimin e mbiemrit i *diishim* — A. Dh.) tui ja vu përpara adverbën *maa* b.f. unë jam *ma i padishim* se ti»²⁵. Duhet thënë se, megjithëse gjuha e folur si edhe gjuha letrare jo mjaftësisht e formuar e përdor këtë zhvendësim, ky s'është aspak i drejtë, sepse në rastin e parë (*më pak...*) ne, përmes formës mbiemërore, pohojmë *qenien të ditur* të të dy palëve, kurse në të dytën *qenien të paditur* të tyre.

Edhe kjo «formë» mund të përdoret e shoqëruar me fjalëzat *sa... aq...* për të treguar rritje proporcionale të cilësisë së shprehur nga mbiemri, p.sh.: *Sa më tepër copëtohet toka, aq më pak* pjellore ajo bëhet. (Marks-Engels, Vepra I, 195).

Mendojmë që kjo «formë», meqë nuk ka bazë popullore të mos përdoret me vend e pa vend, por vetëm në rastet ku është stilistikisht e domosdoshme; nga ana tjetër nuk jemi për mënjanimin e plotë të kësaj forme edhe nga gjuha letrare, sepse kjo mënyrë shprehjeje është gjerësisht e përhapur në këtë gjuhë dhe, nga ana tjetër, në disa raste e jep më të saktë se mënyrat e tjera përcaktimin e shkallës së cilësisë përkatëse.

* * *

Nga gjithë sa pamë rreth shkallës krahasore, del se cilësia në këtë shkallë merr tashmë vlerë relative. Kur themi: Petriti është *më i urtë* se Shpresa etj. — akoma s'do të thotë se Petriti është *i urtë*, por vetëm *i urtë* në raport me Shpresën, në krahasim me atë — e siç thotë V. Vinogradovi, këtu «vetë cilësia duket sikur humbet, zhduket në krahasimin e pafund të fenomenit»²⁶.

3. SHKALLA SIPËRORE

Mbiemri në të ashtuquajturën shkallë sipërore tregon se cilësia e sendit të karakterizuar prej tij është në një shkallë shumë të lartë (po jo në më të lartën) dhe se kjo cilësi për nga shkalla e saj kundrohet jashtë çdo krahasimi, jashtë çdo marrëdhënjeje me shkallën e kësaj cilësie tek ndonjë send tjetër (a tek sendet e tjera). — Thamë që nuk tregon se cilësia është në shkallën më të lartë, sepse mund të themi: Çlodhja është *shumë e mirë*, por puna është *më e mirë* — e këtu kuptimisht tipari i shprehur me shkallën krahasore të sipërisë relative është në një gradë më të lartë se tipari i shprehur me shkallën sipërore.

Vërejtëm më sipër se shkallëzimi në shqipen është analitik. Dihet se analitike janë në sistemin gramatikor të shqipes edhe kohët e përbëra të foljes (në mënyrën dëftore — që nga e *kryera*, dhe e *ardhshmja* — si dhe *mënyra lidhore*, *kushtore*; format e pashtjella — *përcjellorja* e *paskajorja*). Ndryshimi midis shkallëve të mbiemrit dhe këtyre formave analitike të foljes qëndron pikërisht këtu: ndërsa tek foljet në rastet përkatëse përdoren fjalë shërbyese, të cilat brenda formës përkatëse nuk kanë kuptim leksikor të pavarur, tek mbiemrat për formimin e shkallës sipërore (si edhe tek shkalla krahasore e barazisë dhe e ultësisë) përdoren mjete *leksikore* me funksionin e fjalëve shërbyese, por që ruajnë të gjitha karakteristikat e pavarësisë së tyre leksikore.

25) A. Xanoni, *Gramatika*, 60.

26) V.V. Vinogradov, *vep. e cit.*, 243.

Deri tani në mbarë gramatikat tona format: *shumë* (mjaft, jashtëzakonisht, fort, tepër etj.) + *mbiemër në pohore* janë trajtuar si forma të shkallës sipërore absolute, pa u shoqëruar me ndonjë vërejtje kritike nga pozitat morfologjike-formëformuese²⁷.

Që ndajfoljet e lartpërmendura të fitojnë funksionin *formë-formues* (shkallëformues), që të bëhen, pra, element përbërës i një forme analitike që vështrohet morfologjikisht si një formë e vetme, si një njësi e vetme morfologjike, duhet të shndërrohen në *morfema* qoftë ndihmëse, qoftë të vetmjaftueshme, pra duhet të përfundojnë në mos në pjesëza, së paku në fjalë shërbyese që brenda formës së dhënë nuk kanë kuptim leksikor të pavarur. E që këto ndajfolje të përfundojnë në fjalë shërbyese ne mendojmë se duhet të përmbushin këto kushte: a) në mos ta humbasin krejt, t'u zbehet theksimi i tyre i zakonshëm; b) t'u zbehet kuptimi dhe c) të fitojnë një pozicion të ngulitur ndaj trupit të mbiemrit.

Po t'i shqyrtojmë këto kushte tek «forma» e shkallës sipërore do të bindemi se asnjëri prej tyre nuk plotësohet.

Të gjitha ndajfoljet që përdoren në këtë funksion ruajnë theksin e tyre të zakonshëm — duke mos marrë parasysh këtu faktin e pamohueshëm e të përgjithësuar në shqipen që në çfarëdo togfjalëshi elementi i parë humbet diçka nga theksimi i tij i zakonshëm dhe theksi i togut bie mbi elementin e dytë, (kh. *djalë* i *mirë* dhe: ai është i *mirë shumë*, ku *djalë* dhe i *mirë*, gjithë duke humbur diçka nga theksi i tyre i zakonshëm, nuk pushojnë së qeni fjalë të mvetësishme edhe nga pikëpamja e theksit). Këtu duhet pasur parasysh theksimi i zakonshëm, normal e jo afektiv, emocional, ku mund të theksohet bile edhe pjesëza *më* e krahasores së sipërisë, p.sh. Ai tash më duket *ma* i ambël, *ma* i shoqnueshëm dhe *ma* i afër ke zemra eme. (H. Stërmilli, Sikur, 122); Duke qenë *më* të kujdesur, *më* të fuqishëm, *më* të bashkuar, *më* të dhëmshur, *më* besnikë, *më* me plot shpresë dhe guxim, ne do t'ia hedhim godinës kombëtare ndërtimin mbi themele të forta. (S. Luarasi, Fjala shqipe, 130).

Të gjitha ndajfoljet e përdorura për këtë funksion ruajnë plotësisht të pazbehur kuptimin e tyre leksikor — shfaqjen e sasisë; për këtë na bindin jo vetëm ndajfoljet e lartpërmendura (kh. Nuk e merr dot me mend, Marina, sa *shumë* e gëzuar jam. (V. Vinçani, Lumturia, 51), ku *shumë* zbërthen, konkretizon kuptimin sasior të *sa* në rastin e dhënë — populli thotë: *sa e gëzuar*. . .), por, edhe krijimet e mëvonshme, si *thellësisht* vëllazëror», *thellësisht* revolucionar», «*çuditërisht* i bukur» etj. e për më tepër emrat e ndryshëm që përdor gjuha e folur (e që i ka për-qafuar në masë edhe gjuha letrare) *akull*, *dëborë*, *qumësht*, *sterrë*, *pis*, *çelik* etj.

Përsa i përket topikës, këto ndajfolje mund të vendosen para ose prapa formës pohore të mbiemrit. Pavarësisht nga fakti që midis këtyre dy përdorimeve nuk ka barazi për nga dënduria e tyre e që vendosja pas formës pohore është e kushtëzuar stilistikisht — këto ndajfolje vendosen prapa kryesisht për të theksuar shkallën e intensitetit të cilësisë — këtu rëndësi ka fakti që këto ndajfolje kanë mundësi sintaksore për

27) K. Cipo ka shënuar shprehimisht që shqipja shkallët krahasore dhe sipërore detyrohet t'i formojë vetëm perifrastikisht me mjete leksikore (76); Sh. Demiraj pranon që elementi i parë i formës është ndajfolje (75), por në tekstin për shkollat pedagogjike (1962, 77) quhet ndajfolje edhe pjesëza *më*; Xanoni i quan fialza (60); Xhuvani s'mban qëndrim; Myderrizi gjithashtu (76); Sheperi i quan ndajfolje, por ai edhe pjesëzën *më* ndajfolje e quan (49).

t'u vendosur para e pas (kurse kushtëzimi i mësipërm s'ka rëndësi, sepse ekziston edhe kur karakterizohen veprime: *punon shumë — shumë punon*), p.sh. Ja nji shtëpi e *bukur fort* dikur e tash si qyqe (Ll. Siliqi, Ringjallja, 14); Jam i *dërmuar fare* shpirtërisht, (N. Jorgaqi, DeM, 92); faqet i skuqeshin e i bëheshin si kokërrzat e ndonjë shege të *arrirë shumë* (Th. Kacorri, Ditë, 16).

Me gjithë këtë liri për t'u vendosur para e pas mbiemrit në pohore, përdorime të tilla: Ti je *shumë* njeri i *poshtër*, Aleks - i tha ajo (F. Gjata, Kënetë, 468); Je *shumë* njeri i *mirë!* (po aty, 484); putheshin, përqafoheshin si dy vëllezër të ndarë njëri nga tjetri pas *shumë* kohe të *gjatë* (F. Postoli, Për mprojtjen, 142). Në këtë luftë *shumë* u rrëfye *trime* fëmij' e Aliut (N. Frashëri, Istori e përgjith. 64), të cilat në të vërtetë janë shumë popullore, nga pozitrat e gjuhës letrare duhen vlerësuar si shkelje të rregullave të topikës në gjuhën shqipe.

Si përfundim të gjitha ndajfoljet e përdorura si intensifikuese sasiore të shkallës pohore (për të treguar shkallën e intensitetit të cilësisë së shprehur nga mbiemri i dhënë) a për ta formuar «formën» kuptimisht sipërore, nuk kanë përfunduar aspak në fjalë shërbyese, por ruajnë plotësisht kategorinë e tyre ndajfoljore. Si rrjedhim nga pozitrat morfologjike shkalla sipërore (si edhe shkalla krahasore e barazisë dhe e ultësisë) nuk ka një formë të vetën, jo sepse e ashtuquajtura formë e saj është analitike por sepse elementët përbërës të kësaj «forme» ruajnë mëvetësinë e tyre semantiko-morfologjike e bile sintaksore. Megjithatë, ndërsa ekzistenca e «formës» së shkallës sipërore në gjuhën shqipe mund të mohohet me të drejtë nga pozitrat morfologjike, bashkëvajtja funksionale e këtyre dy komponenteve përbërëse dhe njësia kuptimore që del nga kjo bashkëvajtje është e pamohueshme edhe për gjuhën shqipe. Kështu që nga pozitrat semantike ekzistenca e shkallës sipërore, ashtu si për çdo gjuhë tjetër, edhe në shqipen nuk mund të mohohet, por kjo nuk mjafton për ta pranuar sipëroren si shkallë më vete. Atë në gjuhë të tjera, si p.sh. latinishtja (kh. *remedium utilissimum omnium* (remediorum); *facillimus-a-um*; *difficillimus-a-um*) e shprehin me një formë të vetme sintetike, shqipja e shpreh analitikisht me elementë të mëvetësishtëm, pra leksikalisht. Në këtë kuptim është i drejtë mendimi i Pekmezit që këto «forma» janë transfigurime të shkallëzimit «me anë të shprehjeve e lokucioneve përkatëse si në gjuhë të tjera»²⁸.

Këtej del se për shprehjen e kuptimit të shkallës sipërore gjuha shqipe përdor formën e shkallës pohore të mbiemrit të dhënë të prirë nga ndajfolje të ndryshme sasiore, të cilat nuk janë gjithmonë sinonimike midis tyre; ato bashkohen në një grup vetëm në një vështrim mjaft të gjerë si fjalë shkalle (intensifikuese të cilësisë) (kh. p.sh.: Dhimitër Shuteriqi... shkon midis minatorëve të Rubikut, për të gjetur tema e heronj *krejt të rinj*, nga ata që ka gjetur gjer tani për veprat e tij (Shkrimtarët shkojnë... — Zëri i Pop. 17.2.66,1) — ku ndajfolja *krejt* nuk mund të zëvendësohet nga ndajfolje të tjera pa ndryshuar kryekëput kuptimin. E këtu (tek ruajtja e plotë e semantikës së secilës ndajfolje) del një mos-përputhje themelore midis formave sintetike (p.sh. të latinishtes) dhe «formave» në fjalë të shqipes.

Ndajfoljet më të përdorshme në këtë funksion janë: *shumë*, *fort*, *mjaft*, *krejt* (*kryekëput*), *jashtëzakonisht*, *fare*, *tepër*, *keq*, *bukur*. P.sh. me të vër-

28) Gj. Pekmezi, *vep. e cit.*, 121.

tet po të shof *shumë të shqetësuese* (S. Pitarka, Trimi, 24); Bagëtia e kafshëtë janë të shumta edhe egërsiratë e shtazët e dëmçme *fort të paka e të rralla*. (S. Frashëri, Dheshkronjë, 25); E vërteta e thatë është *krejt e ndryshme*. (F. Noli, HeS, 11); E si ia tregoi e ndjeu veten *jashtëzakonisht të qetë e të lumtur*. (F. Gjata, Përmbysja, 47); Kosta për të cilin baheshin të gjitha këto dëfrime pandesh *fare i gëzue*. (Lipi, Pelasgë, 8); Ti, e dashur, je *tepër e kthjellët* për këtë këngë. (I. Kadare, Përse, 65); Po Ganiu nuk e do Latifenë, po shërbëtoren e saj Marron, që ish *keq e bukur*. (K. Floqi, Fe, III); Fjalët m'i paska *bukur t'mdha*. (Moisi Golemi, 84); Qe stolisun me veti *bukur të mira* (M. Logoreci, Historia, 135). Siç shihet edhe nga shembujt, ndajfoljet *keq* e *bukur* si intensifikuese të mbiemrit në pohore përdoren pothuajse kryekëput nga autorë veriorë e kryesisht shkodranë, por për variant stilistik i përdor edhe ndonjë autor i sotëm jugor. Për nga denduria e përdorimit, sipas materialit, këto ndajfolje mund t'i renditnim në këtë mënyrë: *shumë, mjaft, jashtëzakonisht, tepër, fort, fare* etj.

Në gjuhën letrare hasim edhe një numër ndajfoljesh të përdorura në këtë funksion, të cilat, megjithëse nuk kanë marrë ende një përdorim të gjerë, po përhapen çdo ditë e më shumë, sidomos në publicistikë, p.sh.: Uran Rema kish një bindje *çuditërisht të madhe* (Sh. Musaraj, Para, I, 438); ata zbulojnë natyrën dhe politikën *thellësisht agresive* të imperializmit amerikan (H. Lleshi, Shokut Ho Shi-Min — Zëri i Pop., 3. II, 66, I); Hallka e sotme qe e ftohtë, *tmerrësisht* e ftohtë (N. Jorgaqi, DeM, 93); Populli ynë është *plotësisht i ndërgjegjshëm* se për t'i arritur ato duhet një punë e madhe (E. Hoxha, 20 vjet, 80); Ne jemi *absolutisht të bindur* se lëvizja komuniste (po aty, 65); Ka disa që do mos kënaqeshin me një histori *fjesht popullore* (F. Noli, HeS, 5).

Përmendëm më sipër se për të shprehur një shkallë shumë të lartë të cilësisë, gjuha popullore (por mjaft dendur edhe gjuha letrare) përdor përpara formës pohore të mbiemrave emra të ndryshëm lëndemërtues, të cilët në përdorimin e dhënë nuk tregojnë sendin (lëndën) që emërtojnë, por atë cilësi inherente të abstraguar të atij sendi, e cila tek ai gjendet në një shkallë shumë të lartë (në mos më të lartën — së paku për dijen popullore) dhe si rrjedhim rroket menjëherë sa dëgjojmë emrin e sendit. Fakti që këta emra në këtë funksion shprehin një tipar, flet qartë për vlerën mbiemërore të këtyre emrave në funksionin përkatës, për këtë na bindin edhe rastet e shpeshta, ku këta karakterizojnë, njëlloj si një mbiemër në sipërore, emrin e dhënë pa qenë të shoqëruar me mbiemrat përkatës, por duke e marrë këta këtë funksion, p.sh. Të vegjëlit *flakë* nga ftyra e me buzën në gaz shkonin në shtëpinë tjetër (S. Spasse, Ata, 183); Po prapa faqeve të tia *prush*, fshihej një shpirt energjik (Z. Sako, Buka, 40); sikur u ngroh nga ato fjalët «*mjaltë*» të teto Konxhes (J. Xoxa, Lumi, I, 221).

Pra në përdorime të tilla morfologjiksht kemi të bëjmë me emra që emërtojnë sende me tipare cilësore në një gradë shumë të lartë dhe lehtësisht të kapshme.

Në bashkëvajtje me mbiemrat përkatës mëvetësia funksionalisht mbiemërore e këtyre emrave zbehet për shkak të shfaqjes direkte të tiparit të dhënë nga mbiemri përkatës; edhe funksioni sintaksor i tyre ndihmon që nga semantika e vërtetë, *shumë + mbiemër*, të rroket vetëm *shumë*, pra, në dukje u mbetet vetëm funksioni ndajfoljor «shkallëzues». Kështu p.sh. kur dëgjojmë: Kjo shegë është *mjaltë* e ëmbël — tek emri *mjaltë* më parë se çdo cilësi tjetër e tij (ngjyra, viskoziteti, rëndësia etj.) bile edhe së të-

rësia e tij si *send*, prej nesh rroket cilësia kryesore e tij, të cilën ai e ka në një shkallë shumë të lartë (në mos në më të lartën): *ëmbëlsia*. Nga ana tjetër thuhet: i ka faqet *shegë të kuqe*. Gjuha popullore është gjithmonë mjaft konkrete. Emrat e ndryshëm që përdor ajo në këtë funksion, janë jo vetëm nga më të ndryshmit e deridiku të shumtë, por janë edhe në një farë vartësie nga mjeshhtëria e ambienti rrethues i njerëzve që i përdorin. Secili përdor në këtë funksion atë *send* tiparin e të cilit e njeh më mirë, p.sh. atje ku rriten mollët thonë më tepër: i ka faqet *mollë të kuqe*; atje ku nuk rriten aq mollët, por shegët thonë: i ka faqet *shegë të kuqe*, ndërsa atje ku rriten thanët thonë: i ka faqet *thanë të kuqe* (p.sh. *Thanë e kuqe* në fytyrë — A. Varfi. Në tingujt, 76). Sigurisht mjaft prej këtyre i kanë kapërcyer kufijtë e sferave të ngushta të përdorimit dhe janë bërë pronë e mbarë shqipes.

Kjo mënyrë përdorimi është, sikurse vë re me të drejtë edhe Sh. Demiraj, rezultat i një krahasimi (Pra: Ajo u bë e kuqe *si flakë* > Ajo u bë e kuqe *flakë* \approx Ajo u bë *flakë e kuqe* \approx ajo u bë *flakë* (kh. me një fustan të kuq si gjaku — F. Gjata, Zemër, 32; Krahët e zbuluar, të bardhë qumësht F. Gjata, Këneta, 191; Fytyra qumësht e bardhë e zotit Backa — Sh. Musaraj, Para, II, 71). Ky proces duhet menduar më tepër si proces logjik e zanafillës për fenomenin e dhënë e jo që në gjuhë në fillim për çdo tip të tillë është përdorur pa tjetër skema: e kuqe *si flakë* e pastaj është kaluar në mënyrat pasuese — kjo s'është as e argumentueshme as e vërtetë.

Pavarësisht nga fakti se në origjinë është e gjuhës së folur popullore, kjo mënyrë «shkallëzimi» po gjen një përdorim mjaft të gjerë edhe në gjuhën letrare — kemi, pra, një shtrirje të figurës popullore në gjuhën letrare²⁹, p.sh.: nuk mund të quhej ceremonial... sidomos me kravatën *flakë të kuqe* (A. Abdihoxha, Tri, I, 301); E mora në duar, ishte *plumb e rëndë* (I. Kadare, Përbindshi, 38); Ishte një gjumë i *rëndë plumb* (po aty — 48). Këmbëzbathur e të *lagur qull* vrapuan andej nga erdhi zëri (A. Abdihoxha, Tri, I, 89); Mbetet shega *dyll'e mverdhur* (Asdreni, Psallme, 129); T'ëmbël *mjaltë* rushtë si ngaherë (po aty, 24); Vitës i dolën përpara syve çarçafët e pajës, të *bardhë dëborë* e që tani, në mes të asaj errësire *pus të zezë* po i dukeshin (J. Xoxa, Lumi, III, 245); A kur hapen herë herë / Ret'e *zeza sterrë* nd'erë. (N. Frashëri, Lulet, 3); Ishte ba *limue i verdhë* (Sh. Musaraj, Para, I, 408); Filozofi u bë *prush i kuq* në fytyrë (po aty); Ai ndjeu... avullin e çfrytjeve *prush të nxehtë* (J. Xoxa, Lumi, III, 288); buronin puse me ujin *brisk të ftohët*. (J. Xoxa, Lumi, I, 134); Një drithërimë, *akull e ftohët* i mori majrat e gishtërinjve (po aty, 236); Nekija... ra në krahët e tij *pëndë e lehtë* (Sh. Musaraj, Para, I, 460).

Të gjuhës popullore janë edhe përdorime të tilla: E unë korba pandehja mos ia ka ngrënë frëngjuza, se edhe ashtu, të rrënduar, e ka *mashalla të gjatë*, i ziu xha Limon. (J. Xoxa, Lumi, III, 82); Dhoma ku bëhesh konferenca ishte *goxha e madhe* (Sh. Musaraj, Para, I, 187); Duhet të jesh

29) Këtë ndërtim gjermanishtja e jep në formë kompozitash përcaktuese, duke qenë si element i parë e përcaktues i kompozitës emri përkatës, ndërsa si element i dytë mbiemri i dhënë, p.sh. *blitz-schnell* (rrufe i shpejtë), *abgrundtief, fédérleicht* (pëndë i lehtë) etj. — shih: J. Erben, *vepër e cituar*, 163; W. Jung, *vepër e cituar*, 174; kh. edhe artikullin e L. V. Ivashkeviç, *Slozhnie predlagatel'nye nemeckogo jazyka, s pervym komponentom-osnovoj imeni sushcestvitelnogo tipa schneeveiss, gras-grün* — Uçjonye Zapiski, 3-14. Një mënyrë të tillë ndërtimi në shqipen kemi hasur vetëm me ndajfoljen *shumë*, p.sh. i *shumë vuajturi* President (Ligjërton Fan Noli, 71); shpimëni në shtëpi të *shumëdashurit* Vasil (S. Luarasi, Fjala, 20-21); I *shumënderuari* zot Haxhi Manoli (P. Pepo, Kodiku i Korçës, 112).

beter i fortë që të mos pëlçasësh nga marazi, (N. Sinseri. Kokrra, 31); Një fshatare mes-hollë dhe e bukur pun'e madhe mban në dorë llambën (S. Spasse, Afërdita, 145).

Përsa i përket topikës së këtyre emrave, siç del edhe nga shembujt e mësipërm, ekziston mundësia e vendosjes para dhe pas mbiemrit përkatës njëlloj si në rastin e ndajfoljeve intensifikuese. Por, ashtu si edhe tek ndajfoljet, prapavendosja bëhet me qëllim theksimi të shkallës së intensitetit të cilësisë.

Kjo «shkallë» mund të përforcohet me anë të përsëritjes së ndajfoljes së vendosur para formës pohore të mbiemrit të dhënë; midis ndajfoljes së përsëritur mund të vihet edhe vizë ose lidhëza e, p.sh.: për çudi, tërë ajo turmë, që pak më parë e tmeroi, tashti iu duk shumë-shumë e vogël, e pafuqishme. (A. Abdihoxha, Tri, I, 256); Gjer ahere nga gjithë atdheu neve na përkiste një pjesë shumë shumë e vogël (I. Kadare, Dasma, 37); aktivitetet e saj janë shumë e shumë të rralla (I. Kadare, Vatër, Drita, 2.X.1966, 1) (kh. edhe shkallën krahasore të sipërisë relative: Dhe rruga e gjatë dukej shumë e shumë më e shkurtër se ç'mund të pandehni ju — Dh. Shuteriqi, Gurnecka, 5).

Ndërsa në ndërtime të tilla: dhe dinin të lëftonin / ishin fort mirë të pjekur / (N. Frashëri, HeS 36) — kemi shkallëzim të ndajfoljes së cilësisë mirë, e cila përcakton mbiemrin prejpjesor (kh. : po trimi, q'i lij pas shokët, hoqi fort mirë një shtëpi, Tatarit i ra në kokët / po aty / — në konstruktë të tipit: Kafshët e kësaj kohe, si të detit dhe të steresë janë gjendurë të gurosura fort shumë (N. Frashëri, Dituritë, 13); punë fort shumë e mëkatë (N. Frashëri, HeS, 21). Gjithë këta yj..., janë... të mbëdhenj fort shumë (N. Frashëri, Dituritë, 122) — nën ndikimin e gjuhës popullore, kemi intensifikim të formës së pohores nga dy ndajfolje të ndryshme me kuptim pak a shumë të ngjashëm. Kjo mënyrë intensifikimi, të cilën e shënon edhe K. Kristoforidhi (vep. e cit., 32): fort shumë i bukurë, fort tepër i bukurë, fort mjaft i bukurë, së paku në shqipen e sotme letrare, nuk përdoret.

Ndërtimet e gjuhës popullore të tipit: Ama fiq për kokën e fjqve. (J. Xoxa, Lumi, I, 207). Të kemi gjetur një burrë për kokën e burrit (N. Jorgaqi, DeM. 175); Ajo kishte vajzë për kokën e vajzës (po aty — 173); Po ish zagar për kokën e zagarit (A. Kallamata, Net, 49); Ti je djalë si mos djalë (Mbledhës, II, 58); ma kini shtatin punë e madhe (S. Luarasi. Fausti. 83)³⁰ — përfaqësojnë një shkallëzim, si të thuash, frazeologjik e jo gramatikor. Mjetet që përdoren për këtë funksion janë jashtë sistemit mbiemëror — këto ndërtime i lidh me «shkallën sipërore» vetëm sinonimia, ngjashmëria, semantika e tyre.

Nga pozitat semantike ka të drejtë K. Cipo që mbiemrat «i pari, i vetmi, i madhi etj.», përbëjnë një «sipërore të veçuar», pra sipas ndarjes që kemi bërë ne kanë kuptimin e shkallës krahasore të sipërisë relative, por këtë vlerë e ka një numër i pakufizueshëm mbiemrash në përdorimin konkret në pohore: kur themi i vogli i djemve, e madhja e vajzave, herën e fundit, puna kryesore, e bukura e dheut, i ligu i botës, e mira e nënës, — logjikisht mendojmë «më i vogli» etj. Populli thotë madje edhe më i pari (kh. edhe : Në çdo sulm ti je m'e para (V. Skënderi, Këngët, 68). Sidoqoftë, për arësyet që i përmendëm më sipër, këtu mund të diskutohet vetëm për semantikë që i korespondon shkallës krahasore të sipërisë absolute, por jo për forma.

30) Shih K. Cipo, Sintaksa, 25.

Që shkalla sipërore tregon një shkallë shumë të lartë të cilësisë, kjo duhet kuptuar në një vështrim të gjerë të fjalës, së pari, sepse jo që të gjitha ndajfoljet që përdoren për formimin e kësaj shkalle janë sinonimike me *shumë*; së dyti, sikurse vëren J. Erben³¹ ekziston «një shkallëzim në sensin e kundërt», që mundëson zvogëlimin e sasisë së cilësisë e që bëhet i mundshëm me anë të ndajfoljeve *pak*, *pakëz* e sidomos *hiç* dhe *aspak* — të vendosura gjithashtu para formës pohore të mbiemrit, p.sh. Në ngritjen e mureve të rrethimit, gurët, deri atëhere të palatuar ose *pak të latuar*, i nënshtroheshin një punimi të kujdesshëm (HeSh; 108); Mysafiri, përkundrazi i vuri dorën një froni *pakëz të lartë* (Sh. Musaraj, Para, I, 491); nënokja nuk i ka *hiç të mbara* qiqrat (I. Qafëzezi, Nusja e vogël e së Gjozit — Përpjekja shqiptare, 7, vol. II, 108); me fjalë të shkurtëra nuk jam *hiç i zoti* për të ecur më këmbë (F. Noli, Don, 188); ne nuk jemi *aspak kokëfortë* (E. Hoxha, 20 vjet, 66).

Megjithëse fjalorët e ndryshëm e japin ndajfoljen *pak* si antonime me ndajfoljen *shumë*, duhet theksuar se, ndërsa *hiç* e *aspak* mbeten plotësisht të tilla (antonime me *shumë*, *jashtëzakonisht* etj.), ndajfolja *pak* në këto shprehje ka shkuar drejt zbehjes së kuptimit të saj dhe ka vlerën: *deridiku*, *deri në një farë mase etj.*, pra nuk mbetet antonime me *shumë*. Megjithatë ekziston një përdorim i tillë (antonim) edhe për ndajfoljen *pak*, kur thuhet: Ai *pak i zoti* më duket që ta kryejë me sukses këtë punë! ≈ më duket i *pazoti*; Ai s'më duket *hiç i zoti*.

Pra, përderisa pranohet — goftë edhe vetëm për nga kuptimi — shkalla sipërore në sensin pozitiv, duhet të pranojmë edhe një sipërore në sensin negativ, më drejt një shkallë ultësore (a ultësie). Edhe Sh. Demiraj shënon se, ndërsa ndajfoljet «*shumë*, *tepër*, *fare*, *aqë*, *kaqë*, *mjaft*, *më* (geg. *ma*), *jashtëzakonisht*», «*kanë* kuptim përforconjës», ndajfolje të tilla si *pak*, *më pak*, *aspak* etj. kanë kuptim dobësonjës³². E pra, deri sa format e sajuara me *më* (*ma*) janë vështruar e vështrohen si krahasore të sipërisë dhe format me *më pak* si krahasore të ultësisë, del e domosdoshme që formave me *shumë* t'u përgjigjen format antonime me *pak*. Të gjitha këto si edhe vërejtja e cituar tek format e shkallës krahasore të sipërisë relative — mbi kalimet e ndajfoljeve sasiore nga vlerësime emocionale e subjektive në vlerësime të përpikta e bile të shprehura me numra, e bëjnë të qartë pamëvetësinë morfologjike të shkallës sipërore.

4. VËREJTJE RRETH KUPTIMEVE TË SHKALLËVE TË MBIEMRIT

Kuptimet themelore të çdo shkalle të krahasimit u analizuan gjerësisht më sipër. Këtu do të bëjmë disa vërejtje rreth rasteve që janë më specifike dhe më tepër rreth rasteve, kur një shkallë përdoret me kuptimin e një shkalle tjetër, në funksion të një shkalle tjetër. Le ta fillojmë me shkallën pohore.

Nga vërejtjet që bëmë rreth shkallës sipërore, doli e qartë që forma e shkallës pohore mund të intensifikohet dhe bile të përcaktohet e të saktësohet me gjithfarë ndajfoljesh sasiore e cilësore. Përveç ndajfoljeve që përmendëm e që nga koha janë kristalizuar pranë formës së pohores, duke formuar me të një njësi kuptimore, të barabartë me vlerën e sipërores, shkalla pohore përcaktohet dhe nga mjaft ndajfolje të tjera të të njëjtit tip, dhe bile është shumë e vështirë për të prerë qartë kufijtë edhe kuptimisht midis këtyre formave të dyta dhe atyre me vlerë sipërore. Kështu tek for-

31) J. Erben, *Vep. e cit.*, 164.

32) Sh. Demiraj, *Vepër e cituar*, II, 258.

mat *pak a shumë* + *mbiemër në pohore* kemi vlerësim të përgjithshëm, një farë grade të cilësisë³³. Tek këto forma nuk kemi shkallëzim të mbiemrit të dhënë, por një krahasim me antonimin e tij. Kështu p.sh. një qytet *pak a shumë i madh* — s'është aspak — *qytet i madh*, por vetëm *më i madh se një qytet i vogël*. Pra në fakt këtu kemi një dobësim të cilësisë së shprehur në shkallën pohore nga mbiemri *i madh*, p.sh. U përpoqa... të shkruaj një histori *pak a shumë kritike*. (F. Noli, HeS, 5); Sa qeshë me të tjerët, ...isha *pak a shumë e qetë*. (V. Vinçani, Lumturia, 66), t'i dërgohesh një informacion *pak a shumë i saktë* shokut Hysejn (Sh. Musaraj, Para, I, 194); ajo e quante veten *pak a shumë të rritur* dhe të denjë (N. Jorgaqi, DeM, 59).

Ndër ndajfoljet përcaktuese e plotësuese të shkallës pohore janë edhe: *gjysmë, përgjysmë*³⁴, *gati, gati-gati, pothuaj, disi* etj., p.sh. nuk e shijoi dot bukurinë e trupit *gjysëm lakuriq*. (I. Kadare, Përbindshi, 54); Pa u ngritur akoma, ashtu *gjysmë i shtrirë* filloi të gdhendë. (D. Agolli, Zhurma, 122); Kur arriti kontrolli në portën e saj, porta ishte *përgjysëm e hapur* (Sh. Musaraj, Para, I. 329); ç'kemi andej nga qyteti — tha ai *disi i qetësuar* (F. Gjata, Tana, 19); Skënderi... kënaqej tek shikonte gishtat e tyre, *gati të padukshëm* (A. Abdihoxha, Tri, I, 213); Ishin flakë të mëdha dhe të çuditëshme, flakë të zbeta, *gati gati të bardha* (I. Kadare, Përbindshi, 60); (kh. edhe: *Simboli që shprehet në hyrjen e tyre në lëvizjen revolucionare, simbol ky ngabthësisht djallëzor, dinakërisht naiv...* anakronizëm gjenialisht absurd... — Marks-Engels, Vepra, I, 154-155).

Një ndajfolje tjetër që përdoret në bashkëvaajtje me formën e shkallës pohore të mbiemrit, por që i jep kësaj të fundit vlerën e sipërores me një nuancë të theksuar habie, dëshire, mospërmbytjeje e emocioni është ndajfolja *sa*, p.sh. — *sa e largët* më duket dita e nesërme! (H. Stërmilli, Sikur, 129); *Sa e mirkëz*, që je, Dita, *sa e mirkëz*. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 77); Bre *sa kokëtrashë* djalë, të mos kesh parë! (N. Sinaeri, Kokrra, 76); *Sa e çudiçme* dhe *sa e dëshiruar* është kjo rrojtje për njerës zemërthyer nga kjo botë (F. Postoli, Për, 80). Këtu vlen e njëjta vërejtje që kemi bërë për format *aq i lumtur!*, *kaq i bukur!*. Pra kuptimisht folësi do ta shprehë cilësinë në një gradë shumë të lartë, mirëpo nuk e kënaq asnjë nga ndajfoljet që zotëron gjuha për këtë funksion dhe ai e lë me ndajfoljen pyetëse *sa*, e cila këtu nuk ka kuptimin pyetës, por kuptimin e pakufishmërisë, e mund të thuhet se ka shkuar drejt shndërrimit të saj në një pjesëz emocionale që shpreh habi, çudi, mospërmbytje. Mospërmbytja e ndajfoljes përkatëse nga gjuha, nuk duhet parë aspak si varfëri e shqipes e e gjuhëve të tjera, por si kapërcim i çdo mase të objektivitetit të shfaq-

33) Lokucioni ndajfoljor *pak a shumë* në fakt është i barabartë me *më pak a më shumë* (kh. gjerm. *mehr oder weniger*, rus. *bolee ili menne*, angl. *more or less*, fr. *plus ou moins*, it *più o meno*). Është me interes të vërejmë që në gjuhën shqipe, veç përgjithësisht të formës së pashkallëzuar të këtij lokucioni ndajfoljor, ka ndodhur edhe përmbyssa e gjymtyrëve përkatëse në raport me gjuhët e tjera. (Pikërisht nën ndikimin e këtyre gjuhëve në ndonjë rast gjejmë rendin *shumë a pak*, p.sh. Për ngritjen e tyre zgjidhej një kodër *shumë a pak e izoluar* me shpat *sa më të thepisur* (Hesh, 107). Kjo përmbyssa mund të ketë arsye psikologjike: nga pak kalohet në *shumë*, por edhe arsye eufonike. Ky lokucion është sinonimik me *deridiku*.

34) Në gjermanishte, rusishte e anglishte (por edhe në ndonjë gjuhë tjetër) mbiemri i shoqëruar nga kjo fjalë formon një fjalë kompozite: p.sh. *halbfett, halbgar, halblang, halbjährig; poluzhörnij, polygodovoj, polydlinij, half-yearly, half-bred, half-backed* etj. Edhe në shqipen ekziston një prirje e tillë për ta kthyer këtë emër në element fjalëformues të mbiemrit. Kh. edhe: aqë ndryshon i vllaj i saj Laerti nga Hamleti... obortar këpuçë-lëpirës, *gjysmë-spiun, gjysmë-palaco, gjysmë-çilimi*. (F. Noli, Hamleti 12); Rusia është një vend *gjysmë-aziatik*... (Stalin, Vepra, II, 336).

shëm me anë të ndajfoljeve sasiore (kh. edhe rus. *kak prekrasno more!*; gjerm. *wie schön ist das Meer!*; angl. *How beautiful the sea is!*).

Është për t'u shënuar që ndajfoljen *sa* në këtë funksion nuk e gjejmë të trajtuar në gramatikat e ndryshme, ndërsa në fjalorët e gjejmë — kështu në Fjalorin e gjuhës shqipe: «*sa... tregon shkallën e një cilësie... sa trim që ka qenë!*»; S.I. Ozhogovi: «*kak nareçie opredilitelbnoe — deri në çfarë shkalle... kak ja rad!*»; Brockhaus: «*wie... në çfarë grade, mase: wie grossartig!*».

Në shprehje thirrmore, gjuha popullore përdor shpesh formën pohore të mbiemrit me vlerën e një shkalle shumë të lartë, por të papërcaktuar konkretisht se *sa*, p.sh. *More, ç'e bukur këngë!* (S. Spasse, Ata, 50). Në këto raste pohorja shoqërohet me fjalën *ç*, e cila origjinarisht është përemërore, por në këto përdorime ka shkuar gjithashtu drejt shndërrimit të saj në pjesëzë. Përdorime të tilla janë shumë të rralla e deridiku të vjetëruara.

Në funksion të shkallës sipërore, por me një forcë më të madhe shprehjeje, përdoret në ligjërimin popullor edhe forma e pohores së mbiemrit e shoqëruar me shprehje të tilla si: E shkathët e zgjuar *përmbi të gjitha vajzat* e kooperativës (Sh. Musaraj, Të shkuara), i hollë, i gjatë, ashtu siç kish qenë dikur: *trim mbi trimat* (M. Kuteli, Tregime të moçme, 41); Aty gjen Janukën e bardhë, *të bukur mbi të bukurat* (po aty — 91); Kam një motër, *të mirë mbi të mira* (po aty — 155); nusen e ke *të bukur ndër të bukurat* (po atje — 168), — ose kur pasohet nga një fjali rrjedhimore: E bukur moj e bukur / E bukur je *sa të thuash* (Visaret e kombit, V 1941, 105); Teto Konxheja i pati qepur... një palë të mbathura me flutura, të hijëshme *sa s'bëhet* (J. Xoxa, Lumi),

Një mënyrë tjetër përdorimi e formës së pohores në funksion të sipërores është edhe përsëritja e kësaj forme. Këtë mënyrë e ka përmendur i pari K. Cipo në Gramatikën (f. 77) dhe në Sintaksën (f. 25) e tij: «Populli e formon sipëroren edhe duke përsëritur mbiemrin...»; «në vend të sipërores absolute mund ta përsërisim dy herë mbiemrin...». Nuk na duket me vend kufizimi që i bën E. Lafe këtij përdorimi, kur pohon se «mbiemri përsëritet gati gjithmonë në përdorim predikativ»³⁵. Kundër këtij pohimi flasin edhe disa nga shembëllat e sjella prej tij në f. 132, nga J. Xoxa etj. Por duhet thënë se kryesisht përsëriten mbiemrat e nyjshëm. Sikurse vëren Budagovi, «sipas mënyrës se si njeriu filloi të jepte nuanca gjithmonë e më të holla cilësie, kjo mënyrë shprehjeje filloi të mos e kënaqte më: përsëritja dyfishe duhet të kthehej në përsëritje shumëfishe... Kështu, teorikisht tipi *i madh-i madh* duhet të kthehej në *i madh-i madh-i madh* e madje në *i madh-i madh-i madh-i madh* etj.»³⁶. Kjo mënyrë kthimi është e zakonshme në përralla dhe në përgjithësi më e shpeshtë në bisedit e lira afektive me të vegjëlit. Kjo mënyrë përdorimi që e ka origjinën në gjuhën e folur popullore, po merr një përhapje përdit e më të gjerë në letërsinë artistike, p.sh. Një lis *i gjatë e i gjatë*, gjysmat e fletëve i ka të bardha (Mblechës II, 29); Zbret ajo bregun, arrin buzë liqerit, sheh një urë *të gjatë, të gjaaatë*, (M. Kuteli, Xinxifilua, 180); Kam vetëm një dyshim, Hajdar bej, — tha *serioz-serioz*. (Sh. Musaraj, Para, II, 430); Tani pëllumbat / Rrotull Sahatit vërtiten, *të bardhë, të bardhë*. (I. Kadare, Përse, 35). Ndonjëherë pas formës pohore të përsëritur të mbiemrit vjen një fjali krahasore, p.sh. Njëra prej tyre filloj të tregojë një prallë *të gjatë të gjatë*

35) E. Lafe, *Përsëritja si mjet gramatikor*, «Studime Filologjike», 4/1966, 131.

36) Budagov, R.A. *Vvedenie v nauku o jazyke*, M. 1965, 296.

sa një litar Vranje (M. Kuteli, Netë, 65). Por mund të mos kemi përsëritje të thjeshtë të formës së pohores, por ripërmendjen e saj me një krahasim, p.sh. *I gjatë, i gjatë sa të them unë*, sa dy njerëz të shkurtër të vënë njëri në kokë të tjetrit. (N. Prifti, Lëkura, 3). Kh. edhe përsëritjen e po atij mbiemri në pohore, por të shoqëruar nga parashtesa *stër-*; (me kurrizin të murmë e të stërmurmë (M. Kuteli, Xinxifilua, 6); na ka ardhur gojë me gojë nga moti *i lashtë e i stërlashtë* (po atje-3); Lafshën e kish të *kuqe e stërkuqe* si flakë e zjarrit (atje-244).

Në gjuhën letrare po merr një përhapje gjithmonë e më të madhe përdorimi i pohores prirë nga lokucioni *më se*. Kjo formë, me sa kemi hetuar ne, është një evropianizëm — e ka gjermanishtja, frëngjishtja, italishtja dhe rusishtja. Por, meqenëse në gjuhën shqipe ky konstrukt është karakteristik për gjuhën letrare e jo për gjuhën popullore, ka të ngjarë që kjo formë të jetë kalkuar pikërisht nga ndonjëra prej këtyre gjuhëve të huaja. Kjo formë ka kryesisht kuptimin e shkallës sipërore, por ndonjëherë mund të ketë kuptimin *diçka më tepër se...*³⁷, pra, theksohet tejkalimi i gradës së dhënë me shkallën pohore të mbiemrit, — p.sh. Edhe ekzistencën e një partie komuniste shqiptare... e quaj *më se të domosdoshme* (Sh. Musaraj. Para, I, 170); Me këtë mënyrë do të jem e kënaqun dhe *ma se e lumtun* (H. Stërmilli, Sikur, 159); Trajtën Arianit e gjejmë dy herë edhe në dokumentat arkivale, po të dy herët janë *më se të dyshimta*. (Dh. Shuteriqi. Aranitët, Studime Historike, 4/1965, 5).

Në disa raste, kur fjalia drejtuese që përmban mbiemrin në pohore, pasohet nga një fjali e varur rrjedhimore, që luan rolin e gjymtyrës së dytë të krahasimit, atëhere forma pohore zakonisht ka kuptimin e shkallës sipërore, p.sh. Misrat ne këndeja i kemi të thatë në këtë vakt, po çupat ama i kemi të *njoma, që t'i hash me gjithë kocka*. (J. Xoxa, Lumi, I, 78); Gjer tashti u tregove burrë *i pjekur sa s'ka më*. (V. Vinçani, Të rinjtë, 34); Nganjëherë më hipën një mërzi *e madhe sa s'bëhet*. (N. Jorgaqi, DeM, 128); Një burrë *i mirë që s'e ka pasë shoqin* (H. Mosi, Cubat, 77). Në këto raste jo vetëm që mungon ndajfolja shkallëformuese, por mund të përdoret si lidhëz e elementit të dytë të krahasimit (në vend të *sa dhe sa që*) lidhëza *që*. Ndonjëherë, duke e quajtur si lehtësisht të kuptueshëm tiparin e shprehur nga mbiemri përkatës, autori s'e përmend fare, p.sh. ama, e kishte bërë / të mirë — A. Dh. / që të lëpinje gishtërinjtë (J. Xoxa, Lumi, III, 143); më kapi një frikë / *e madhe* — A. Dh. / që aman o zot (V. Vinçani, Të rinjtë, 6). Kishte bërë një punë / të mirë — A. Dh. / që ç'ke me të (Populli).

Lidhur me kuptimin e shkallës krahasore mund të bëhen këto vërejtje: Kur krahasohet për nga shkalla e saj cilësia e dhënë tek dy a më shumë sende — dhe krahasuesi nuk është në gjendje të përcaktojë prerazi se tek cili prej këtyre sendeve cilësia e dhënë qëndron në një shkallë më të lartë, sepse që të dy (e që të gjitha) e zotërojnë cilësinë e dhënë, një shkallë shumë të lartë, atëhere ai shprehet kështu: atje na qenkej foleja e dhjetra rrymave që e quajnë veten *secila më komuniste se tjetra...* (Sh. Musaraj, Para, I, 37); Se si i erdhi Skënder Ndriçollit nga këto romuze,... *njëra më e rëndë se tjetra*. (J. Xoxa, Lumi, III, 254). Pra këtu të dy sendet e kanë tiparin kuptimisht në shkallën sipërore. Një përdorim të tillë e ka vënë në dukje së pari K. Cipo (Sintaksa, 24) dhe më pas Sh. Demiraj (Morfologjia, dispensë, I, 79).

³⁷ Edhe mënyra e formimit të këtij lokucioni mund të jetë pikërisht cungimi i togut *më shumë se, më tepër se*, sado që në italishte është *più che* (më se).

Në përgjithësi përsa i përket përdorimit të krahasores dhe të sipërores, do shënuar mendimi i E. Schwyzerit që këtu «mbizotëron përdorimi predikativ»³⁸ në krahasim me atributivin. Një gjë e tillë nuk është vënë re jo vetëm për gjuhën shqipe, por as për shumë gjuhë të tjera. Megjithatë, një farë qëndrimi miratues ndaj këtij mendimi është marrë në heshtje edhe nga shumë gramatika shkollore tonat, sepse në to mbizotërojnë (për të mos thënë ka vetëm) shembulla ilustruese me mbiemër në funksion predikativ.

Kur kemi rritje të vazhdueshme të shkallës së cilësisë, atëhere para formës së shkallës krahasore të sipërisë vendosen ndajfoljet a lokucionet ndajfoljore (të shoqëruara nga lidhëza e) *gjithnjë e, gjithmonë e, për ditë e, ose shprehja sa vete e*, p.sh. Ata po e shohin se *gjithnjë e më e thellë* po bëhet kontradikta e tyre me komunistët (Tradhëtarët... Zëri i Pop., 22.III.66, 4); Për Mimosën ditët vinin *gjithnjë e më të bukura* (N. Jorgaqi, DeM, 140). Edhe kjo mënyrë përdorimi do parë si ndikim i gjuhëve të huaja si italishtja, gjermanishtja etj.

Në periudha të tipit: Ai përpiquej ta bënte rrëfimin *sa më të gjallë* që t'ishite e mundur — fjalia e varur e fjalisë drejtuese që përmban mbiemrin në shkallën krahasore të sipërisë relative të prirë nga ndajfolja *sa*, është fjali e varur e intensitetit potencialisht maksimal të shkallës së mbiemrit në krahasore dhe përbën gjymtyrën e dytë të krahasimit; ajo bën punën e një ndajfoljeje sasiore, zërthen pra, kuptimin e ndajfoljes *sa*. Kuptimisht ky krahasim zërbëhet në dy elementët e krahasimit të shkallës krahasore të barazisë: *aq... sa...*, por me kusht që *sa është maksimumi i mundshëm i intensitetit të cilësisë*, e jo çdo intensitet; pra, mund ta transformojmë kështu: Ai përpiquej ta bënte rrëfimin *aq të gjallë sa ishte maksimalisht e mundshme*. Ndërtimet me *sa + mbiemër në shkallën krahasore të sipërisë relative* janë karakteristikë vetëm të gjuhës letrare; gjuha popullore nuk i përdor.

Duke qenë kuptimisht e kapshme, kjo fjali e varur e intensitetit potencialisht maksimal, zakonisht nuk shprehet fare, p.sh. do t'i plotësojmë të gjitha kushtet për një jetë *sa më normale* (Tregojnë... Zëri i Pop., 3, II, 66, 1); ta bëjnë *sa më të lumtur e të gëzueshme* jetën e popullit (E. Hoxha, 20 vjet, 80-81); Nata duhet t'ishite *sa më e errët* (I. Kadare, Përbindshi, 75).

Kur fjalia e varur nga fjalia drejtuese që përmban mbiemrin në shkallën krahasore të barazisë, është një fjali rrjedhimore, atëhere logjikisht «forma» krahasore e barazisë së bashku me fjalinë rrjedhimore është e njëvlershme me sipëroren e mbiemrit të dhënë, p.sh. ajo dukej *aq e bukurosh, aq lozonjare thuajse* po ta çikje sadopak *të mbetej në dorë*. (A Abdihoxha, Tri, I, 137); Dhe ish *aq e prerë* në këtë mendim, *saqë Qemali nuk pati më kurajën* t'i kundërshtojë. (Sh. Musaraj, Para, I, 122). Nganjëherë në vend të lidhëzës *sa që* përdoret vetëm *që*, çka s'është e rekomandueshme për normën letrare, p.sh. Zyberi asht një fmi *kaq frigs qi* dro gjithshka. (L. Gurakuqi, Vepra, 205).

Barazia kuptimore e këtyre njërive me një të tretë të vetme është kaq e vërtetë, sa shpeshherë, kur folësi nuk gjen fjalët e përshtatshme, e len fare jashtë fjalinë rrjedhimore dhe mjaftohet vetëm me formën e shkallës krahasore të barazisë së mbiemrit. Siç u vrejt më sipër, ky fenomen nuk është specifik i shqipes. Ky barazim do parë në një vështrim mjaft të gjerë logjik, e pra, kjo nuk do të thotë që funksioni i fjalisë rrjedhimore

38) E. Schwyzer, *Grammatik der griechischen Sprache*, München, 1959, Bnd. I, 182.

qenka vetëm e vetëm të barazojë kuptimisht shkallën e pranishme të barazisë me shkallën sipërore të nënkuptuar — ajo ka plotësisht funksionin e vet të mvetësishëm e normal, jep të dhëna të tjera shtuese e sqaruese.

Është për t'u shënuar, më fort nga pozitat stilistike, që në përdorime të tilla: mos ki merak, gropën do ta bëj të thellë, shumë të thellë (I. Kadare, Gjenerali, 9); po që qe ndonjë gjë e ligë, shumë e ligë, këtë e mora vesh nga babai (Th. Kacori, Ditë, 5); Ky ishte një rast i rrallë, shumë i rrallë, prandaj Kola qe bërë në qejf (A. Abdihoxha, Tri, I, 174); atë çast na e ndjemë veten të fortë, shumë të fortë (M. Kallamata, Shokë, 16), — ku realiteti objektiv është po ai, dhe vlerësimi i tij bëhet në dy shkallë të ndryshme nga i njëjti folës në të njëjtën kohë, në vështrimin e parë duket sikur kemi një farë kontradikte, sepse sendi mund të ketë tiparin ose në njërin ose në tjetrën shkallë, por jo njëherazi edhe në njërin edhe në tjetrën. Por kjo mënyrë përdorimi shpjegohet me faktin që folësi nuk kënaqet me vlerësimin e parë dhe në çast e rivlerëson ose më drejt e saktëson vlerësimin e tij. Këtë saktësi mund ta bëjë edhe duke vazhduar me një ndërtim krahasor (p.sh.: Petriti është i mirë, më i mirë se...).

Këtu do të shënojmë edhe një vërejtje të fundit lidhur me përdorimin e sipërores. Përdorimi i pamenduar i fjalëve shkallëzuese çon shpeshherë në shpërdorim, mjafton të përmëndim rastet: «tmerrësisht i bukur (i dashur)», po kështu rastet më tepër (që do të thotë «më shumë se sa duhet»), ku kjo shpërdorohet për shumë, mjaft (që nuk do të thotë shumë) etj. Me të drejtë V. Jungu shënon se «në tërësi është për t'u ruajtur nga përdorimi i shpeshtë i sipërores. Shpesh zbulohet që në vend që të themi mendimet më të thella, mund të themi më mirë mendime të thella»³⁹. Ne do të vërenim se duhet ruajtur në përgjithësi nga shkallëzimi i pakontrolluar p.sh. shikonte dëborën, qiellin tepër të kaltër e të pastër. (Dh. Xhuvani, Kambana, 8); Detyra na kërkon që këtë mot të punojmë pa rreshtje, me zell dhe me kurajë më të madhe, me zjarr më të pashojtur dhe me zemër më të pathyer. (S. Luarasi, Fjala, 29-30).

PËRFUNDIM

Shkallëzimi i mbiemrave në thelb është karakteristik vetëm për cilësorët e drejtpërdrejtë (duke përfshirë këtu edhe mbiemrat që tregojnë një tipar lëndor a përkatësor në kuptimin e tyre figurativ), por jo në pavarësi të plotë nga semantika e tyre. Shkalla e mbiemrit tregon gradën në të cilën gjendet tipari cilësor tek sendi i dhënë. Shkalla pohore e mbiemrit duhet pranuar si shkalla bazë, jashtë çdo krahasimi dhe pa ndonjë tregues morfologjik përkatës. Ajo pranohet si shkallë vetëm për hir të kundërvënjes me shkallët e tjera.

E vetmja shkallë që në gjuhën shqipe ka një formë të vërtetë është shkalla krahasore e sipërisë (me të dyja nëndarjet e saj).

E ashtuquajtura shkallë krahasore e barazisë dhe e ultësisë si edhe e ashtuquajtura shkallë sipërore nuk kanë forma përkatëse; ato formohen jo me morfema formëformuese, por me mjete leksikore të mëvetësishme. Si mjete leksikore për këto shkallë shërbejnë ndajfolje të ndryshme dhe forma pohore e mbiemrit.

39) W. Jung, *vepër e cit.*, 174.

Tek shkalla krahasore në çdo rast krahasohen për nga shkalla cilësi-të midis tyre, ose e njëjta cilësi tek sende të ndryshme, ose e njëjta cilësi tek i njëjti send, por në rrethana të ndryshme (dhe jo sendet midis tyre, siç thuhet zakonisht).

Tek shkalla krahasore e sipërisë absolute në funksion predikativ mbiemri është i substantivuar. E ashtuquajtura shkallë krahasore e ultësisë nuk ka bazë popullore, ajo përdoret vetëm në gjuhën letrare nën ndikimin e gjuhëve të huaja.

Gjuha shqipe zotëron edhe një varg shprehjesh që kanë vlerën e së ashtuquajturës shkallë sipërore.

Shkallët e ndryshme të mbiemrit përdoren mjaft shpesh në funksion të njëra-tjetrës.

VEPRAT LETRARE TË PËRMENDURA DHE SHKRIMET E TYRE

- | | |
|--------------------------|---|
| A. Abdihoxha: Tri, I | Ali Abdihoxha: Tri ngjyra të kohës, v. I, Tiranë, 1965 |
| A. Varfi: Në tingujt | Andrea Varfi: Në tingujt e revolucionit, Tiranë, 1961 |
| A. Xhuvani: Jeta | Aleksandër Xhuvani: Jeta e Mehmet Aliut, Tiranë, 1921 |
| Asdren: Psallme | Asdren: Psallme murgu, Bukuresht 1930. |
| Çajupi: Baba Tomorri | Çajupi: Baba Tomorri, Tiranë 1950 |
| Prralla | Prralla të zgjedhura, Tiranë |
| Vepra | Vepra, Tiranë, 1957 |
| D. Shaplllo: Përtëritje | Dalan Shaplllo: Përtëritje, Tiranë, 1960 |
| D. Agolli: Në rrugë | Dritëro Agolli: Në rrugë dolla, Tiranë 1958 |
| Zhurma | Zhurma e erërave të dikurshme, Tiranë, 1965 |
| D. Kurti: Pralla, I, II. | Donat Kurti: Pralla kombtare, vëll. I, II, Shkodër, 1942 |
| Dh. Shuteriqi: Gurnecka | Dhimitër Shuteriqi: Gurnecka, Tiranë, 1957 |
| Dh. Xhuvani: Kambana | Dhimitër Xhuvani: Kambana e fundit, Tiranë, 1959 |
| E. Hoxha: 20 vjet | Enver Hoxha: 20 vjet Shqipëri socialiste, Tiranë, 1964 |
| E. Çabej: Konstandini | Eqrem Çabej: Konstandini, shkrimtarët shqiptarë, vëll. II, Tiranë, 1942 |
| F. Paçrami: Në tufan | Fadil Paçrami: Në tufan (Dy drama), Tiranë, 1963 |

F. Noli: Don Kishoti	Fan Noli: Don Kishoti (përkthim), Boston, 1932
Othello	Othello, Boston, 1916
HeS	Historia e Skënderbeut, 1921, 1962.
F. Gjata: Këneta	Fatmir Gjata: Këneta, Tiranë, 1958
Në pragun	Në pragun e jetës, Tiranë, 1960
Ujët fle	Ujët fle, hasmi s'fle, Tiranë, 1951
Zemër	Zemër shqiptare, Tiranë, 1953
F. Postoli: Për mbrojtjen	Foqion Postoli: Për mbrojtjen e atdheut.
H. Stërmilli: Sikur	Haki Stërmilli: Sikur t'isha djalë, Tiranë, 1959
Shtigjet	Shtigjet e lirisë, Tiranë, 1967
HeSh	Historia e Shqipërisë, v. I, Tiranë, 1958
H. Mosi: Cubat	Hil Mosi: Cubat, Tiranë, 1915
I. Uruçi: Pëlhura	Ibrahim Uruçi: Pëlhura e zezë, Tiranë, 1958
I. Kadare: Dasma	Ismail Kadare: Dasma, Nëndori, 8, Tiranë, 1967
Gjenerali	Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, 1963
Përbindshi	Përbindshi, Nëndori, 12, Tiranë, 1965
Përse	Përse mendohen këto male (vëllim), Tiranë, 1964
Shekulli	Shekulli im, Tiranë, 1961
J. Xoxa: Lumi, I, II, III	Jakov Xoxa: Lumi i vdekur, I, II, III, Tiranë, 1965
J. Rrota: Rreth	Justin Rrota: Rreth votrës, Shkodër, 1945
K. Jakova: Halili	Kolë Jakova: Halili dhe Hajrija, Tiranë 1950
Toka	Toka jonë, Tiranë 1955
K. Floqi: Fe	Kristo Floqi: Fe e kombësi, Sofje, 1914
Nder	Nder e qytetni, Tiranë 1922
Lenin: Vepra, I, II	Lenin: Vepra të zgjedhura, v. I, II, Tiranë, 1956. 1959

Lipi: Pelasgë!	Lipi (Filip Papajani): Pelasgë! Qytetnim! Vllaznië!!!, Tiranë, 1923
L. Gurakuqi: Vepra	Luigj Gurakuqi: Vepra të zgjedhura, Ti- ranë, 1961
Ll. Siliqi: Ringjallje Vjersha	Llazar Siliqi: Rringjallje, Tiranë, 1960 Vjersha dhe poema, Tiranë
Marks-Engels: Vepra, I, II	Marks-Engels: Vepra të zgjedhura, v. I, II, Leipzig, 1958
Mbledhës: I, II, III	Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, v. I-1961, v. II-III, 1962
M. Myftiu: Leka	Mehmet Myftiu: Leka, Tiranë, 1960
M. Kallamata: Gjëmbat	Miço Kallamata: Gjëmbat e trëndafilut, Tiranë, 1955
Netë	Netë gjahtarësh, Tiranë, 1959
Shokë	Shokë lufte, Tiranë, 1962
M. Kuteli: Xinxifilua Tregime	Mitrush Kuteli: Xinxifilua, Tiranë, 1962 Tregime të moçme shqip- tare, Tiranë, 1965
N. Frashëri: Dituritë	Naim Frashëri: Dituritë, Bukuresht, 1888
HeS	Histori e Skënderbeut, Korçë, 1923
Iliadhë	Iliadhë e Omirit, Buku- resht, 1896
Istori e përgj.	Istori e përgjithëshme, Bukuresht, 1886
Lulet	Lulet e verës, Korçë, 1923
Mësime	Mësime, Bukuresht, 1894
N. Jorgaçi: DeM	Nasho Jorgaçi: Dashuria e Mimosës, Tira- në, 1960
N. Sinaeri: Kokrra	Nella Sinaeri: Kokrra aguridhe, Tiranë, 1959
P. Marko: Qyteti	Petro Marko: Qyteti i fundit, Tiranë, 1960
Q. Guranjaku: Tetë ditë	Qamil Guranjaku: Tetë ditë pa bukë, Ti- ranë, 1959
R. Brahimi: Katër vajza	Razi Brahimi: Katër vajza, Tiranë, 1962
S. Frashëri: Dheshkronjë	Sami Frashëri: Dheshkronjë, Bukuresht, 1888

	Shqipëria	Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e çdo të bëhet, Ti- ranë, 1962
S. Luarasi: Fausti		Skënder Luarasi: Fausti, I (përkthim), Tiranë, 1957
	Fjala	Fjala shqipe, Tiranë, 1961
	Vilhelm	Vilhelm Teli (përkthim), Tiranë, 1962
S. Andoni: Tregime		Sotir Andoni: Tregime nga Morava, Tira- në, 1960
S. Çomora: Karnavalet		Spiro Çomora: Karnavalet e Korçës, — Dramë, Tiranë, 1964
	Sorra	Sorra dhe pullumba, Tira- në, 1957
Stalin: Vepra I, II.		Stalin: Vepra, I-1951, II-1954
S. Spasse: Afërdita		Sterjo Spasse: Afërdita, Tiranë, 1944
	Afërdita përsëri	Afërdita përsëri në fshat, Tiranë, 1956
	Buzë	Buzë liqenit, Tiranë, 1965
	Ata	Ata nuk ishin vetëm, Tira- në, 1952
S. Pitarka: Trimi		Sulejman Pitarka: Trimi i mirë me sho- kë shumë, Tiranë, 1958
Sh. Musaraj: Para I, II		Shevqet Musaraj: Para agimit, I, II, Tira- në, 1965
	Të shkuara	Të shkuara të paharrua- ra, Tiranë, 1957
	Isha unë	Isha unë Çobo Rrapu- shi, Tiranë, 1960.
T. Miloti: Zanusha		Tonin Miloti: Zanusha, Tiranë, 1958
Th. Kacorri: Ditë		Thoma Kacorri: Ditë që s'harrohen, Ti- ranë, 1959
	Për mëmëdhenë	Për mëmëdhenë, I, II, Ti- ranë, 1961
V. Vinçani: Lumturia		Vandush Vinçani: Lumturia, Tiranë, 1965
	Të rinjtë	Të rinjtë, Tiranë, 1958
V. Kokona: Me valët		Vedat Kokona: Me valët e jetës, I, Tira- në, 1961
V. Skënderi: Këngët		Vehbi Skënderi: Këngët e para, Tiranë, 1953
Z. Sako: Nga jeta Buka		Zihni Sako: Nga jeta në luftë, Tiranë 1958 Buka, Tiranë, 1965

R é s u m é

SUR LES DEGRÉS DE COMPARAISON DES ADJECTIFS
EN ALBANAIS LITTÉRAIRE CONTEMPORAIN

La comparaison de l'adjectif est à indiquer le degré où se trouve le trait qualificatif de l'énoncé. La comparaison des adjectifs est propre aux seuls adjectifs qualificatifs (y compris aussi les noms indiquant un trait matériel ou d'appartenance au figuré), mais non point en complète indépendance de leur sémantique.

En partant des seules particularités sémantiques, on peut admettre trois degrés: le positif, le comparatif et le superlatif. Mais, une véritable forme n'a que le comparatif de supériorité.

Pour extérioriser le comparatif de supériorité, l'albanais a une forme analytique. Au contraire, pour les autres subdivisions du comparatif et pour le superlatif il emploie des moyens lexicaux indépendants.

Le soi-disant degré positif doit être admis comme un degré de base, en raison de l'opposition avec les deux autres degrés, mais il n'a pas un indice morphologique. Il est caractérisé par un morphème zéro. A ce degré-ci, le trait est donné en dehors de toute comparaison.

L'adjectif au comparatif exprime la qualité d'un objet comparé comme degré avec la même qualité d'un autre objet ou avec une autre qualité du même objet, ou bien avec une autre qualité d'un autre objet, ou encore avec la même qualité de toute la classe où est compris l'objet donné, et même avec la même qualité chez le même objet, mais en circonstances différentes.

Le comparatif a trois subdivisions: supérieure, équative, inférieure. Le comparatif de supériorité a deux aspects: a) degré comparatif de supériorité relative — quand le trait d'un objet est comparé, au point de vue de son degré, à celui d'un ou de quelques autres objets, et b) degré comparatif de supériorité absolue — quand le trait d'un objet est comparé à celui de tous les coexemplaires du groupe où fait partie cet objet.

La forme du degré comparatif de supériorité relative comporte la particule à fonction formative më et la forme affirmative de l'adjectif. Ce degré peut être intensifié à l'aide d'adverbes comme shumë, akoma, edhe, pak, ca, jashtëzakonisht, etc., même par le mot herë précédé de numéraux (njëmijë herë më i madh). Il s'associe aussi les adverbes sa... aq, en vue d'indiquer un accroissement proportionnel du degré de qualité. Les conjonctions comparatives qui relient la deuxième partie de la comparaison sont: se, sesa, nga, seq. Il y a des cas où ces conjonctions manquent, mais elles sont sousentendues lorsque comme deuxième membre de comparaison est une proposition. Lorsque le deuxième membre de comparaison est désormais connu pour le sujet-parlant, alors il peut n'être point exprimé.

Le degré comparatif de supériorité absolue, en fonction attributive (épithète) a la même forme que le comparatif de supériorité relative (il y a des auteurs qui, dans ce cas aussi, utilisent la forme substantivée de l'adjectif); au contraire, en fonction prédicative on emploie la forme substantivée de l'adjectif donné. A ce degré, les éléments, dont le trait subit la comparaison, sont toujours homogènes.

Comme deuxième membre de comparaison on y emploie le génitif, l'accusatif ou l'ablatif du nom du groupe dont fait partie l'objet auquel est

comparé le trait, mais aussi le nom du lieu où ce trouve cet objet, ou bien le nom du propriétaire de l'objet. Les prépositions respectives sont në, ndër, mbi, nga, midis, prej.

Le soi-disant comparatif équatif n'a pas une forme particulière. Il est toujours identique à la forme du positif ou bien s'adjoint les adverbes aq, kaq qui gardent leur indépendance et ne se modifient pas en mots accessoires. Les conjonctions comparatives pour le deuxième membre de la comparaison sont sa, si. On rencontre, non rarement, des constructions précédées par les adverbes sa... aq (donc, en ordre renversé) qui peuvent exprimer l'égalité, mais aussi l'opposition antonymique. A ce degré, l'adjectif peut être associé aussi par la particule po. Dans les propositions affirmatives, quand est absent le deuxième membre de comparaison, cette particule est presque absolument nécessaire. Pour des objets qui sont proches dans ces cas on emploie l'adverbe kaq, mais pour ceux qui sont loin alors on met aq, mais souvent cette régularité ne se maintient pas.

Lorsque le deuxième membre est désormais connu, alors on peut ne pas l'exprimer comme sousentendu. C'est précisément de cet usage «caduc», que cette forme assume, non rarement, la valeur du superlatif, donc elle perd tout lien avec le comparatif. Cela arrive aussi quand, comme deuxième élément de comparaison sert une proposition consécutive. Dans le langage populaire, à des effets d'accentuation, aussi la «forme» avec les adverbes aq, kaq de ce degré, peut être préarticulée. De même, dans le langage populaire on rencontre aussi plusieurs cas où entre l'adverbe d'intensité de ce degré et la forma positive du pronom sont intercalés d'autres mots. A des effets d'accentuation, les adverbes aq et kaq sont employés association avec les adverbes shumë, tepër, etc., ou bien en simple répétition (aq e aq e nxehtë).

Aussi le soi-disant degré de comparaison d'infériorité n'a pas une forme propre, mais il est construit en antéposant à la forme positive de l'adjectif la locution adverbiale më pak. Cette forme n'est pas usitée dans le langage populaire, mais seulement dans la littérature artistique. Il peut devenir plus intense à l'aide de l'adverbe de quantité shumë. Il s'associe aussi par les adverbes sa... aq.

Le soi-disant degré superlatif de l'adjectif indique le trait à un degré très haut ou bien en dehors de toute comparaison. Ce degré est constitué par la forme positive de l'adjectif précédé par différents adverbes de quantité, surtout shumë, mjaft, jashtëzakonisht, fort, tepër, etc. Ces adverbes gardent également leur valeur lexicogrammaticale entière et ne se modifient pas en mots accessoires (ils ne perdent ni l'accent, ni le sens lexical et ils jouissent de pleine liberté dans leur insertion avant ou après la forme positive de l'adjectif). En fonction de ce degré on emploie aussi des noms d'objets, dont le trait donné est à un degré très haut, sinon au plus haut (akull, borë, qumësht, prush, flakë, dyllë, etc.). En association avec la forme positive des adjectifs donnés par cette valeur on ne saisit que celle de l'adverbe antécédant (akull i ftohtë — jashtëzakonisht i ftohtë).

Avec la valeur de ce «degré», le langage populaire emploie un grand nombre d'autres expressions.

Comme antonymes à ce degré on doit considérer les constructions: pak i aftë, aspak i mirë, hiç i mirë.

Les différentes «formes» qu'on vient d'analyser peuvent être employées aussi en fonction mutuelle. Ainsi, le positif associé par l'adverbe sa, la particule ç ou répétée, de même quand il est suivi par différentes expressions ou bien par une proposition consécutive, prend la valeur du superlatif.

Le comparatif aussi, dans des constructions du type njëri më i bukur se tjetri assume la valeur du superlatif. Le comparatif s'associe aussi des locutions adverbiales indiquant un accroissement continu du degré de qualité (sa vete e, përditë e, gjithmonë e). Les constructions de ce genre ne sont pas du langage populaire. Le comparatif de supériorité relative est précédé souvent par l'adverbe sa (sa më të gjallë) pour indiquer le maximum possible d'intensité de la qualité. Son usage se circonscrit pourtant à la seule langue littéraire.

SPIRO FLOQI

MBI DISA ÇËSHTJE TË RENDIT TË FJALËVE NË SHQIPEN E SOTME.

Çështja e rendit të fjalëve në fjali (të thjeshtë, të zgjeruar, në fjali të pavarura ose në fjali të varura) nuk ka qenë prekur thuajse fare nga studjuesit e sintaksës shqipe. Ka ekzistuar vetëm ndonjë thënje e shkëputur për ndonjë rast të veçantë, si p.sh. për vendin e kryefjalës të «Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskënishtes» e Ilia Dilo Shepërit (Vlorë 1927), të kallëzuesit në fjalitë e varura kohore, paraqitur nga K. Cipoja në «Sintaksën» e tij të botuar më 1952, dhe nga M. Domi në tekstin e sintaksës për shkollat e mesme (botimi i parë 1954) si dhe thënja e A. Dozonit po për këtë çështje në «Manuel de la langue shqipe ou albanaise», botuar në Paris më 1879.

Në këtë sfond, spikat artikulli «Një rregullë e shqipes mbi rendin e fjalëve» i lingvistit gjerman Klaus Hebler¹, si një punim i posaçëm kushtuar rendit të fjalëve në shqipen e sotme. Autori i artikullit ka marrë në studim një material mjaft të pasur të nxjerrë nga tekstet shqipe në prozë (të shumtën përralla popullore) të botuara nga folkloristët e filologët e huaj Margaret H. Hasluk, Johan Urban Jarnik, Maksimilian Lamberg, Gustav Vaigand, Gustav Majer dhe Holger Pedersen.

Ndonëse materialet e përdorura nga autori nuk kanë të gjitha një vlerë të barabartë dhe ndonëse ai nuk ka pasur parasysh edhe materialet të tjera të prozës popullore të mbledhura e të botuara prej të huajsh a shqiptarësh (si përrallat e botuara nga A. Dozoni, nga Hani, nga Th. Mitko ose nga Spiro Dinja, nga D. Kurti («Përralla Kombtare», Bleu I dhe II, Shkodër 1942, 1943), ato kryesoret që kanë qenë botuar para 1957-ës) prapëseprapë mund të konsiderohet se materiali i studjuar është i mjaftueshëm dhe rregulla kryesore e rregullat shtojcë në përgjithësi u përshtaten edhe atyre.

Me të drejtë autori e sheh të pa mjaftueshëm shqyrtimin e rendit të fjalëve vetëm në dy gjymtyrët kryesore dhe afirmon se duhet «marrë parasysh pozicioni i tyre ndaj gjymtyrëve të tjera të fjalisë». Ai thekson se «për vlerësimin e rendit të fjalëve është vendimtare çështja e pozicionit të kallëzuesit ndaj gjymtyrëve të tjera» (49) dhe shton se, sipas mendimit të tij, «një pikënisje e favorshme për studimin e këtyre marrëdhënjeve, janë fjalitë kohore dhe fjalitë lidhore (Relativsätze)» (f. 49). Në bazë të vrojtimeve të hollësishme të bëra për fjalitë kohore dhe fjalitë lidhore, autori nxjerr rregullat më tipike, dhe pikërisht «një rre-

1) Claus Haebler, *Eine albanische Wortstellungsregel*, «Münchener Studien zur Sprachwissenschaft», 1957, Heft 11 (f. 49-61).

gullë kryesore» dhe dy rregulla shtojcë: «rregullën shtojcë 1» dhe «rregullën shtojcë 2».

Rregulla kryesore është formuluar kështu: «Në fjalitë kohore dhe lidhore, folja kallëzues pason pothuaj pa përjashtim menjëherë lidhëzën kohore të fjalisë së varur, përkitazi përemërin lidhor, pra ka pozicion nistor të mbuluar» — sipas shprehjes së V. Braunit (Wilhelm Braune) dhe E. Kikersit (Ernst Kieckers). Këtë rregull kryesore, autori e ilustron me shembuj të zgjedhur nga proza popullore. Ai jep shembuj për fjalinë kohore prepozitive, interpozitive ose postpozitive me lidhëzat kohore me foljet kallëzues në të tashmen, të pakryerën, të kryerën e thjeshtë dhe të kryerën e mënyrës dëftore (për lidhëzat *kur*, dhe *si*, *mbasi* (*masi*, *pasi*), *sa*, *porsa*, *posa* dhe *nek*); për lidhëzat *porsa*, *deri sa* jepen shembuj me foljet kallëzues në trajta të dëftores dhe të lidhores dhe për lidhëzat *sa*, *deri sa*, *deri që* jepen edhe shembuj me foljet kallëzues në trajtat e së kryerës së thjeshtë të dëftores. «Shembujt, — thotë autori i artikullit, — janë zgjedhur në mënyrë të tillë që prej tyre mundësisht të vihet re edhe pozicioni i kallëzuesit ndaj gjymtyrëve të tjera të fjalisë së varur» (f. 51).

«Kur del kulshedra, kur trumbullohet koha, ato drangojt u apin habere njeni tjetërit.

Nesërmet kur u xgjua zonja në kashtoret e pa se dial'i lypsej, u tremp pa masë.

Si maroi mezin miu, i tha t'jatis përsi.

Pasi shkuan ca dit, djali u bë mir.

Meiher, sa hini djali mrenn, furra u fik krejt.

Nekë bëri që të dil dervishi nga dera, e zunë djelt.

Ky hangër edhe qenarin e laknurit, deri sa u maru krejt.

Prep i lshon plaka ka një lug, deri qi maroi kosin.

Pastaj jepen shembuj për periudhën me fjali «lidhore», me përemrin *që(qi)*, si p.sh.: Këtu, ai zog, që kërkon ti, nuk isht.

Mbi ato llafe, që thosh mbreti me kaiqerinë...

I lumi ti, qi ke një vlla pash, dhe me përemrin *i cili*, *e cila*: «Ishte një her një duhanxhi i ri, i cili kishte një grua të bukur.

Krahas rregullës kryesore autori paraqit edhe dy rregulla «shtojcë». Në *rregullën shtojcë 1* thekson se «Disa fjalë me ton të dobët (schwachtönige Wörter), të cilat pothuajse vazhdimisht shfaqen të lidhura me foljen në një njësi respektivisht të ngulitur, pikërisht mohimet (die Negationen, d.m.th. pjesëzat mohuese) *mos*, *nuk*, *se* (gabimisht për *së*, *s'*) pjesëzat *po* dhe *të*, si dhe trajtat proklitike të përemrave vetorë ose bashkime të këtyre (verbindungen derselben) ruajnë edhe në fjalitë kohore e lidhore pozicionin e tyre proklitik përpara foljes kallëzues» (f. 51). Po japim ndonjë nga shembujt:

Në fjalitë kohore me *kur*: «Kur *m* leu baba, ishe *n* fush.

Kur *po i* afrohesh arës, ky *i* tha *t* jatis.

Kur *e* kan gjet xhinja, kan than.

Kur *t* shkojn bora në trin të kams.

Edhé si *e* bitisnë ustallarët, vate mbreti.

Nek *i* shpuri lagjenë me ujë, klau vajza.

Në fjalitë lidhore, me *që (qi)* dhe *i cili e cila*: por *mos* bashin hajr ata *qi t* kan kallxue.

Ket *pun*, qi *ma* keni kry ju.

Gjeç një kokrr arre, *t* cilën *ja* shtina *n* varr *t* patanit.

Cila të *më* pëlqen, do *t* e marr grua.

Krahas rregullës shtojcë 1, K. Hebleri nxjerr edhe një rregullë shtojcë 2: «Fjalitë e varura, që normalisht u prijnë fjalive të tyre varëse (regierendenden Sätze), e ruajnë gjithashtu këtë pozicion, në qoftë se varen nga një fjali kohore a lidhore, hyjnë pra midis lidhëzës kohore të fjalisë së varur, përkitazi përemrit lidhor dhe foljes kallëzues të fjalisë kohore ose lidhore» (f. 51) për të cilën jepem më pak shembuj, gjithsej katër; ndër ta do të paraqitim vetëm dy: «I dolli një çup e bukurë... e cila pasi e përshëndoshi, e pyeti atë.

Shkoi ke zotnija, i cili, *posa e pa*, i tha.

Rregulla kryesore zbulon me të vërtetë një rregullsi karakteristike, dhe përbën një kontribut të çmuar të autorit në studimin e rendit të fjalëve në shqipen e prozës popullore. Rregulla shtojcë 1, edhe pse konstaton një fenomen të dhënë, nuk ka po atë rëndësi, ndërsa rregulla e tretë, duke marrë parasysh se fjalitë e varura interpozitive nuk janë të zgjeruara dhe s'ka ndonjë mundësi tjetër të vendosjes së gjymtyrëve, nuk përbën ndonjë çështje të ndërlikuar të sintaksës së përrallave popullore.

Si parashtron rregullën kryesore dhe dy rregullat shtojcë, me gjithë shembujt përkatës, autori i artikullit vë re se «vetëm për disa raste relativisht të pakta nuk vlejnë rregullat e mësipërme: midis lidhëzës kohore të fjalisë së varur, përkitazi midis përemrit lidhor e foljes kallëzues futet nganjëherë një gjymtyrë tjetër fjalie (kryefjalë ose plotës rrethane). Siç duket, ajo merr nga ky pozicion i pazakontë një kuptim të veçantë» (58) dhe jep disa shembuj të paktë²: «Një ditë, kur *burri* po nisësh për punë, grua ja i tha:

«Këjo furkë ish ajo të cilën *qerozi* kishte marrë për vlesë prej çupësë nënë dhet'.

«E *passi mezi* e hoqi atë nga vëra, xbriti ndëpër të tri shkallëza poshtë.

Nxurë macen, e cila *me një shpejtësi të madhe* i përzu mijt.

«Prej gjakut plagëvet llamies e cila *mb atë çast* edhe ngordhi.

Sikur të kish hetuar më tej autori i artikullit faktorët që kushtëzojnë këto «përjashtime» nga rregulla, këto mënjanimë nga pozicioni i rëndomtë, kontributi i tij do të kishte qenë i plotë dhe veç kësaj do të kishin dalë edhe faktorët që kushtëzojnë në çdo rast të caktuar mënjanimin nga rendi i rëndomtë. Natyrisht një punë e tillë do të kërkonte mundim edhe kohë, sepse duhet të merreshin parasysh shumë fenomene gjuhësore, por besojmë se për një punë të tillë e vllente barra qiranë. Por K. Hebleri, siç duket, nuk e ka quajtur të mundur këtë, prandaj e ka parë të arësyeshme të kalonte menjëherë në «çështjen» e origjinës së këtij rendi të fjalëve, dhe, duke u mbështetur të thënjet e Thumbit, të A. Carcanosit dhe të E. Kikersit (natyrisht pa kontrolluar më së afërmi as materialet gjuhësore të greqishtes), ai vë re se «Pozicioni i zakonshëm i foljes kallëzues në shqipen... haset në të gjitha hollësitë (nënvizuar prej meje, S.F.) edhe në greqishten e re. Këtu natyrisht folja pason jo vetëm në fjalitë kohore dhe lidhore, por në të gjitha fjalitë e varura *pa përjashtim* (përsëri nënvizuar prej meje, S.F.) ose e ndarë vetëm nga mohimi nga pjesëzat e format përemërore, lidhëzën e fjalisë kohore, pothuajse pa përjashtim fjalën pyetëse dhe lidhoren» (f. 58) Dhe fill mbas kësaj, meqenëse gjuhë të tilla si shqipja, greqishtja, bullgarishtja, makedonishtja (të cilën autori nuk e zë në gojë, me sa du-

2) Nënvizimet brenda shembujve janë bërë prej nesh me qëllim që të duken më qartë fenomenet në shqyrtim në çdo rast.

ket, nuk e konsideron gjuhë më vete) serbokroatishtja, rumanishtja dhe turqishtja kanë mjaft tipare të përbashkëta sa janë quajtur edhe «gjuhë ballkanike» ngre menjëherë çështjen «në mund të konstatohet se në cilën gjuhë e kanë pikënisjen e tyre tiparet e trajtuara më sipër të rendit të fjalëve, në greqishte apo në shqipe» (f. 59). Dhe më në fund konkludon që «njeriu lejohet ta mbajë për probabël (wahrscheinlicher) që pozicioni nistor i mbuluar i kallëzuesit në fjalitë e varura kohore e lidhore të shqipes lidhet me ndikimin grek» (f. 61).

Dhe këtu ndërhyjnë «argumentet» e autorit: «Ndërsa shqipja, — thotë ai, — për shkak të dokumentimit të saj të vonë nuk lejon të konstatohet zhvillimi historik i rendit të fjalëve që është në diskutim, në greqishten situata është pakrahasimisht më e favorshme. Greqishtja klasike ofron një numër të caktuar shembujsh për pozicion nistor të mbuluar të foljes, për më tepër në fjali kohore dhe lidhore, të cilat janë të privuara nga subjekti i tyre (die eines eignen Subjektwortes entbehren). Në greqishten helenike dhe në greqishten e Dhjatës së Re mbizotëron pastaj ky pozicion i kallëzuesit, para së gjithash, në fjalitë lidhore. Këtu pra është përgatitur tashmë situata e cila pastaj u bë zotëruese në greqishten e re, dhe pikërisht për gjithë fjalitë e varura» (f. 59-60).

Autori e ka ndërje edhe vetë se sa të paqëndrueshme janë argumentet që sjell, prandaj shton se «Edhe në qoftë se nga këto të dhëna nuk mund të fitohet një kriter i sigurtë për përgjigjen ndaj pyetjes së bërë, prapëseprapë duket më probabël (so mutet es doch wahrscheinlicher an, nënv. prej meje, S.F.) që greqishtja është pikënisja e atij rendi karakteristik fjalësh që i korespondon njëherazi edhe shqipes» (60), por këtë «duket më probabël» autori nuk e përforcon me tjetër gjë veçse me «argumentin tjetër», d.m.th. që «Greqishtja ka ushtruar një ndikim zotërues të dokumentueshëm mbi shqipen dhe gjuhët e saj fqinje, ndërsa një ndikim në drejtimin e kundërt — duke mos marrë në konsideratë anën leksikore — deri tani nuk është konstatuar» (50). Duke u mbështetur te opinioni i K. Sandfeldit shprehur në veprën «Linguistique balcanique» lidhur me pozicionin e foljes të fjalitë me një folje në lidhore (që ka zëvendësuar infinitivin) në greqisht, në shqip të, rum. *să*, blg. *da*, autori i lejon vetes «ta mbajë për probabël, që pozicioni nistor i mbuluar i kallëzuesit në fjalitë e varura kohore e lidhore të shqipes lidhet me ndikimin grek» (61).

Shkurt argumentimi i tezës së autorit mbi karakterin e huazuar të rendit të fjalëve në fjalitë kohore e lidhore ka ecur në këtë rrugë:

1) Shqipja e greqishtja si «gjuhë ballkanike» kanë mjaft tipare të përbashkëta: leksikore, morfologjike e sintaksore; duhet gjetur burimi i tyre: ky burim nuk mund të jetë tjetër veç greqishtes e shqipes.

2) Shqipja është dokumentuar vonë si gjuhë e shkruar, prandaj nuk mund të ndiqet historia e zhvillimit të kësaj çështjeje në gjuhën shqipe, kurse greqishtja është dokumentuar shumë më parë, prandaj ajo na jep mundësi të ndjekim historikun e zhvillimit; greqishtja ka ndikuar mbi shqipen për rendin e fjalëve, sepse terreni i përgatitur që në greqishten e vjetër u përforcua dhe u përgjithësua në greqishten e re ku rendi nistor i mbuluar i foljes kallëzues është normë jo vetëm në fjalitë kohore e lidhore, por në gjithë tipet e fjalive të varura pa përjashtim.

3) Megenëse greqishtja ka ushtruar ndikim të gjithanshëm mbi gjuhët ballkanike në përgjithësi e mbi shqipen në veçanti, nuk ka se si të mos ketë ndikuar greqishtja mbi shqipen dhe në këtë çështje, pra shqipja e ka marrë hua rendin e fjalëve nga greqishtja.

Argumentat e autorit tonë nuk janë të thella, bindëse. Ato mbësh-

teten vetëm mbi konstatime të sipërfaqshme, të cilat nuk mund t'i qëndrojnë një vështrimi më të thelluar dhe të shumanshëm.

Për këtë ne do të shqyrtojmë çështjen e materialit faktik dhe të qëndrimit ndaj tij, çështjen se a i përgjigjet gjithë shqipes «rregulla kryesore» dhe çështjen se deri ku rendi i fjalëve të greqishtes së re është aq i normuar, i fiksuar sa e pandeh autori i artikullit dhe nga ana tjetër a kemi elemente për të shqyrtuar, së paku në këtë fazë, rendin e fjalëve në shqipen dhe greqishten si diçka që lidhet me strukturën e thellë të brendshme të secilës gjuhë dhe a mund të mendojmë se kemi të bëjmë me ndonjë influencë të greqishtes mbi shqipen.

E para, çështja e materialit faktik. Tekstet në prozë (të shumtën përralla) që ka marrë në shqyrtim, autori i konsideron se «mund të vlejné si pasqyrim direkt i gjuhës së folur» (f. 50, shën. 5), d.m.th. autori deklaroi se ka për qëllim të shqyrtojë rendin e fjalëve në gjuhën e folur. Porse materiali i përdorur nuk përligj qëllimin dhe kjo përbën një të metë të rëndësishme të punimit: aty përzjehen fragmentet në prozë të paraqitura në tekste mësimore ose në gramatika të ndryshme si fragmente të gjuhës së folur, dhe veç kësaj pjesa më e madhe e fragmenteve janë përralla popullore, kështu që në fakt autori nuk shqyrton rendin e fjalëve në ligjërimin e folur, por rendin e fjalëve në një lloj të caktuar stilistiko-gjinor të krijimtarisë letrare popullore, në përrallat popullore. Po në këtë mes është harruar karakteri specifik gjuhësor i përrallave popullore. Konstruktet që përdoren në përrallat popullore, kushtëzohen nga dy faktorë kryesorë: nga forma e tyre (tregim i folur), dhe nga brendia e tyre. Forma e ligjërimin të folur duhet të perceptohet pa vështirësi dhe menjëherë nga dëgjuesi, dhe kjo është lidhur me destinacionin e përrallës, prandaj të përrallat fjalitë kanë një strukturë sa më të thjeshtë. Brendia e përrallave përqëndrohet në tregim veprimesh e ngjarjesh, pra te përralla aksioni, veprimi është esenca. Peripecitë e heroit ose heronjve jepen në mënyrë përparuese që shtjellimi të mbrijë fundin pa stërgjatje të tepëruara. Duke qenë se karakteristika kryesore e brendisë së përrallave është aksioni, veprimi, pra peshë të madhe komunikative, kumtesore, kanë foljet, kallëzuesit, të cilët edhe luajnë një funksion kryesor në strukturën e fjalive dhe të periudhave. Për këtë arsye, strukura sintaksore e fjalisë a e periudhës te përrallat kushtëzohet nga veçoritë stilistiko-gjinore të përrallës si gjini kallëzimitare, monologjike, mbushur me hollësira veprimesh, por jo me përshkrime karakteristikash, përshkrime të natyrës a të rrethanave, as me ndonjë vlerësim emocional a intelektual të këtyre ngjarjeve e veprimeve. Prandaj mendojmë që për materialin faktik të shqyrtuar do të ishte më i drejtë një titull tjetër, si p.sh.: «Një rregullë mbi rendin e fjalëve në përrallat popullore shqiptare». Nga ana tjetër, gjuha e folur, siç dihet mirë, ka disa karakteristika suplementare që nuk i ka gjinia kallëzimitare, monologjike: ajo përdor sidomos dialogun. Gjuha shqipe, veç kësaj, ndërthen edhe një varg stilesht të tjera si stilin e letërsisë artistike, stilin e letërsisë publicistike, stilin e shkresave të administratës dhe stilin e letërsisë shkencore etj.

Në përrallat popullore shqiptare, rendi i fjalëve ose vendi i kallëzuesit, i kryefjalës etj. është pikërisht ashtu siç thotë K. Hebleri, por në variantet e tjera stilistiko-gjinore të gjuhës shqipe, në gjuhën letrare, të shkruar dhe të folur, rendi i fjalëve nuk është i fiksuar, është më i lirshëm dhe kushtëzohet, me sa kemi hetuar gjer tani, nga tri arsye kryesore: 1) nga arsye thjesht strukturore; 2) nga arsye të peshës kumtesore të një gjymtyre a të një grupi gjymtyrësh të caktuara gjatë zbër-

thimit aktual të fjalisë (aktuellné členění větné, sipas terminologjisë së linguitit të njohur çek Vilem Mathesius), ku rendi i fjalëve a gjymtyrëve të fjalisë përcaktohet nga fakti i rëndësisë kumtesore që kanë ato për kumtimin e «së panjohurës», lidhur «me të njohurën», dhe 3) për arësye të nuancave kuptimore të reja te cilat mund të jenë suplementare dhe të mbishtrohen mbi kuptimin themelor të një tipi të caktuar periudhe me fjali të varur (deri sa të arrijnë tek ndërrimi i gjithë kuptimit themelor).

K. Hebleri, me të drejtë, vë në dukje karakterin e pamjaftueshëm të shqyrtimit të rendit të fjalëve vetëm tek rendi «kallëzues-kryefjalë», por megjithatë vetë lejon një gabim kur, ndonëse thekson se «çështja e pozicionit të kallëzuesit ndaj gjymtyrëve të tjera është vendimtare», prapëseprapë në shqyrtimin e materialit dhe në parashtrimin e rregullës kryesore dhe të rregullave shtojcë, nuk shikon në rendin e kallëzuesit ndaj gjymtyrëve të tjera, por rendin e kallëzuesit ndaj mjetit të lidhjes, lidhëzave kohore ose përemrave a ndajfoljeve lidhore. Kjo e shpie në fakt te një vështrim i pozicionit të kallëzuesit në kundërshtim me vetë thënjen e vet: ai për të qenë konsekuent me thënjen e vet duhej të studjonte jo më rendin «kallëzues — mjet i lidhjes» në mënyrë absolute, pra edhe mekanike, por si diçka relative, si diçka të lidhur në mënyrë të shumanshme, pra rendin e kallëzuesit e të kryefjalës; rendin e kryefjalës, kallëzuesit e kundrinës, rendin e kryefjalës — kallëzuesit — plotësit rrethanor; rendin kryefjalë-kallëzues-kundrinë-plotës rrethanor e të tjera kombinime të kryefjalës, kundrinës, plotësit rrethanor, jo vetëm ndaj kallëzuesit por njëherazi ndaj kallëzuesit dhe gjymtyrëve të tjera, rendin «emër+cilësor» (emëror, mbiemëror, ndajfoljor), dhe për këtë është i domosdoshëm shqyrtimi i një materiali ku të figurojnë gjymtyrët përkatëse, prandaj kanë pasë të drejtë linguitët shqiptarë etj. që kanë shqyrtuar pozicionin e kallëzuesit ndaj kryefjalës vetëm tek ato raste kur fjalia ka «një kryefjalë të vetën».

Kështu që nga pikëpamja e pozicionit të kallëzuesit ndaj gjymtyrëve të tjera të fjalisë, dy tipet e fjalive që shqyrton autori, nuk janë të njëvlershme. Puna është se, siç dihet, lidhëzat nuk janë gjymtyrë të fjalisë ku ndodhen, dhe pozicioni i kallëzuesit ndaj gjymtyrëve të tjera rregullohet jashtë ndonjë funksioni gjymtyror të mjetit të lidhjes. Një gjë e tillë nuk ndodh te fjalitë lidhore. Mjetet e lidhjes së këtyre fjalive, përemrat dhe ndajfoljet lidhore, kryejnë njëkohësisht dy funksione: funksionin lidhëzor, atë të lidhëzës, dhe funksionin gjymtyror në fjalinë e varur, d.m.th. janë edhe gjymtyrë të fjalisë së varur, sipas funksionit të fjalës lidhëse në togfjalëshin përkatës emëror ose foljor. Por pozicioni i mjetit të lidhjes në fjalitë e varura lidhore të shqipes (ashtu si edhe në shumë gjuhë indoevropiane) është i fiksuar, ai ndodhet gjithmonë në krye të fjalisë së varur (ndonjë rast përjashtimi do ta parashtrojmë më poshtë), kështu që fjalia lidhore fillon me një gjymtyrë fjalie me pozicion të ngulur, të fiksuar. Funksioni gjymtyror i mjetit të lidhjes — si kryefjalë, si kundrinë (e drejtë, e zhdrejtë pa parafjalë, e zhdrejtë me parafjalë), si plotës rrethane etj. e vë kallëzuesin në një pozicion të domosdoshëm pas kësaj gjymtyre, pra këtu pozicioni i kallëzuesit del vetë i fiksuar për shkak të pozicionit të fiksuar të mjetit të lidhjes — gjymtyrë e fjalisë, dhe në këtë rast kemi tjetër raport midis rendit të fjalëve, nga sa kishim te fjalia e varur kohore: këtu kemi raportin «kryefjalë — kallëzues», «kundrinë-kallëzues», «plotësor rrethane — kallëzues» etj., qysh nga mjeti i lidhjes.

Le të shohim pra modelin (të thjeshtuar) te «shtëpia që duket», (= e cila, kryefjalë), shtëpia që ndërtojmë (= të cilën, kundrinë e drejtë), shtëpia

së cilës i hodhën çatinë (kundrinë e zhdrejtë pa parafjalë), shtëpia për të cilën biseduan (kdr. e zhdr. me parafj.); po kështu edhe vendi ku a nga (plotësor rrethanor vendi), koha kur (plotësor rrethanor kohe) arësyeja, shkaku pse (plotësor shkaku), mënyra (se) si (plotësor mënyre) etj. Pra funksioni i dyfishtë lidhëzor dhe gjymtyror i përemrave dhe ndajfoljeve lidhore e vë kallëzuesin në pozicion varësie ndaj pozicionit të tyre, d.m.th. kallëzuesi s'ka se si të mos vijë (menjëherë ose jo), pas këtyre gjymtyrëve, pozicioni i tij është gjithmonë «i mbuluar», por në çdo rast përkatës nga një gjymtyrë e ndryshme e fjalisë së varur.

Edhe më i mbuluar, dyfish i mbuluar, në mund të shprehemi kështu, del pozicioni i kallëzuesit në një nëntip të fjalisë lidhore, ku i mbuluar del edhe vetë mjeti i lidhjes, vetë përemri lidhor *i cili, e cila* etj. në rasën gjindore. Në këtë rast përemri lidhor zë pozicionin që i përcaktohet nga funksioni i tij atributiv ndaj emrit, i cili hap fjalinë e varur. P.sh.: prindët, fëmijët e të cilëve; . . . rrugët në anët e të cilave. Këtu rendi i gjymtyrëve të fjalisë së varur ndaj njëri-tjetrit mund të jetë: kryefjalë, kundrinë, plotësor rrethane — plus një fjalë a një tog fjalësh që përcaktojnë atë si emër — plus një plotësor cilësonjës të shprehur me anën e përemrit lidhor + (. . .) folja kallëzues.

Këtu pasqyrohet një veti e rendit të fjalëve në togfjalëshin përkatës «Emër + Emër në gjindore» i cili për shqipen është i vetmi rend ekzistues, rend i ngulur në sajë të lidhurisë shumë të ngushtë të fjalëve përbërëse, lidhuri që është aq e ngushtë sa duke u transpozuar në periudhë me fjali të varur, bën të spostohet nga «kryeja e këndit» tradicional vetë mjeti i lidhjes, përemri lidhor *i cili* në rasën gjindore.

Mund të themi se në shqipe kemi tri raste kryesore të pozicionit të kallëzuesit ndaj gjymtyrëve të tjera në fjalitë e varura (të shtjelluara):

1) në fjalitë lidhëzore, me lidhëza, pozicioni i kallëzuesit dhe ai i kryefjalës nuk kanë varësi të drejtëpërdrejtë nga pozicioni i mjetit të lidhjes; veçse do pasur parasysh se një palë lidhëza mund të ushtrojnë një ndikim të tërthortë mbi rendin e fjalëve nëpërmjet të semantikës së tyre, siç janë p.sh. lidhëzat kohore me prejardhje nga ndajfoljet; kurse lidhëza të tjera, si lidhëzat ffillonjëse *se, që* janë lidhëza «boshe» nga ana semantike, janë «shenja boshe» të varësisë së një fjalie nga një tjetër, dhe nuk kanë një ndikim të tillë mbi rendin e gjymtyrëve të fjalisë.

2) në fjalitë lidhore pozicioni i foljes — kallëzues është kushtëzuar nga pozicioni gjymtyror i demodsoshëm i mjetit të lidhjes, përemrave e ndajfoljeve lidhore, që janë gjymtyrë të ndryshme të fjalisë së varur lidhore;

3) pozicioni i foljes-kallëzues është akoma më i kondicionuar (bile këtu është i kondicionuar, i paracaktuar edhe vetë pozicioni i mjetit të lidhjes, kësaj here përemrit lidhor *i cili, e cila* në rasën gjindore, kur mjeti i lidhjes del i mbuluar nga një emër), dhe pozicioni i kallëzuesit del i mbuluar dyfish: edhe nga emri i parë i togfjalëshit atributiv emëror edhe nga mjeti i lidhjes gjymtyrë cilësonjëse në togfjalëshin atributiv (rastet e cilësimit të mëtejshëm të vetë emrit me fjalë përcaktonjëse ose me togfjalëshe me bashkërenditje, prapë me funksion përcaktonjës, nuk ngrejnë më kandar).

Arësye thjesht strukturore përcaktojnë në shqipen e sotme edhe pozicionin e kryefjalës, të kallëzuesit dhe të mjetit të lidhjes në një nëntip të fjalisë së varur lidhore. Në këtë rast pozicioni i gjymtyrëve përkatëse dhe i mjetit të lidhjes është krejt i ndryshëm në të dy gjuhët.

Në fjalitë e varura lidhore, ku përemri lidhor është në rasën gjindore

pozicioni i tij është i paracaktuar nga kohezioni i rendit të fjalëve në togfjalëshin «Emër + Emër në rasën gjindore», kështu që marrëdhënjet midis kryefjalës dhe kallëzuesit si dhe ato midis këtij dhe gjymtyrëve të tjera përcaktohen nga funksioni i emrit të parë të togfjalëshit emëror atributiv: kryefjalë, kundrinë, plotës rrethane.

Një rend i tillë është i rëndomtë jo vetëm në stilin publicistiko-shkencor, por edhe në stilin e letërsisë artistike. Po japim për ilustrim në krye disa shembuj nga vepra të stilit publicistiko-shkencor dhe më pas nga letërsia artistike:

Martesa (e Skënderbeut) ishte e nevojshme, se me këtë sigurohej alianca me princin më të fortë të Toskërisë, NDIHMA USHTËRIAKE DHE FINANCIALE E TË CILIT *ish e domosdoshme* për pasimin e luftës. . . / Noli, Historia e Skënderbeut, Boston Mass. 1921, f. 185/.

Kooperativat e artizanatit, RRJETI I TË CILAVE *shtrihet* në pjesën më të madhe të vëndit, realizuan planin e dytë pesëvjeçar 9 muaj para afatit dhe 5 muaj para zotimit /E. Hoxha, Raport mbi aktivitetin e K.Q. të PPSH, T. 1961, f. 46/.

1) Tek tuk ndriçonte ndonjë llampë e zbehtë elektriku, *drita* e së cilës *binte* në gropat me ujë / Gjata, Këneta, 437/.

. . . ngriti vetullat e holla, maja e të cilave sa nuk çikte kaçurrelat pranë tëmthave. . . /A. Abdihoxha, Përmbysja, «Ëndra dhe dritë», T. 1963, 154.

U tërhoq zvarrë drejt Palit e nisi të kthehet zvarrë tatëpjetë me të plagosurin, *rënkimet* e të cilit *sa vinin e bëheshin* më të dobta/. Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, kap. II, T. 1955, f. 78/.

I vinte keq për vogëlushët, *shumica* e të cilëve *vinin* nga fshatrat për rreth /T. Laço, Rruga e bardhë, T. 1964, 35/.

2) Flitej se ishin vlarë dy a tre shokë, *emrat* e të cilëve Rrem Gurrsi nuk i dinte /Sh. Musaraj, Para Agimit, v. I, T. 1965, f. 246/.

— Ulemi! — pranoi Pucelli.

Mengadalë vendosi të vdekurin, *fytyrën* e të cilit e kish mbuluar me shaminë garibaldine / P. Marko, Hasta la vista, T. 1958, f. 328/.

Përkitje midis dy gjuhëve ka në rast se fjala sunduese e përemrit lidhor në togfjalëshin përkatës paraqitet si një plotës rrethanor, rendi i gjymtyrëve kryesore të fjalisë përcaktohet në radhë të parë nga semantika rrethanore e gjymtyrës së parë të fjalisë që sjell menjëherë pas vetes pozicionin e kallëzuesit të pasuar nga kryefjala, si të shembujt e mëposhtëm:

Eci në rrugicën e vogël të kopshtit, NË ANËT E SË CILËS *nuk ngrihen drurë* të gjelbër, por grykat e blerta të topave /I. Kadare, Në muzeun e luftës, «Qyteti i jugut», T. 1967, f. 21/.

Fill nga bregu i kënetës së dënuar shkuam në kryesinë e kooperativës, BRËNDA TOKAVE TË SË CILËS *shtrihej ajo* /Po ai, Këneta e Konisbaltes, po aty, 197/.

Tashti e pati ajo, — u përgjegj i penduar Hakiu e vazhdoi të qëllojë në një ferrë, PRAPA DEGËVE TË THATA TË SË CILËS *lëvizte një ushtar armik* /F. Gjata, Prova e madhe, «Në pragon e jetës», T. 1960, f. 71/

Në ndonjë rast si p.sh. kur kemi një periudhë me dy fjali lidhore, një të shkallës së parë dhe një të shkallës së dytë; në fjalinë e shkallës së parë ky rend mbështetet edhe nga arësye të tjera thjesht gramatikore, kur këmbimi i rendit të kallëzuesit me atë të kryefjalës jo vetëm është i pamundur për arësye të strukturës së fjalisë ku ata ndodhen, por edhe për arësye se fjalia lidhore që pason (e dyta) duhet të ndodhet menjëherë pas emrit (a grupit të emrit) që cilëson:

I shqetësuar, herë vështronte orën e dorës dhe herë digën, **MË TË DY ANËT E SË CILËS** *ishin dy eskavatorë* që prisnin urdhërinë e tij për të çarë argjinaturën / Gjata, Kënetë, T. 1959, f. 472 /. Këtu kemi nga një anë pamundësinë për të thënë «më të dy anët e së cilës **dy eskavatorë** ishin» por edhe pamundësinë për të thënë **dy eskavatorë ishin** QË prisnin urdhërinë», sepse midis përemrit lidhor që dhe emrit antecedent *eskavatorë* ka hyrë kallëzuesi i fjalisë varëse *ishin* (= ndodheshin), që është në kundërshtim me veçorinë e periudhës në fjali të varur lidhore, ku fjalia e varur nuk mund të ndahet nga emri a përemri antecedent veçse me gjymtyrë të dyta përcaktokjese.

Në shqipen letrare dhe në greqishten e re kemi koincidencë për nga pozicioni i kallëzuesit dhe i kryefjalës së fjalisë lidhore me përemrat lidhorë përkatës shqip *i cili*, greq. *ὁ ὅποιος* me ose pa parafjalë.

Mënyra **ME TË CILËN** *u fitua beteja* e Nartës është për të vënë re, se do ta shohim të përsëritet disaherë prej Skënderbeut në rrethimet e Krujës / Noli, Historia e Skënderbeut, Boston 1921, f. 35 /.

— Trimëria fitohet pak nga pak, në ndeshje e sipër. Po influencojnë, sigurisht, edhe rrethanat, **NË TË CILAT** *është rritur njeriu*, edhe mënyrat, **ME TË CILAT** *është edukuar* / Sh. Musaraj, Para agimit, vëll. I, T. 1965, f. 354 /.

Krahaso rendin «kallëzues-kryefjalë» të shembujt e mëposhtëm të greqishtes së re (janë nxjerrë nga vepra e A. Carcanosit 3).

Ὁ Θεοφιλίτης σάν τελείωσε τή δουλειά, γιά τήν ὁποία τόν εἶχε στείλει ὁ βασιλέας. (= punën, për të cilën e kish dërguar mbreti), *γύρισε στήν Πόλη: Φώτη Κόντογλου*, te A. Τζαρζάνος, l.c, vll I, 164.)

Τό μοναστήρι εἶχε κελλιά, μέσα στά ὁποῖα καθόντανε παρθένες καλόγριες (ka qeli brenda të cilave banojnë murgesha), te po ai, po aty, f. 164.

Po për shqipen nuk është karakteristik përdorimi i përemrit lidhor që, përemër i pandryshueshëm dhe që nuk shoqërohet dot me parafjalë, ndërsa në greqishtet përemri lidhor përkatës *πού* përdoret rëndom edhe me vlerën e përemrit *ὁ ὅποιος* me parafjalë të ndryshme:

Ὁ κῆπος εἶνε τοῦ γιου μου, πού ἡ γυναίκα του θά πάρη ἄλλον ἄντρα (= τοῦ ὁποίου ἡ γυναίκα), te Carcanos, I, f. 165.

Εὐτύχησε νάναδρέψη ποιητάς, πού ἡ δόξα τους δέν εἶνε ἐφήμερη (τῶν ὁποίων ἡ δόξα) te po ai, po aty, f. 165.

Ἔτσι ὁ ἀναγνώστης θά νιώση καλύτερα καί τήν ἀτμόσφαιρα, πού μέσα της δροῦν τά πρόσωπά μου (= ἔντος τῆς ὁποίας) te po ai, po aty, f. 165.

Te fjalitë e varura lidhore rendi «kryefjalë-kallëzues» është i fiksuar, i përcaktuar nga funksioni kryefjalor i mjetit të lidhjes; përemrit lidhor:

Prej këtyre shpëton «Karadaku», *i cili*, pas shumë vuajtjesh, **kthehet** me një pjesë të mirë të shokëve të mbetur / M. Shehu, Kujtime nga jeta e Brigadës së I^{re} Sulmuese, T. 1959, f. 39 /.

Moretua dhe Pucelli ishin pranëpranë pas maqinës së Alvarezit, *i cili bisedonte* me Asimin / P. Marko, Hasta la vista, T. 1958, f. 31 /.

Edhe Rifua e puthi xha Telon, *i cili* e **gëzoi** në shpatulla me dashuri si djalin e tij / Z. Sako, Njerëz dhe ngjarje, T. 1961, 95 /.

Kthehemi në muajin e Vjeshtës së Parë të vitit 1913 në Korçë, *e cila*

3) ΑΧΙΛΑ. Α. ΤΖΑΡΤΖΑΝΟΥ, ΝΕΟΕΛΛΗΝΙΚΗ ΣΥΝΤΑΞΙΣ (ΤΗΣ ΚΟΙΝΗΣ ΔΗΜΟΤΙΚΗΣ), δεύτερη ἔκδοσις. ΤΟΜΟΣ Α', Ἐν Ἀθήναις 1946, ΤΟΜΟΣ Β' (ΑΝΑΤΥΠΩΣΙΣ), Ἐν Ἀθήναις 1963.

gjendej nën thundrën e grekërve... / F. Postoli, Për mbrojtjen e Atheut, krye XIII, f. 147 /.

Po ky pozicion i kallëzuesit ndaj kryefjalës në gjuhën shqipe është i rëndomtë edhe në rastet kur kallëzuesori (fr. prédicatif, gjerm. prädikativ) mban peshën kumtesore kryesore të fjalisë së varur, kur pesha kumtesore e kryefjalës nuk është aqë e rëndësishme. Një zhvendosje e kryefjalës pas kallëzuesit do t'i jepte asaj një theksim jashtëzakonisht të fuqishëm, gjë që nuk pajtohet me situatën reale.

Në fund të oborrit nxinte një kasolle e vogël, **QË plaku** i kishte thënë **shtëpi**. / Dh. Xhuvani, Gabimi i pandreqshëm, «Këmbana e fundit», T. 1957, f. 118 /.

Nesti Troloja, TË CILIN të gjithë në Korçë e thërrisnin **Nesti Furxhiu**, ishte mëmëdhetar i flaktë dhe anëtar i Komitetit Revolucionar / Th. Kacori, Për mëmëdhenë, pjesa e dytë, T. 1961, f. 149 /.

2. Në fjalitë kohore, rendi kryefjalë-kallëzues kushtëzohet nga arësye të zberthimit aktual të fjalisë. P.sh.

Gjysmë ore më vonë, Tana e pa Stefanin rrugës, **KUR ajo këthehej** në shtëpi me gjyshin / F. Gjata, Tana /.

2) Xha Mili e kishte ndjekur (të vëllanë) me sy **DERI SA ay (=ky)** **kishte humbur** nëpër pemët / A. Mara, Shtëpi e Xha Milit, 48 /. Rendi «kryefjalë-kallëzues» te këto fjali të varura kohore është kushtëzuar nga pesha kumtesore e gjymtyrëve kryesore. Një rend i anasjelltë «kallëzues-kryefjalë» do t'i jepte kryefjalës një peshë kumtesore jashtëzakonisht të rëndësishme, gjë që do t'i binte ndesh situatës reale të pasqyruar në periudhë.

3) **KUR trarët, shtyllat dhe dërrasat e thata të shtëpive shekullore u kthyhen në qymyr**, flaka ra disi, por fuqia e zjarrit u bë më e ashpër / A. Abdihoxha, Vjeshtë me stuhi, T. 1959, 79 /. Në këtë fragment grupi i kryefjalës (d.m.th. kryefjala e shoqëruar nga gjymtyrët që varen prej saj) është shumë i gjerë, prandaj pozicioni i tij prepozitiv ndaj kallëzuesit ndihmon të vihet në dukje pesha kumtesore e kallëzuesit, si më e rëndësishmja, për hir të së cilës bëhet kumtimi, sepse për ndryshe ajo do të paraqitej si diçka e dorës së dytë, e parëndësishme a neutrale.

4) Në një gjendje të këtitllë, **KUR gjermanët po tërhiqen** me gjithë mënd, **KUR Balli Kombëtar është në disgregacion të plotë**, **KUR Ora e Madhe e çlirimit të Shqipërisë ka rënë**, Abaz Kupi i Legalitetit mundohet që të çfrytëzojë rastin e të marrë pushtetin në dorë / M. Shehu, Lufta për çlirimin e Tiranës /.

5) Tashti, **KUR dielli filloj të djegë, etja po e mundonte shumë** / F. Gjata, Armiqtë, «Nëndori» 1964, № 1, f. 48 / Në fragmentet (4), (5) pozicioni prepozitiv i kryefjalës dhe i grupit të saj ndaj kallëzuesit është përcaktuar edhe nga nuanca e shkakut që merr fjalia e varur kohore, nuancë që ka bërë të mundur vendosjen e këtij rendi të gjymtyrëve kryesore, ashtu si te fjalitë e varura shkakore me të njejtin kuptim.

Në shembullin e mëposhtëm, veç arësyes së zberthimit aktual të fjalisë së varur, në rendin e fjalëve ka ndikuar edhe nuanca semantike e mospajtim-lejimit që del në strukturën e periudhës me fjali të varur kohore në sajë të përqasjes së brendive reale të fjalive; rendi kryefjalë kallëzues është ashtu si te fjalitë e varura lejore, me vlerë stilistike-kumtesore neutrale.

E dashura ime Afrëditë, ç'brenjë e fshehtë të mundon ty sot **KUR gjithë jemi të gëzuar** për këtë ditë? / M. Grameno, Varri i Pagëzimit, f. 28 /.

Në rast se periudha me fjali të varur me lidhëzën kohore *kur* ka ka-

llëzuesit në trajta kohore që tregon mbarëkohëshmi ose përsëritje në kohë, mbi kuptimin kohor shtrohet nuanca e kushtit, dhe atëhere bëhet i mundshëm përdorimi i rendit «kryefjalë-kallëzues», që gjen mbështetjen e vet edhe te gjymtyrimi aktual i fjalisë së varur. Në shembullin e mëposhtëm, para fragmentit të cituar, është bërë fjalë për Malin e Prerë, i cili, si çdo mal, ka edhe një majë, pra nga ky fakt, togfjalëshi «maja e tij», përbën «pikënisjen» e thënjes. «temën», «të njohurën», dhe mbi këtë mbështetet autori për të treguar «rhemën», «të renë», «të panjohurën», atë që mban peshën kumtesore kryesore dhe për hir të së cilës bëhet kumtimi, prandaj kryefjala, grupi i kryefjalës, vendoset para kallëzuesit.

Kur *maja e tij mbulohet me një rreth resh bojë hiri*, atëherë (. . .) dimri është i afërt / A. Mara, Shtëpia e Xha Milit, 58 /.

Rendin «kryefjalë-kallëzues» në fjalitë lidhore e lejon shpesh edhe tipi semantiko-strukturor i periudhës: periudha ka një fjali të varur përcaktore shtjelluese ose përshkruese, d.m.th. me anën e fjalisë së varur i jepet emrit antecedent një karakteristikë suplementare, jo të domosdoshme për karakterizimin e tij. Në këtë rast nën trajtën e strukturën e periudhës me fjali të varur përcaktore (atributive) fjalia e varur mund të përbëjë, sipas rastit, ose një fjali të varur me vlerën e një fjalie të bashkërenditur këpujore, ose me vlerën e një fjalie të bashkërenditur kundërshtore, në varësi nga kallëzuesi pohor, përkritazi mohor i fjalisë përcaktore.

Kam një shok QË ti e **njeh**: Agronin / J. Alibali, Pritja, «Vajza prej Oroshit», T. 1962, f. 65 / (këtu përafërisht baraz me «kam një shok, dhe ti e njeh»).

— Ç'kërkoni? — e pyeti përsëri burri me gjyzykë, duke i hedhur Stavrit një vështrim të dyshimtë e tërë frikë. QË Stavri s'e vuri re / F. Gjata, Këneta, T. 1959, f. 5 /. Këtu «. . .një vështrim të dyshimtë e tërë frikë, por Stavri nuk e vuri re». Po kështu edhe te shembulli i mëposhtëm.

Gjatë këtyre pesëqind vjetëve, në Egjipt kishin sunduar trembëdhjetë faraonë të tjerë, PËR TË CILËT *Shoqata* Botërore e Historianëve s'dinte gjë / Q. Buxheli, Një ndodhi në plazh. T. 1962, f. 29 /.

Në raste të tjera, në fjalinë e varur lidhore është i rëndomtë rendi «kryefjalë-kallëzues» për shkak të semantikës ftillëzonjëse të fjalisë së varur, d.m.th. se fjalia e varur lidhore ka të bëjë me një emër me kuptim abstrakt, rëndom të kumtimit e të një procesi mendor, si p.sh. *teza*, *legjenda*, *mendimi* etj., brendinë konkrete të së cilës e shpjegon, e ftillëzon fjalia e varur. Fjalia e varur lidhore (përcaktore, atributive) mund të kryejë në këtë rast funksionin ftillëzonjës në sajë të togut të formuar prej parafjalës *sipas* dhe përemrit lidhor, gjë që i jep mundësi gjithë togut të funksionojë në këtë rast me vlerën e lidhëzës ftillonjëse *se* ose *që*. Fjalia e varur, me modalitetin e një deklarate ka rend të rëndomtë të gjymtyrëve kryesore ashtu si në fjalitë përcaktore shpjeguese pranemërore⁴, sepse kryejnë funksionin atributiv shpjegues nëpërmjet të ftillëzimit të brendisë reale të një gjymtyrë të shprehur me një emër me kuptimin leksikor të ligjëritimit, të deklaratës, opinionit etj.

4) Me termin «fjali përcaktore shpjeguese pranemërore» kemi quajtur fjalitë e varura lidhëzore (me që bashkohen me lidhëza) që kanë të bëjnë me një emër antecedent të fjalisë kryesore (prandaj edhe janë quajtur «pranemërore») dhe që kryejnë funksionin e përcaktimit, e cilësimit nëpërmjet të «shpjegimit», ftillësimit, konkretizimit të brendisë reale të emrit, i cili është përherë emër abstrakt dhe me semantikë të caktuar kumtimi, mendimi, opinionit ose te një gjendjeje të brendshme.

Kështu, ekziston një mendim, SIPAS TË CILIT PUNIMI i vendimeve të komiteteve të partisë në organizatat bazë i **rëndon** këto dhe u pret inisiativën / E. Hoxha, Revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës, T. 1967, 9 / këtu: «... një mendim, sipas të cilit...» = një mendim që pohon se... ose *mendimi se*).

Ahere fshatarët filluan të krijojnë legjenda SIPAS TË CILAVE *këneta nuk kishte për t'u tharrë* kurrë / F. Gjata, Ujrat e Verdha, «Në pragun e jetës», T. 1960, f. 26 /.

Siç shihet, në politikën e saj ekonomike lidhur me industrializimin socialist të vendit, partia jonë, me gjithë ekzistencën e veçorive ka gjithnjë parasysht *tezën leniniste* SIPAS SË CILËS *industria* e rëndë është baza e industrializimit socialist / E. Hoxha, Raport mbi aktivitetin e KQ të PPSH, T. 1961, f. 65.

Sintaksisti grek A. Carcanos, autori i veprës së njohur «Sintaksa e greqishtes së re»⁵ pohon se «Në fjalitë e dyta folja e ka vendin rregullisht (*κανονικά*) menjëherë pas fjalës që fillon fjalinë e dytë, dhe kryefjala dhe gjymtyrët e tjera kryesore ose të dyta të fjalisë vijnë pas saj» dhe jep nga një shembull me lidhëzat *άν, όταν, πώς, σαν*: këtë rregullë e ngushton duke përjashtuar pjesëzat *δέν, μή* ose ndonjë nga fjalët *θα, να*, tipet proklyktike dhe enklitike të përemrave vetorë ose trajta paralajmëruese a përsëritëse të përemrave *τύποι της προληπτικής ή επαναληπτικής άντωνυμίας*: «këto fjalë edhe këtu zënë vend përpara foljes, midis fjalës që çel fjalinë e dytë, gjithmonë sipas rendit që pamë më lart (në § 287, S.F.).

Për rastet e mënjanimet nga kjo rregullë, autori i Sintaksës së greqishtes së re bën fjalë në një shënim në po atë faqe (276, shënimi i parë): «Midis fjalës që çel fjalinë e dytë dhe foljes së kësaj *shumë herë πολλές φορές* ndërkalen kryefjala e fjalisë ose gjymtyra të tjera të dyta të saj, dhë *ndonjëherë (κάποτε)* ndonjë fjali tjetër e dytë, kur është fjala për të theksuar dhe për të nxjerrë në pah kuptimin e tyre (*όταν πρόκειται αυτά έτσι να τονιστούν και να έξαρθῆ τό νόημά τους*). (276). Në të vërtetë, ndër shembujt e paraqitur aty ka fragmente ku «theksimi» «vënja në pah» duket qartë, sidomos te periudha me fjali të varur kohore: *Πριν καλά καλά ό ήλιος πέση, έμπαιναν στό χωριό* (f. 277), d.m.th. «para se të përrëndonte mirë dielli, hynë në fshat, fjalë për fjalë «para se mirë e mirë dielli të përrëndonte, hynë në fshat»). Por në shembujt të tjerë nuk duket të ketë ndonjë «shenjë» theksimi të kuptimit, sidomos te periudhat me fjali të varur kundrinore (*ειδικές προτάσεις*), si p.sh. te: *πίστεψα πώς όλοι μέ παίνεψαν* (f. 276); *πίστεψε ότι... ή ζωή μου δέ θα είχε δέλητρο* (po ai, po aty, f. 277)

Na duket se për nga pikëpamja e ndonjë theksimi, këto fjali janë neutrale: në fjalitë e varura që nisin me lidhëzat ftilionjëse *ότι, πώς, πού*, si fjali dëftore të zhdrejta që janë, zbatohet rendi i fjalëve që është i rëndomtë për fjalitë dëftore të pavarura, kur nuk kanë ndonjë theksim.

Ndoshta autori i ka atribuar vënjen në pah jo më rendit të rëndomtë të kryefjalës por theksimit intonacionor që mund të ketë ajo në atë fjali, por theksimin intonacionor mund ta vinte në dukje edhe me një rend tjetër fjalësh.

Nuk na duket i drejtë të konsiderohet si diçka mekanike caktimi i vëndit të kallëzuesit të fjalitë e varura lidhore (përcaktore, përmendëse. Relativsatz). Në këto fjali për greqishten e re është i paracaktuar vetëm

5) A. TZAPTZAHOΣ, v.c. vll. II, Athinë 1963, fq. 276.

vendi i mjetit të lidhjes, d.m.th. pozicioni i përemrave e ndajfoljeve lidhore, — domosdo në krye të fjalisë së varur, — kurse vendi i kallëzuesit nuk mund të konsiderohet jashtë funksionit sintaksor të këtyre përemrave e ndajfoljeve lidhore, pa marrë parasysh se çfarë gjymtyrë të fjalisë janë dhe si zbatohet në këto raste rendi i fjalëve i rëndomtë neutral. Kur përemri lidhor është kryefjalë, kundrinë a plotës, kallëzuesi zë ndaj kryefjalës pozicion të domosdoshëm postpozitiv, gjithashtu edhe pas kundrinës a plotësave të rrethanës; kur fjalia e varur çelet nga një ndajfolje lidhore, kallëzuesi pason domosdo plotësin e rrethanës, d.m.th. ndajfoljen lidhore, kështu që në këto raste kemi rend të fiksuar, përkritazi «kryefjalë — kallëzues» «kundrinë — kallëzues», dhe «plotës rrethane — kallëzues». Por shkalla e lidhurisë së pjesëve përbërëse të grupit të kryefjalës, nga njëra anë, dhe të grupit të kallëzuesit nga ana tjetër, si në shqipe, ashtu dhe në greqishte është shumë e madhe, jo vetëm në fjalinë e varur, por edhe në fjalinë e pavarur. Prandaj, kur përemri lidhor është kundrinë e drejtë, folja duhet të vijë menjëherë pas saj që të mos priset lidhuria e ngushtë përbrenda grupit të kallëzuesit dhe kundrinës; në këtë sfond futja e një kryefjale midis kundrinës dhe kallëzuesit do të merrte me të vërtetë atë «kuptim të veçantë», për të cilin bën fjalë K. Hebleri; po kështu mund të thuhet edhe për grupin e kallëzuesit me plotësit e rrethanës.

Po ai rend që vërehet midis kryefjalës dhe kallëzuesit e plotësve të rrethanës, ka të bëjë edhe me rendin e kryefjalës dhe të kallëzuesit në fjalitë e varura kohore si në shqipe, ashtu edhe në greqishte. Ndonëse thuhet në përgjithësi se lidhëzat kohore (që na interesojnë posaçërisht këtu) nuk janë gjymtyrë të fjalisë, prapëseprapë, semantika e tyre rrethanore kohore shfaqet qartë dhe ndikon në rendin e kallëzuesit e të kryefjalës, ndryshe për shembëll nga lidhëzat thjesht funksionale, lidhëzat ftillonjëse, që janë katandisur vetëm në një shenjë formalo-gramatikore të varësisë së një fjalie nga tjetra, siç e përmendëm më sipër.

Veç kësaj, nga të tri mënyrat me të cilat në greqishten e re mund të shprehen raportet partitive, shqipja ka të përbashkët vetëm njërën, ndërsa nga ana tjetër shqipja, siç pamë më sipër, ka një konstrukt që s'e ka greqishtja, konstrukt me rendin postpozitiv të përemrit lidhor në gjindore. Le ta shohim shembullin e mëposhtëm:

'Η νέα Ἑλληνική εἶναι διακλαδισμένη σέ διαλέκτους, πού ἡ μιά διαφέρει πολὺ ἀπ' τήν ἄλλη /te Carcanos, v. c. VII. I. f. 165/. ku ndodhen konstruktet:

- (1): πού ἡ μιά διαφέρει
- (2): ἀπ' τίς ὁποῖες ἡ μιά διαφέρει
- (3): τῶν ὁποίων ἡ μιά διαφέρει

Nga këto shqipja ka në përdorim vetëm konstruktin (2), zaten edhe këtë të kushtëzuar nga disa kufizime, të cilat, me sa duket, nuk ekzistojnë në greqishten e re.

Në shqipe ekziston togfjalëshi partitiv «Dy prej vajzave / njëra nga vajzat» sipas formulës «Numuror + nga/prej + Emër» me këtë rend të fiksuar siç e kemi paraqitur këtu. Në fjalitë e varura lidhore, kur emri zëvendësohet nga përemri lidhor, rendi i mësipërm nuk ndryshon.

Herën e parë (Skënderbeu) u rrethua prej turqve, NJË PREJ TË CILËVE e rrëmbeu për qafe dhe përpiquej ta zvarniste nga kali përdhe / F. Noli, Historia e Skënderbeut, Boston 1951. f. 100 /.

Dhoma ishte e vogël, (. . .) me dy dritare të vockëla, si kafazë, NJËRA PREJ TË CILAVE ishte e mbyllur /Gjata, Tana², T. 1958, f. 315 /.

Greqishtja e re nuk njeh një vendosje të tillë të gjymtyrëve të togfjalëshit: po ta përkthenim greqisht shembullin e mësipërmë do të kishim tri variante të tjera krejt të ndryshme nga konstrukti shqip; po shënojmë vetëm elementet e domosdoshme të strukturës:

- (1) ... δύο παράθυρα, που τό ένα ήταν ...
- (2) ... δύο παράθυρα, των οποίων τό ένα ήταν ...
- (3) ... δύο παράθυρα, άπ' τά όποία τό ένα ήταν ...

Nga këto, konstrukti përkatës (1) në shqipe nuk është as mbarë-shqiptar, as letrar: ai figuron ndonjëherë në tekstin e përrallave të mbledhura prej Pedersenit në Korfuz të Greqisë nga shqiptarë prej Mursie dhe Lëkurësi që patjetër i dinin të dy gjuhët, shqipen dhe greqishten, dhe këtu mund të shihet një pajtim midis greqishtes dhe bartësit dialektor të treguesit të përrallës,⁶ por këtë e gjejmë vetëm tek ato përralla të botuara prej H. Perdesenit, prandaj ky konstrukt nuk është karakteristik i shqipes.

Konstrukti (2) është krejt i huaj për sintaksën e shqipes, siç e kemi treguar më lart. Ndërkaq, konstrukti përkatës (3) është në përdorim në shqipe, por në raste të caktuara: kur ekziston një kundërvënje midis gjymtyrëve përkatëse të dy fjalive lidhore, të bashkërenditura me lidhëza këpujore, por të bashkëvarura nga fjalia varëse. Në këtë rast është prishur dhe vetë rendi i mundshëm në fjalinë e pavarur për togfjalëshin partitiv «Numuror + nga / prej + Emër», rend që ruhej në konstruktet të pashoqëruara me kundërvënje fjalish: përemri lidhor zë vendin e parë dhe pasohet nga numërori: «nga të cilët / prej të cilëve + numëror». Kjo përmbyse e rendit të gjymtyrëve të togfjalëshit përbrenda periudhës ndodh për arsye se përemri lidhor është gjymtyrë e përbashkët e të dy fjalive të bashkërenditura këpujore, dhe për shqipen është normë që vendi i gjymtyrëve të përbashkëta nuk mund të jetë veçse në krye fare të periudhës me fjali të bashkërenditura. Kjo kërkesë është aq e fortë sa ka arritur të mundë edhe rezistencën e rendit të vetëm të mundshëm të gjymtyrëve në togfjalëshet partitive të shqipes.

Sulltan Muradi II, për të thyer kryengritjen shqiptare, dërgoi Ali Pashën, më të zotin e gjeneralëve të tij, me një ushtëri prej 25.000, NGA TË CILËT 15.000 ishin kalorës dhe 10.000 këmbës / F. Noli, Historia e Skënderbeut³, T. 1962, f. 36 /.

6) Po të shihet më afër çështja, fjala «που» e greqishtes së re nuk funksionon gjithmonë si përemër lidhor, përmendës: si përemër lidhor ajo mund të funksionojë vetëm kur është kryefjalë e kundrinë e fjalisë së varur, por në raste të tjera ajo fjalë nuk përmend asgjë nga fjalia kryesore (emër a përemër), dhe funksioni lidhës kryhet nëpërmjet të përmrave vetorë etj. që ndodhen në të, përndryshe do të vështirësohej pa masë kuptimi i saktë i marrëdhënjeve, ose ai do të bëhej i pamundur pa iu drejtuar kontekstit të mëparshëm.

Në greqishten e re, përdorimi i fjalës «που» dhe konstruktet ku përdoret ajo (fjalitë «lidhore») përputhen çuditërisht me përdorimin dhe me konstruktin përkatës të persishtes moderne, ku fjala «*ke*» ashtu si dhe fjala e greqishtes së re «*που*» në disa raste, nuk është veçse një farë mjeti lidhës universal, një farë pjesëzë lidhëse, një farë «shënje konvencionale» e varësisë së një fjalisë nga një fjali tjetër. Funksionin e përmendjes së emrit a përemrit antecedent e kryejnë përemra të ndryshëm vetorë, me parafjalë a pa parafjalë, të cilët janë gjymtyrë të fjalisë së varur lidhore, kurse fjalia lidhëse persisht «*ke*», greqisht «*που*» nuk janë gjymtyrë të fjalisë së varur, veçse ndodhen përbrenda saj. / Shih: Ю. А. Рубинчик, Сложные предложения с придаточным определительным в современном персидском языке, Москва 1959, ф. 20-35.

Nga ushtarët dhe vullnetarët që u mblodhnë, (Skënderbeu) mbajti vetëm 15.000, PREJ TË CILËVE 8.000 ishin kalorës dhe 7.000 këmbës, të gjithë luftëtarë të provuar, të zgjedhur me kujdes / Po ai, Historia e Skënderbeut², Boston, 1951, f. 33 /.

Moisiu ishte i nipi i Gjergj Aranitit edhe i Vladan Aranitit, NGA TË CILËT *i pari* ishte i vjehri edhe *i dyti* i kunati i Skënderbeut / Po ai, po aty, f. 73 /.

Fjalja që ka, pakë se paku, dy pjesë NGA TË CILAT *njëra* bën fjalë për një njeri, për një kafshë, për një gjë dhe *tjetra* na tregon se ç'është për të, quhet fjali e thjeshtë / K. Cipo, Sintaksa, T. 1952, f. 3 /.

Ajo (shtëpia) kish katër dhoma, NGA TË CILAT zonja e shtëpisë *dy* i lëshonte me qira dhe *dy* i mbante për vete / V. Kokona, Me valët e jetës, vll. I, T. 1961, f. 44 /.

Rendi i fjalëve në fjalitë e varura të greqishtes së re nuk është plotësisht i tillë siç e ka paraqitur K. Hebleri. Te një varg tipesh të fjalive të varura nuk vërehet rendi «i rëndomtë» «kallëzues-kryefjalë» etj. siç e jep të absolutizuar autori i artikullit, duke thënë se «këtu (d.m.th. në greqishten e re) folja pason jo vetëm në fjalitë kohore dhe lidhore, por në të gjitha fjalitë e varura pa përjashtim direkt (nënvizuar prej meje, S.F.) ose e ndarë vetëm nga mohimi, pjesëzat ose trajtat përemërore lidhëzën e fjalisë kohore, pothuajse pa përjashtim fjalën pyetëse dhe lidhorin» (f. 58).

Në greqishten e re ka një varg tipesh semantiko-strukturore periudhsh me fjali të varura, ku rendi «kryefjalë-kallëzues» etj. nuk është i fiksuar, i ngulitur, por është mjaft i lirë.

Kjo mund të konstatohet mjaft mirë te «fjalitë specifikuese» (ειδικές προτάσεις) me lidhëzat ftillëzonjëse *ότι, πώς, πού,* (pranfoljore, pranmbiemërore ose pranemërore), te fjalitë shkakore, te fjalitë lejore, te fjalitë rrjedhimore; rendi i fjalëve është më i ngulitur te fjalitë kohore, te fjalitë kushtore (tek kjo e fundit duhet shikuar edhe ndonjë çështje e influencës së rendit të fjalëve të fjalive pyetëse të përgjithshme, nga, siç dihet, e kanë origjinën këto fjali në gjuhët indoevropiane).

Po japim disa shembuj të qëmtuar aty-këtu nga vepra e cituar e A. Carcanos-it, vll. II:

Shembuj për fjali «specifikuese».

1) me funksion «kundrine»:

Ξέρεις πού ή μέση μου πονεί /f. 53/.

Θαρρώ πώς καλύτερα είναι να μείνουμι' εδω /po aty/.

Ἐπίστευες ότι αυτό τό παιδί θα μάς πότιζε φαριάκι; /f. 58/

2) me funksion «kryefjale»:

Εἶν' ἀλήθεια πώς μερικά ἀπ' τὰ διηγήματα αὐτά εἶναι δημοτικοί θρύλοι /f. 55/

Τυχρό πού ή Αλτάνη εἶχε τὰ ἴδια πολιτικά αἰσθήματα με τόν άντρα της /po aty/.

3) me funksion përcaktues-ftillëzues ndaj një emri abstrakt:

Μιά μέρα ήρθε εἰδηση πώς ό άνδρας της πέθανε στίς θάλλασες τής Κίνας /f. 55/

Δέν μπορεί κανείς ναποδείξη τήν κατιγορία πώς ό Λασκαράτος ήταν ἐγκάτετος τών Ἄγγλων στήν Ἐπτάνησο /po aty/.

Καριά θεωρία δέν μπορεί ν'άλλάξη τό φυσικό κανόνα, πώς ό ποιτής είναι αὐτοδίδακτος /f. 56/

Shembuj për fjalinë shkakore:

Προχώρα, τί (= διότι) ό καιρός κάθε σου βήμα κρίνει /f. 60/

Δική τή γλώσσα δέν μπορεί νά πλάση, γιατί τότε ποιός δά τόν καταλάβαινε: /f. 60/.

Shembull për fjalinë kushtore:

"Αν τά μαλλιά μου μισόσπρισαν, εἴκοσι ἐτῶν εἶν' ἡ καρδιά μου /f. 71/,
përbri rendit të rëndomtë «kallëzues-kryefjalë», si p.sh.

"Αν τό κατώρθωσε αὐτό ό Παῦλος, τόν θαυμάζω /f. 62/.

Shembuj për fjalinë lejore:

Και οί γονεῖς μου νά μή σέ θέλουν, ἐγώ θάρθω νά σέ πάρω /f. 76/.

Shembuj për fjalinë rrjedhimore:

Φαίνεται πώς θάφευγε τόσο μακρὰ, ὥστε ἄλλη συνάντησι δέ δά εἶχε πλέον στή αὐτή μαζί τους /f. 95/.

Ἡ Μυρσίνα τόσο ὀμορφη ἦταν, που καί πεθαμένη φαινόταν σάν ἄγγελος /f. 95/.

Shembuj për fjalinë kohore (me nuancë kushtore):

"Όταν τό πνεῦμα κοιμάται, τό σῶμα τρέφεται /f. 100/

"Όταν ἕνας ἄνθρωπος χάσι τή γαλήνη του, χάνει τό πᾶν /po aty/.

Veç kësaj te disa tipe fjalish me nuancë kushtore, rendi kryefjalë-kallëzues nuk duket i kushtëzuar nga arësye theksimi; ca më tepër kjo ndodh te fjalitë lidhore.

Prandaj greqishtja e re nuk ka mundësi të ketë ndikuar mbi rendin e fjalëve «kallëzues-kryefjalë» etj. te fjalitë e varura kohore dhe lidhore të shqipes, sepse edhe për vetë greqishten një rend i tillë nuk është i ngulitur, jo vetëm për gjithë tipet semantiko-strukture të periudhave me fjali të varura, por edhe përbrenda nëntipeve të fjalive të varura kohore dhe lidhore.

Kështu, duke marrë parasysh mospërkimet e strukturës së disa nëntipeve të fjalive lidhore të shqipes dhe greqishtes përsa i përket pozicionit të mjetit të lidhjes si dhe të mospërkimit te vlera «përemërore» të përemrit lidhor shqip që, nga njëra anë, dhe te fjala greqishte «πού» nga ana tjetër, si dhe mjaft mospërputhje që u vunë në dukje gjatë parashtrësës, ne, në kundërshtim me K. Heblerin, nuk mund të lejohe mi ta mbajmë për «më probabel» (wahrscheinlicher) mundësinë e ndonjë ndikimi grek, por e hedhim poshtë një mundësi të tillë, dhe theksojmë se ato përkime që vihen re midis greqishtes dhe shqipes janë ose pjesërisht të përbashkëta për gjuhët indoevropjane, dhe rrjedhin nga disa tipare të përbashkëta të trashëguara thjesht morfologjike a sintaktiko-morfologjike, ose përbëjnë një zhvillim të pavarur në të dy gjuhët, që ka dhënë rezultate gadi të njëjta a të afërta.

Kështu, studimi i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe ka rëndësi të

madhe jo vetëm për këtë gjuhë, por edhe për gjuhësinë ballkanike e, më tej, edhe për gjuhësinë e përgjithshme, ashtu si dhe studimi i rendit të fjalëve në greqishten e re e në gjuhët e tjera ballkanike.

Por, besojmë se roli i vërtetë i rendit të fjalëve, si në shqipen e sotme⁷, ashtu edhe në greqishten e re e në gjuhët e tjera të Ballkanit, nuk mund të studjohet e të zbulohet pa marrë parasysh në masën e duhur fenomenin gjuhësor shoqëruar të domosdoshëm në çdo fragment ligjërimor, d.m.th. pa marrë parasysh intonacionin, sidomos në atë pjesë që ka të bëjë me theksat frazorë. Tashmë është e qartë për ne se struktura gramatikore (formalo-gramatikore) është më se forti shprehëse e anës objektive të semantikës, kurse rendi i fjalëve, i gërshetuar ngushtë me intonacionin, shërben për të treguar raportin e një gjymtyre të fjalisë ndaj një gjymtyre tjetër të fjalisë ose ndaj një fjalie të tërë, për të treguar rëndësinë që i jep ligjëruesi një fjale a një togfjalëshi në vargun ligjërimor, me fjalë të tjera, për të treguar peshën kumtesore që ka kjo fjalë ose ky togfjalësh në një njësi të caktuar kumtesore, ku për hir të kësaj peshe kumtesore edhe sajohet vetë fjalia (a periudha).

Studimi i rendit të fjalëve në shqipen letrare kombëtare përbën një nga çështjet themelore të Gramatikës shkencore që po harton Instituti i historisë dhe i gjuhësisë, dhe do të kërkojë pa tjetër një punë të madhe kërkimore.

Për zgjidhjen me sukses të studimit të rendit të fjalëve në gjuhën shqipe (a në gjuhët e tjera të ballkanit, për të cilat kjo çështje është ndër më aktualet e urgjentet) do të duhen një varg përgjithësimesh teorike paraprake të vrojtimeve të pasura të grumbulluara brenda një kohe relativisht të gjatë, duke pasur gjithmonë parasysh bashkëveprimin e rendit të fjalëve me intonacionin, varësinë e rendit të fjalëve nga faktorë morfologjikë, leksikorë, leksiko-gramatikorë e sintaksorë, duke shqyrtuar një material që nga strukturat më të thjeshta (fjalitë e thjeshta dykryegjymtyrëshe me vetëm kryefjalë e kallëzues) deri te periudhat shumëgjymtyrëshe, duke u mbështetur në të dhënat e togfjalësheve dhe duke ndjekur modifikimet e ndryshme të tyre gjatë funksionimit në fjali, gjatë kalimit nga një strukturë e thjeshtë me një bërthamë kallëzuese, te struktura më të ndërlikuara, dhe duke zbuluar këtu se cilat anë të rendit të fjalëve kanë rëndësi thjesht gramatikore (d.m.th. tregojnë funksionin gjymtyror të fjalëve), cilat anë kanë të bëjnë me çështjen e «zbërthimit aktual», e cila anë, së fundi, kanë të bëjnë me momente thjesht stilistike, duke nxjerrë në pah rastet e «rendit të rëndomtë», ose «të drejtë», rastet e rendit të anasjellë për shkak të gjymtyrimit aktual, dhe rastet e rendit të anasjellë për shkak të nuancave stilistike etj. etj.

Duke u zbuluar kështu tiparet karakteristike dhe inherente të gjuhës shqipe (dhe të gjuhëve të tjera ballkanike) mund të ndërmerret një përjasje e gjithanshme e strukturave dhe e vlerave për të nxjerrë në mënyrë objektive ato tipare të rendit të fjalëve që janë karakteristike për «gjuhësinë ballkanike» dhe që e dallojnë atë nga gjuhët e tjera indoevropjane. Në këtë sfond rendi i fjalëve në gjuhën shqipe mund të ndriçojë anë të ndryshme të «marrëdhënjeve» të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike, ndër të tjera dhe me greqishten, por jo më në mënyrë të njëanshme si «marrje» e «dhënje», e bërë nga një gjuhë një gjuhe tjetër.

7) Fatkeqësisht nuk kemi njohuri për rezultatet e studimit të hollësishtëm të rendit të fjalëve e të fjalive të shqipes me të cilin merrej akoma më 1957 autori i artikullit, sipas njoftimit të shënimit 14 me f. 61. Nuk dimë të jetë botuar gjë.

R é s u m é

SUR CERTAINES QUESTIONS DE L'ORDRE DES MOTS
EN ALBANAIS CONTEMPORAIN

Sur l'ordre des mots en albanais on n'a eu jusqu'aux derniers temps que des affirmations isolées, parsemées dans les manuels, scolaires ou non, de la langue albanaise. Sur ce fond, l'article de Claus Haebler «Eine albanische Wortstellungsregel», publié dans «Münchener Studien zur Sprachwissenschaft», 1957, Heft 11 (p. 49-61) a le mérite de tirer, sur les matériels des contes populaires albanais, «une règle principale» et «la règle complémentaire 1», et «la règle complémentaire 2» sur l'ordre des mots dans la proposition subordonnée relative et dans la proposition subordonnée temporelle, à savoir: «Dans les propositions subordonnées temporelles et dans les subordonnées relatives, le verbe suit presque sans exception immédiatement la conjonction temporelle de la subordonnée, resp. le pronom relatif; le verbe a, donc, une position initiale «couverte» (p. 51). Dans la règle complémentaire 1 C. Haebler affirme que «Quelques mots à ton faible (schwachtönige Wörter), qui apparaissent presque toujours liés en une unité respectivement fixée, à savoir les particules de négation mos nuk, s', les particules po et të, ainsi que les formes proclitiques des pronoms personnels ou bien leurs combinaisons (verbindungen derselben) conservent dans les subordonnées complètes et relatives leur position proclitique devant le verbe» (p. 51), tandis que la règle complémentaire 2 est énoncée comme suit: «Les propositions subordonnées qui normalement précèdent leur proposition régente conservent aussi cette position si elles dépendent d'une proposition temporelle ou relative, c'est-à-dire sont intercalées entre la conjonction temporelle de la proposition subordonnée, resp. entre le pronom relatif et le verbe de la proposition temporelle ou relative» (f. 51). Les règles sont illustrées par des fragments abondants tirés notamment des contes populaires albanais.

«La règle principale» constate une régularité caractéristique de l'albanais, notamment des contes populaires albanais, et représente une contribution précieuse de C. Haebler. Les règles complémentaires sont d'une importance mineure. Après cela C. Haebler est bien obligé de constater que: «seulement dans certains cas relativement peu nombreux les règles susmentionnées ne sont plus valables: entre la conjonction temporelle de la subordonnée, resp. entre le pronom relatif et le verbe est intercalé parfois un autre terme de proposition (un sujet ou bien un complément circonstanciel). A ce qu'il semble, il assume par suite de cette position insolite, une signification particulière», et présente en tout quatre exemples, sans s'attaquer de manière plus approfondie à l'étude de l'exception en question.

L'auteur de l'article sur «une règle albanaise de l'ordre des mots» se pose pour tâche de découvrir le point de départ (l'origine) de cet ordre des mots en albanais parlé, et après avoir pesé certains arguments il conclut que «l'on est permis de considérer comme plus probable (wahrscheinlicher) que la position initiale «couverte» du verbe dans les propositions temporelles et dans les subordonnées relatives est liée à l'influence du grec» (p. 61). Les arguments en appui présentés par C. Haebler sont la documentation très ancienne des textes grecs, et par conséquent, la

possibilité de suivre la question de l'ordre des mots depuis l'ancien grec, à travers le grec hellénique et le grec du Nouveau Testament, «où a été préparé déjà la situation qui ensuite est devenue dominante dans le grec moderne, et précisément pour toutes les propositions subordonnées» (pp. 59-60). En s'appuyant ensuite sur l'opinion traditionnelle professée notamment depuis K. Sandfeld dans sa «Linguistique balcanique» sur l'influence du grec sur les langues balcaniques, l'albanais compris, C. Haebler est tenu de conclure que l'ordre des mots dans la proposition subordonnée temporelle et dans la subordonnée relative a son origine dans l'influence de la langue grecque.

L'auteur du présent article, S. Floqi, se propose d'analyser la question des matériels pris en considération par C. Haebler, la question de la validité panalbanaise de la «règle principale», la question de la mesure de normalisation de l'ordre des mots en grec moderne (dans la langue démotique qui peut être prise en considération ici), et aussi la question de savoir s'il n'y a pas, même dans cette phase des études, des éléments précieux qui donneraient la possibilité de considérer l'ordre des mots en albanais contemporain et en grec moderne comme le résultat d'un processus indépendant dans chacune des deux langues, plutôt qu'à une influence unilatérale du grec sur l'albanais. L'auteur soulève les questions suivantes:

1°) la langue étudiée par C. Haebler n'est pas l'albanais parlé, mais la langue des contes populaires albanais. La langue des contes populaires et les constructions des contes populaires sont conditionnées par le genre stylistico-littéraire que représentent les contes: récit parlé et contenu où prédomine l'action, donc dans les contes populaires les phrases sont d'ordinaire courtes ou fusionnent les verbes et toutes circonstances temporelles (ou locales). Les coïncidences de l'ordre des mots dans les subordonnées en question est due aux particularités inhérentes aux genres des contes populaires; par contre, dans les autres styles de l'albanais littéraire et parlé l'ordre des mots est plus libre, et se trouve conditionné au moins par trois facteurs: a) par des raisons de structure, b) par la division actuelle de la proposition (aktualné členění větné, selon V. Mathesius), et c) par les nuances supplémentaires et qui se superposent à la signification fondamentale d'un type de phrase complexe de subordination jusqu'à la submerger.

2°) L'auteur reproche à C. Haebler (ainsi qu'à A. Tzartanos) de considérer l'ordre des mots comme un phénomène mécanique, ce qui est contesté par les faits de l'albanais et par les faits du grec moderne. L'ordre immédiat «couvert» du verbe dans les propositions temporelles et les subordonnées relatives du grec moderne et de l'albanais contemporain est conditionné par une certaine cohésion égale dans les deux langues pour le groupe du «verbe objet» et pour celui du «verbe-complément de circonstance». Les conjonctions temporelles, par leur sémantique exercent leur influence sur l'ordre «verbe-sujet», «verbe-sujet-complément d'objet», etc.

3°) De plus, les subordonnées temporelles et les subordonnées relatives ne peuvent pas être considérées sur le même pied quant à l'ordre des termes de proposition, étant donné que dans les relatives, le pronom (ou l'adverbe) relatif, de par sa fonction de liaison a une position fixée tout au début de la subordonnée, ce qui revient à dire que dans les cas appropriés l'ordre «sujet-verbe» est déjà conditionné par la position et la fonction de sujet du relatif, ce dont il ne peut être question dans les temporelles.

4°) Les propositions relatives de l'albanais contemporain et du grec moderne (démotique) offrent un certain nombre de différences fonda-

mentales: 1) l'albanais possède le groupe de mots partitif constitué par «un numéral + prép. nga/prej + un pronom relatif» (një/njëri nga/prej + relatif», qui reproduit dans la subordonnée relative le groupe de mots partitif «numéral + nga/prej + nom»), «një nga djemtë; dy prej vajzave», en d'autres mots, en albanais dans ce cas la subordonnée relative se trouve «introduite» non pas par le pronom relatif, mais par un numéral, ce qui est impossible en grec moderne.

De plus l'ordre des mots dans un groupe de mots attributif en albanais, représenté par la formule «Nom + Nom au génitif» est conservé dans la subordonnée relative, quand le second nom substantif au génitif est remplacé par le pronom relatif (kooperativat e artizanatit, rrjeti i të cilave...), cet ordre est l'unique possible, et se présente tout à fait différent de l'ordre des mots dans les structures adéquates du grec moderne, qui offre trois variantes, dont deux sont impossibles en albanais, et l'autre figure en albanais mais l'emploi en est conditionné pour des raisons de structure à des restrictions, qui ne figurent pas dans le grec (cf. *ποῦ ἢ μιὰ διαφέρει, ἀπ' τῆς ὁποῖας ἢ μιὰ... , τῶν ὁποῶν ἢ μιὰ...)*

D'autre part, l'emploi de l'ordre «verbe-sujet» dans les subordonnées du grec moderne n'est pas si général que le prétend C. Haebler ou que fait entendre A. Tzartanos; dans le présent article sont mentionnés de très nombreux cas d'emploi d'un ordre de mots plus libre et indépendant de quelque «signification particulière»: cela est témoigné par l'ordre des mots dans les subordonnées complétives (*εἰδικῆς προτάσεις*), dans les causales, dans certains types de consécutives, de concessives, et même dans quelque type de subordonnée temporelle (à nuance conditionnelle), et dans certains types de relatives.

Considérant les différences d'emploi des pronoms relatifs et de leurs structures dans les propositions relatives des deux langues, considérant les raisons nettement structurelles de l'emploi de certains modèles d'ordres de mots, considérant aussi le fait que le grec moderne est loin de posséder une topique normale universelle de l'ordre «verbe-sujet» dans les différents types de phrases complexes de subordination, S. Floqi conclut qu'on doit rejeter l'éventualité d'une influence grecque, et s'efforcer de trouver une explication toute diverse des concordances partielles de l'emploi de l'ordre des mots: celles-ci résultent des propriétés communes hérités de l'indoeuropéen (morphologiques, syntactico-morphologiques, etc.) ou bien représentent le résultat d'un développement indépendant effectué dans les deux langues.

S. Floqi conclut en mettant en vedette l'importance de l'étude de l'ordre des mots dans l'albanais et dans les autres «langues balcaniques», le grec y compris, étude qui peut être entreprise en se conformant à certains critères très précis et bien définis, en y faisant intervenir, entre autres, l'étude de l'ordre des mots en relation très étroite avec l'intonation, surtout avec l'accent de phrase. L'auteur présente un certain nombre de critères susceptibles de favoriser la réalisation des études «confrontatrices» sur cette question.